



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Viti: 2024 – Numri: 4

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Tiranë – E hënë, 8 janar 2024

PËRMBAJTJA

	Faqe	
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 792, datë 28.12.2023	Për miratimin e rregullores “Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurave për sigurinë e informacionit të klasifikuar, që trajtohet në Sistemet e Komunikimit dhe Informacionit (SKI)”.....	207
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 806, datë 28.12.2023	Për miratimin e listave të mallrave, që mund të përdoren ose nuk kanë përdorim tjetër përveç qëllimit të dënimit me vdekje, torturës ose dënime apo trajtime mizore, çnjerëzore ose poshtëruese, të cilat janë objekt i kontrollit shtetëror të transferimeve ndërkombëtare.....	228
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 823, datë 28.12.2023	Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 41, datë 24.1.2018, të Këshillit të Ministrave, “Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë”, të ndryshuar.....	234
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 826, datë 28.12.2023	Për organizimin dhe funksionimin e Drejtorisë së Shërbimeve të Peshkimit dhe Akuakulturës.....	241
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 827, datë 28.12.2023	Për deklarimin si pasuri kulturore e paluajtshme “Qendër historike” të një zone në qytetin-muze të Beratit, përcaktimin e zonës mbrojtëse të saj dhe miratimin e planit për ruajtjen, mbrojtjen dhe administrimin e saj.....	243
Urdhër i ministrit të Turizmit dhe Mjedisit nr. 1, datë 3.1.2024	Për delegimin e kompetencave.....	284
Urdhër i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit nr. 1, datë 4.1.2024	Për delegim të kompetencave	285
Vendim i Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut datë 5.12.2023	Çështja Osmani kundër Shqipërisë (<i>kërkesa nr. 8706/18</i>).....	285
Vendim i Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut datë 30.11.2023	Nikolla Cepiku dhe Seni sh.p.k. kundër Shqipërisë (<i>kërkesa nr. 18175/12</i>).....	289

**VENDIM**

Nr. 792, datë 28.12.2023

**PËR MIRATIMIN E RREGULLORES
“PËR PËRCAKTIMIN E RREGULLAVE
DHE TË PROCEDURAVE PËR
SIGURINË E INFORMACIONIT TË
KLASIFIKUAR, QË TRAJTOHET NË
SISTEMET E KOMUNIKIMIT DHE
INFORMACIONIT (SKI)”¹**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 3, të nenit 49, të ligjit nr. 10/2023, “Për informacionin e klasifikuar”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e rregullore “Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurave për sigurinë e informacionit të klasifikuar, që trajtohet në sistemet e komunikimit dhe informacionit (SKI)”, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Ministritë, institucionet shtetërore dhe operatorët ekonomikë nxjerrin udhëzimet përkatëse për zbatimin e këtij vendimi brenda 90 (nëntëdhjetë) ditëve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi.

3. Vendimi nr. 542, datë 25.7.2019, i Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullore “Për sigurimin e informacionit të klasifikuar që trajtohet në sistemet e komunikimit dhe të informacionit (SKI)”, shfuqizohet.

4. Ngarkohen ministritë, institucionet shtetërore dhe operatorët ekonomikë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTËR
Edi Rama**

RREGULLORE

**PËR PËRCAKTIMIN E RREGULLAVE DHE
TË PROCEDURAVE PËR SIGURINË E
INFORMACIONIT TË KLASIFIKUAR, QË
TRAJTOHET NË SISTEMET E
KOMUNIKIMIT DHE INFORMACIONIT
(SKI)”**

KREU I**DISPOZITA TË PËRGJITHSHME****Neni 1****Objekti**

Objekti i kësaj rregulloreje është:

1. përcaktimi i detyrave dhe i përgjegjësive për sigurinë e informacionit të klasifikuar, që trajtohet në sistemet e komunikimit dhe informacionit.

2. përcaktimi i kërkesave minimale, që duhet të zbatohen për sigurinë e sistemeve të komunikimit dhe informacionit.

3. përcaktimi i rregullave për vlerësimin dhe akreditimin e sigurisë së sistemeve të komunikimit dhe informacionit.

Neni 2**Qëllimi**

Qëllimi i kësaj rregulloreje është garantimi i sigurisë së informacionit të klasifikuar, që prodhohet, ruhet, transmetohet, trajtohet në sistemet e komunikimit dhe informacionit.

Neni 3**Fusha e veprimit**

1. Kjo rregullore zbatohet për sistemet e komunikimit dhe informacionit (në vijim, SKI), që trajtojnë ose që do të trajtojnë informacion të klasifikuar “Sekret shtetëror”, të NATO-s, BE-së, shteteve dhe organizatave të huaja me të cilat Republika e Shqipërisë ka marrëveshje sigurie.

2. Dispozitat e kësaj rregulloreje zbatohen nga të gjitha subjektet publike dhe private apo strukturat, të cilat kanë përgjegjësi në planifikimin, krijimin,

¹Ky vendim është përafuar pjesërisht me: vendimin e Këshillit, datë 23 shtator 2013, “Mbi rregullat e sigurisë për mbrojtjen e informacionit të klasifikuar të BE-

së” (2013/488/BE), nr. CELEX 32013D0488, Fletore Zyrtare e Bashkimit Evropian, seria L, nr. 274, datë 15.10.2013, faqe 1–50.



prokurimin, zhvillimin, administrimin dhe përdorimin e SKI-ve.

Neni 4 Përkufizime

Në këtë rregullore, termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. “Akt vlerësimi”, dokumenti ku përshkruhet gjendja e sigurisë së sistemit dhe pranimi ose refuzimi i riskut të mbetur.

2. “Aset”, çdo gjë me vlerë, si pajisje e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit, komponent *software* dhe informacioni.

3. “Autenticiteti”, aftësia për të provuar se informacioni është i vërtetë dhe nga burime të sigurta.

4. “Autorizim kriptografik”, dokumenti që autorizon një individ për të aksesuar ose menaxhuar materialet kriptografike.

5. “Deklarata e Kërkesave të Sigurisë së Sistemit (DKSS)”, dokumenti që përshkruan masat e sigurisë së SKI-ve.

6. “Disponueshmëria”, aftësia e aseteve për të qenë të arritshme dhe të përdorshme kur nevojiten.

7. “Dobësitë”, mangësi në fortësinë, plotësinë ose konsistencën e kontrolleve dhe mund të jenë të natyrës teknike, procedurale ose operacionale.

8. “Emetim elektromagnetik komprometues”, rrezatimi elektromagnetik i pakontrolluar që mundëson ekspozimin e paautorizuar të informacionit të klasifikuar.

9. “Entitet”, në kuptim të kësaj rregulloreje, përfshin individë, pajisje ose shërbime.

10. “Incident sigurie”, çdo ngjarje që rezulton ose mund të rezultojë në padisponueshmëri të sistemit ose të komponentëve të tij kryesorë, zbulim të informacionit të klasifikuar, humbje ose ndryshim të padëshiruar të informacionit, shkatërrim ose humbje të pajisjeve apo të aseteve.

11. “Integriteti”, aftësia për të ruajtur saktësinë dhe plotësinë e aseteve.

12. “Kërcënimet”, mundësi për komprometimin e qëllimshëm ose jo të sigurisë. Në rastin e sigurisë së sistemeve, komprometimet e tilla përfshijnë humbjen e një ose më shumë objektivave të sigurisë së SKI-ve.

13. “Dokumenti i konceptit të operimit (DKO)”, dokumenti që përshkruan misionin, mjedisin operacional, mjedisin e mirëmbajtjes, funksionet

dhe karakteristikat e sistemit brenda mjedisit të përgjithshëm operacional.

14. “Konfidencialiteti”, aftësia për të provuar që informacioni nuk është i ekspozuar për entitete të paautorizuara.

15. “Material kriptografik” përfshin çelësat në të gjitha format e tyre, dokumentet, pajisjet që përmbajnë informacion kriptografik e që janë të rëndësishëm për kriptimin dhe dekriptimin e informacionit.

16. “Metodë e kombinuar autentifikimi”, mënyrë autentifikimi e përbërë nga dy ose më shumë elemente sigurie.

17. “Mjedis i sigurt global i sistemit (MSG)”, rrethina e objektit ku është instaluar dhe operon sistemi.

18. “Mjedis i sigurt lokal i sistemit (MSL)”, objekti ku është instaluar dhe operon sistemi.

19. “Mjedis i sigurt elektronik i sistemit (MSE)”, pajisjet, shërbimet, aplikacionet që përbëjnë një SKI.

20. “Ndërlidhje e sistemeve”, lidhja e drejtpërdrejtë e dy ose më shumë SKI-ve, me qëllim shkëmbimin e të dhënave ose të shërbimeve.

21. “Pamohueshmëria”, aftësia për të provuar që një veprim ose ngjarje ka ndodhur, në mënyrë që ngjarja ose veprimi nuk mund të mohohen më vonë.

22. “Pajisje e lëvizshme”, në kuptim të kësaj rregulloreje, përfshin telefonat *mobile*, laptop, tableta dhe pajisje të tjera të lidhura me internetin.

23. “Plani i Akreditimit të Sigurisë së Sistemit (PASS)”, dokumenti që prodhohet nga AKAS-i, në bashkëpunim me autoritetet e sigurisë, në të cilin jepet informacion për sistemin që kërkohet të akreditohet, autoritetet e përfshira në procesin e akreditimit të sigurisë, aktivitetet që do të kryhen, përfshirë afatet kohore, si dhe dokumentet që do të prodhohen.

24. “Plani i menaxhimit të materialeve kriptografike”, dokumenti ku përcaktohen metodat, mjetet, procedurat, si dhe rolet e përgjegjësitë për generimin, vendosjen, regjistrimin, shpërndarjen, transportin, ruajtjen, arkivimin, revokimin, mbajtjen në llogari, rinovimin, rikuperimin, shkatërrimin dhe raportimin e komprometimit të materialeve kriptografike.

25. “Plani i vlerësimit dhe testimit të sigurisë së komponentëve të sistemit (PVTSKS)” është dokumenti që përcakton komponentët e sistemit që janë subjekt i testimit dhe vlerësimit, si dhe metodat,



mjetet, aktivitetet, rolet dhe përgjegjësitë për testimin dhe vlerësimin e sistemit.

26. “Plani i menaxhimit të riskut (PMR)”, dokumenti ku përcaktohen risqet e sigurisë dhe procesi i menaxhimit të tyre.

27. “Plani i përgjigjes ndaj incidenteve”, dokumenti ku detajohen procedurat në përgjigje të incidenteve të sigurisë kompjuterike. Ky dokument ka për qëllim ruajtjen e të dhënave që lidhen me incidentet dhe parandalimin e përshkallëzimit të tyre.

28. “Dokument i Procedurave të Operimit të Sigurt (DPOS)” është dokumenti ku përcaktohen procedurat për kryerjen e detyrave që lidhen me sigurinë e sistemit, si dhe rolet dhe përgjegjësitë e personelit.

29. “Dokument i procedurave në rastet e emergjencave” është dokumenti ku detajohen procedurat për evakuimin ose shkatërrimin e pjesëve të sistemit të ekspozuara ndaj riskut në rastet e gjendjes së luftës, gjendjes së jashtëzakonshme, krizave kibernetike, fatkeqësive natyrore dhe emergjencave të tjera civile gjatë të cilave ky informacion mund të përvetësohet, dëmtohet, komprometohet, shkatërrohet etj.

30. “Siguria e sistemeve të komunikimit dhe informacionit” është aplikimi i masave të sigurisë për mbrojtjen e informacionit dhe SKI-ve, sipas objektivave të sigurisë.

31. “Siguria e informacionit” përfshin përcaktimin dhe zbatimin e masave për mbrojtjen e informacionit të klasifikuar që trajtohet në SKI nga humbja aksidentale apo e qëllimshme e konfidencialitetit, integritetit dhe disponueshmërisë, dhe masat për parandalimin, humbjen e integritetit dhe disponueshmërisë së këtyre sistemeve.

32. “Sisteme të parandalimit të ndërhyrjeve *host-based*”, aplikacione/platforma të instaluar me qëllim monitorimin, analizimin dhe ndalimin e aktiviteteve të dyshimta, që ndodhin në pajisjen ku ato instalohen.

33. “Skema e shtrirjes së SKI-ve në Zonat e Sigurisë”, dokumenti që paraqet skicën e mjediseve të institucionit, ku pasqyrohet shtrirja e të gjithë komponentëve të lidhur në sistem dhe zonat e sigurisë përkatëse.

34. “TEMPEST”, studimi dhe kontrolli i emetimeve elektromagnetike komprometuese, fenomenit në vetvete dhe masave për mënjanimin e tyre.

35. “Raporti i testimit dhe vlerësimit”, dokumenti ku paraqiten rezultatet e përfuara nga testimi dhe vlerësimi i komponentëve të sistemit.

36. “Risk”, mundësia që një dobësi të shfrytëzohet me sukses nga një kërcënim, duke çuar në cenimin e objektivave të sigurisë.

37. “Risku i mbetur”, risku që mbetet pas implementimit të masave të sigurisë në SKI, duke marrë parasysh që jo të gjitha kërcënimet dhe dobësitë mund të eliminohen apo të reduktohen.

38. “Vlerësimi i sistemit të komunikimit dhe informacionit”, procesi i vlerësimit, testimit dhe ekzaminimit të masave/kontrolleve të sigurisë së sistemit, në bazë të standardeve specifike të sigurisë, si dhe identifikimi i dobësive të sistemit dhe përpilimi i planit të masave minimizuese të këtyre dobësive.

39. “Veprim i privilegjuar” përfshin, por pa u kufizuar në ndryshimin e konfigurimeve të sistemit, ndryshimin e parametrave të sistemit, aksesin në *log-et* e auditimit dhe sigurisë, aksesin në të dhëna, skedar dhe llogari që përdoren nga përdoruesit e tjerë, përfshirë *back-up-et* dhe mediat elektronike.

Neni 5

Objektivat e sigurisë

1. Objektivat e sigurisë janë:

- a) konfidencialiteti;
- b) integriteti;
- c) disponueshmëria;
- ç) autenticiteti;
- d) pamohueshmëria.

2. Niveli i aplikimit të objektivave është specifik për SKI të ndryshme dhe përcaktohet nga misioni i sistemit, kërkesat minimale të sigurisë dhe rezultatet e procesit të menaxhimit të riskut.

Neni 6

Kriteret themelore të sigurisë

1. SKI-të ndjekin këto kriteret sigurie:

a) Menaxhimi i riskut të sigurisë: aplikimi i procesit të menaxhimit të riskut për monitorimin, reduktimin, eliminimin, shmangien ose pranimin e riskut të mbetur që lidhet me sigurinë e SKI-ve;

b) Siguria gjatë të gjithë jetëgjatësisë së SKI-ve: garantimi i masave të sigurisë së SKI-ve nga vënia në funksionim dhe deri në heqjen nga shërbimi;



c) Funkcionalitetet dhe privilegjet minimale: instalimi dhe përdorimi vetëm i funksioneve, protokolleve dhe shërbimeve që kërkohen për të përmbushur misionin operacional të sistemit. Entitetit që përdor SKI-në i lejohen vetëm privilegjet dhe autorizimet që nevojiten për kryerjen e detyrave;

ç) Nyja vetëmbrojtëse: secili SKI i ndërlidhur të trajtojë SKI-në tjetër si të huaj dhe të implementohen masa për kontrollin e shkëmbimit të informacionit me SKI tjetër;

d) Mbrojtja shumënivelëshe: masat e sigurisë së SKI-ve të implementohen në mënyrë të tillë që të ketë më shumë se një nivel mbrojtjeje;

dh) Përditësimi i masave të sigurisë: Rishikim i implementimit dhe efektivitetit të masave të sigurisë së SKI-ve në varësi të ndryshimeve në mjedisin e kërcënimeve dhe dobësive;

e) Akreditimi i SKI-ve: akreditimi i SKI-ve përshtatshmërisht me nivelin e informacionit që trajtohet në to.

2. AKAS-i verifikon aplikimin e këtyre kriterëve dhe implementimin e vazhdueshëm të standardeve të sigurisë.

PJESA I QEVERISJA E SIGURISË SË INFORMACIONIT

KREU I ROLET DHE PËRGJEGJËSITË PËR SIGURINË E SKI-ve

Neni 7

Rolet dhe përgjegjësitë

1. Autoriteti i Operimit të Sistemit (AOS) janë institucionet shtetërore përcaktuar si autoritet klasifikues në kuptim të ligjit për informacionin e klasifikuar, përgjegjëse për planifikimin, përcaktimin e nevojës për SKI dhe përdorimin e SKI-ve.

2. Operatorët ekonomikë, gjatë realizimit të kontratave që përmbajnë informacion të klasifikuar, kur autorizohen për përdorimin e SKI-ve të tyre nga autoriteti kontraktor kanë të njëjtat detyrime e përgjegjësi si Autoriteti i Operimit të Sistemit dhe Administratorit të SKI-ve.

3. Institucionet shtetërore dhe operatorët ekonomikë caktojnë oficerin ose strukturën e sigurisë së SKI-ve, përgjegjës për mbikëqyrjen e

aspekteve të sigurisë së SKI-ve, përcaktuar në këtë rregullore.

4. Roli i administratorit të SKI-ve në institucionet apo organet e administratës shtetërore nën përgjegjësinë e Këshillit të Ministrave, kryhet sipas ligjit nr. 43/2023, “Për qeverisjen elektronike”.

5. Institucionet shtetërore që nuk përfshihen në pikën 4, të këtij neni, ndajnë rolet dhe përgjegjësitë e AOS-it dhe të Administratorit të SKI-ve bazuar në strukturën organizative të institucionit.

6. Subjektet e përcaktuara në këtë nen kryejnë detyrat e përcaktuara në këtë rregullore.

Neni 8

Detyrat e Autoritetit të Operimit të Sistemit AOS

AOS-i ka këto detyra:

a) Përcakton kërkesat funksionale të SKI-ve;

b) Përcakton mënyrën e sigurisë së operimit të sistemit;

c) Kërkon akreditimin e SKI-ve mbështetur në përcaktimet e kësaj rregulloreje;

ç) Miraton dokumentacionin e sigurisë së sistemit;

d) Miraton kërkesat operacionale dhe funksionale të ndërlidhjes së sistemeve;

dh) Pranon riskun e mbetur, që rezulton nga procesi i menaxhimit të riskut të sigurisë;

e) Cakton ose emëron Oficerin e Sigurisë së SKI-ve;

ë) Njofton AKAS-in për ndryshimet në sistem që në fazën e planifikimit të tyre;

f) Dërgon tek AKAS-i kërkesën për riakreditimin e sistemit 4 muaj para afatit të përfundimit të vlefshmërisë së akreditimit.

Neni 9

Detyrat e Oficerit të Sigurisë së SKI-ve

Oficeri i Sigurisë së SKI-ve ka këto detyra:

a) Siguron që të gjitha SKI-të në përdorim, si dhe projektet e SKI-ve që mbështesin misionin dhe detyrat e institucionit janë në përputhje me përcaktimet e kësaj rregulloreje;

b) Harton konceptin e operimit të SKI-ve, në bashkëpunim me administratorin e SKI-ve;

c) Harton procedurat e operimit të sigurt për SKI në përdorim dhe siguron njohjen e tyre nga përdoruesit e sistemit;



ç) Këshillon për sigurinë e SKI-ve dhe trajnon administratorët dhe përdoruesit e sistemit, përfshirë nivelet drejtuese, për aspektet e sigurisë së SKI-ve bazuar në programet e edukimit të personelit;

d) Harton planin e menaxhimit të riskut në bashkëpunim me Administratorin e SKI-ve;

dh) Harton planin e përgjigjes ndaj incidenteve dhe procedurat në rastet e emergjencave në bashkëpunim me Administratorin e SKI-ve;

e) Mbikëqyr ekzekutimin e vlerësimeve periodike të sigurisë së SKI-ve (p.sh.: vlerësim risku, testim dhe vlerësim i sigurisë, inspektim i sigurisë, vlerësim i dobësive, auditim);

ë) Raporton te titullari i AOS-it për mangësitë dhe dobësitë e konstatuara, që lidhen me sigurinë e SKI;

f) Në bashkëpunim me Administratorin e SKI-ve, raporton tek AKAS-i për incidentet dhe masat e marra;

g) Menaxhon materialin kriptografik që ka në përdorim, në përputhje me këtë rregullore;

gj) Mirëmban inventarin e pajisjeve, komponentëve, produkteve dhe aplikacioneve të SKI-ve;

h) Harton procedura të detajuara për pastrimin dhe shkatërrimin e komponentëve memorizues të pajisjeve TIK;

i) Harton skemën e kontrollit të aksesit, ku përcaktohen atributet e çdo entiteti që ka qasje në SKI apo në informacionin e klasifikuar që trajtohet në të, bazuar në parimin “nevojë për njohje”, si dhe duke autorizuar e lejuar privilegjet që nevojiten për kryerjen e detyrave.

Neni 10

Detyrat e Administratorit të SKI-ve

Administratori i SKI-ve ka këto detyra:

a) Dërgon për miratim tek AOS projektet, ndryshimet teknike të SKI-ve, pas paraqitjes së kërkesës;

b) Implementon teknikisht skemën e shtrirjes së SKI-ve në zonat e sigurisë në bashkëpunim me Oficerin e Sigurisë së SKI-ve;

c) Përgjigjet për mbarëvajtjen e SKI-ve;

ç) Merr pjesë në procesin e menaxhimit të riskut;

d) Raporton tek Oficeri i Sigurisë së SKI-ve për mangësitë dhe dobësitë e konstatuara që lidhen me sigurinë e SKI-ve;

dh) Përgjigjet për anën teknike të Deklaratës së Kërkesave të Sigurisë së Sistemit, Procedurat e Testimit dhe Vlerësimit të Sigurisë (PVTS).

Neni 11

Autoriteti Kombëtar i Akreditimit të Sigurisë (AKAS)

Autoriteti Kombëtar i Akreditimit të Sigurisë ka këto detyra:

a) Shqyrton kërkesat për akreditimin e sistemeve;

b) Bashkëpunon dhe koordinon punën me autoritetet e sigurisë së SKI-ve për akreditimin e sigurisë së SKI;

c) Harton e miraton Planin e Akreditimit të Sigurisë së Sistemit (PASS);

ç) Verifikon zbatimin e masave të sigurisë për mbrojtjen e informacionit të klasifikuar gjatë përpunimit, ruajtjes ose transmetimit në sistemet e komunikimit dhe të informacionit nga cenimi aksidental ose i qëllimshëm i objektivave të sigurisë:

i. Verifikon zonat e sigurisë ku është instaluar dhe operon sistemi;

ii. Verifikon nëse përdoruesit e sistemit janë të pajisur me certifikata sigurie;

iii. Verifikon nëse aplikohen aspekte të sigurimit industrial;

iv. Verifikon nëse aplikohen marrëveshje sigurie me struktura të tjera brenda apo jashtë vendit;

v. Verifikon dokumentacionin e sigurisë së sistemit;

vi. Verifikon zbatimin e kërkesave të sigurisë së komunikimeve, sigurisë kriptografike dhe sigurisë së emetimeve, nëse aplikohen, në bashkëpunim me autoritetet e sigurisë;

vii. Inspekton MSG dhe MSL;

viii. Verifikon nëse masat e sigurisë së sistemit janë në përputhje me Planin e Menaxhimit të Riskut;

d) Analizon dhe vlerëson gjendjen e sigurisë së sistemit në varësi të dokumentacionit të sigurisë së sistemit, dokumenteve të lëshuara nga autoritetet e sigurisë dhe rezultateve të inspektimeve;

dh) Pranon riskun e mbetur të sistemit dhe harton aktvlerësimin për zbatimin e masave të sigurisë;

e) Lëshon deklaratën e akreditimit, që autorizon sistemin për të trajtuar informacion të klasifikuar; Kjo deklaratë lëshohet bazuar në vlerësimin pozitiv të sigurisë së SKI;



ë) Menaxhon databazën e sistemeve të klasifikuara kombëtare, të NATO-s, të shteteve dhe të organizatave të huaja të akredituara nga AKAS-i.

Neni 12

Autoriteti Kombëtar i Testimit dhe Vlerësimit të Sigurisë (AKTVS)

Autoriteti Kombëtar i Testimit dhe Vlerësimit të Sigurisë ka këto detyra:

a) Përcakton komponentët specifikë të sistemit që duhet të testohen dhe të vlerësohen, masat e sigurisë dhe pritshmëritë për secilin element;

b) Përzgjedh, përgatit dhe miraton procedurat, metodat dhe mjetet e testimit dhe vlerësimit të komponentëve specifikë të sistemit;

c) Përcakton rregullat për auditimin e implementimit të kërkesave të sigurisë në sistem dhe vlerësimin e operimit korrekt të masave të sigurisë të implementuara në sistem;

ç) Vlerëson nivelin e përputhshmërisë së dokumentacionit të sistemit dhe zbatimit në praktikë të masave të deklaruara në dokumentacion për MSE;

d) Në bashkëpunim me AOS-in, Administratorin e SKI-ve teston dhe vlerëson dobësitë e SKI-ve;

dh) Kontribuon në vlerësimin e riskut të sigurisë së sistemit;

e) Kryen dokumentimin e saktë të procedurave dhe rezultateve të testimit dhe gjeneron raportin e vlerësimit të sigurisë;

ë) Mbikëqyr AOS-in, Administratorin e SKI-ve në zbatimin e udhëzimeve për realizimin e auditimit të sigurisë;

f) Menaxhon databazën e sistemeve të testuara dhe vlerësuara nga AKAS-i.

Neni 13

Autoriteti Kombëtar i Sigurisë së Komunikimeve (AKSK)

Autoriteti Kombëtar i Sigurisë së Komunikimeve ka këto detyra:

a) Përcakton kërkesat e sigurisë specifike për sistemet, produktet dhe mekanizmat kriptografikë dhe kontrollon zbatimin e tyre nga institucionet shtetërore;

b) Përcakton procedurat për përzgjedhjen, operimin dhe mirëmbajtjen e sistemeve, produkteve

dhe mekanizmave kriptografikë dhe kontrollon zbatimin e tyre nga institucionet shtetërore;

c) Administron infrastrukturën e materialit kriptografik të pajisjeve/sistemeve të përzgjedhura;

ç) Vlerëson sistemet, produktet dhe mekanizmat kriptografikë dhe harton aktvlerësimin përkatës dhe ia përcjell AKAS-it në funksion të procesit të akreditimit të sigurisë;

d) Inspekton strukturat kriptografike në institucionet shtetërore për masat për zbatimin e mbrojtjes kriptografike të informacionit të klasifikuar, instalimin, ruajtjen dhe mirëmbajtjen e pajisjeve, sistemeve dhe incidentet kriptografike;

dh) Menaxhon databazën e sistemeve, produkteve dhe mekanizmave kriptografikë të vlerësuar dhe që përdoren nga institucionet shtetërore.

Neni 14

Autoriteti Kombëtar i Shpërndarjes Kriptografike (AKSHK)

Autoriteti Kombëtar i Shpërndarjes Kriptografike ka këto detyra:

a) Administron materialet kriptografike që përdoren për mbrojtjen e informacionit të klasifikuar;

b) Mban databazën e pajisjeve dhe programeve kriptografike, materialit çelës, dokumenteve e procedurave përkatëse për menaxhimin e tyre;

c) Shpërndan materialin kriptografik në institucionet shtetërore;

ç) Administron sistemet e shkëmbimit elektronik të çelësve kriptografikë dhe të llogarisë së materialit kriptografik kombëtar, të NATO-s, BE-së, shteteve dhe organizatave të tjera ndërkombëtare;

d) Zbaton rregullat e sigurimit fizik dhe elektronik, sipas akteve nënligjore në fuqi për ruajtjen e materialit kriptografik;

dh) Siguron që materiali kriptografik të jetë në çdo kohë në kushte pune;

e) Shkatërron materialin kriptografik, sipas rregullores kur është e nevojshme;

ë) Harton procedurat që duhen ndjekur për raportimin e incidenteve;

f) Harton procedurat që duhen ndjekur në rastet e emergjencës;

g) Siguron që i gjithë personeli që ka akses në materialin kriptografik është i autorizuar, i certifikuar dhe i trajnuar, sipas akteve nënligjore në fuqi.



Neni 15

Autoriteti Kombëtar TEMPEST (AKT)

Autoriteti Kombëtar TEMPEST ka këto detyra:

a) Harton politika, standarde e procedura për mbrojtjen nga emetimet elektromagnetike komprometuese;

b) Përzgjedh, siguron dhe administron pajisjet elektronike për realizimin e matjeve TEMPEST të ambienteve dhe pajisjeve;

c) Kryen periodikisht matjet TEMPEST dhe përgatit raportin me rezultatet e matjeve për AKAS dhe institucionet përkatëse;

ç) Kontrollon dhe rekomandon masat që duhen zbatuar për të mënjeluar riskun nga emetimet elektromagnetike komprometuese;

d) Mban databazën me historikun e rezultateve të matjeve TEMPEST.

KREU II

MENAXHIMI I RISKUT TË SIGURISË SË INFORMACIONIT

Neni 16

Procesi i menaxhimit të riskut

1. Procesi i menaxhimit të riskut të sigurisë kryhet për monitorimin, reduktimin, eliminimin, shmangien ose pranimin e risqeve që lidhen me SKI.

2. Procesi i menaxhimit të riskut përfshin:

a) identifikimin dhe vlerësimin e aseteve;

b) identifikimin e agjentëve kërcënues (person, proces kompjuterik, pajisje etj.);

c) identifikimin e kërcënimeve që vijnë si pasojë e veprimt të agjentëve;

ç) identifikimin e dobësive që mund të shfrytëzohen nga agjentët kërcënues;

d) identifikimin e riskut;

dh) vlerësimin e masave ekzistuese të sigurisë;

e) vlerësimin e riskut ose përcaktimin e nivelit të riskut;

ë) identifikimin e masave përkatëse për monitorimin, reduktimin, eliminimin, shmangien ose pranimin e riskut;

f) përcaktimin e riskut të mbetur;

g) dokumentimin e riskut të sigurisë, si dhe procesin e menaxhimit të tij në planin e menaxhimit të riskut.

Neni 17

Risku i mbetur

1. Risku i sigurisë, që konsiderohet si i pranueshëm, miratohet nga AKAS gjatë procesit të akreditimit të sigurisë së SKI-ve dhe mbahet nën monitorim të vazhdueshëm nga Autoriteti i Operimit të Sistemit dhe Administratori i SKI.

2. Risku i sigurisë që konsiderohet si i papranueshëm duhet të trajtohet nëpërmjet aplikimit të masave shtesë ose masave alternative të sigurisë.

KREU III

DOKUMENTACIONI I SIGURISË SË SISTEMIT

Neni 18

Dokumentacioni i sigurisë së sistemit

1. Dokumentacioni i sigurisë së sistemit është tërësia e dokumenteve që kërkohen për akreditimin e sigurisë së SKI-ve dhe shërben si standard për vlerësimin e tij.

2. Dokumentacioni i sigurisë së sistemit:

a) Dokumentacioni i sigurisë së sistemeve hartohet në përputhje me modelet e përcaktuara nga AKAS;

b) I vihet në dispozicion personelit që ka akses në sistem, në përputhje me nevojën për njohje;

c) Përditësohet rregullisht.

3. Dokumentacioni i sigurisë së sistemit përbëhet nga:

a) koncepti i operimit (KO);

b) deklarata e kërkesave të sigurisë së sistemit (DKSS);

c) procedurat e operimit të sigurt (POS);

ç) plani i menaxhimit të riskut (PMR);

d) procedurat e testimit dhe vlerësimit të sigurisë (PVTS);

dh) plani i përgjigjes ndaj incidenteve;

e) procedurat në rastet e emergjencave;

ë) urdhri për ndarjen e zonave të sigurisë;

f) skema e shtrirjes së SKI-ve në Zonat e Sigurisë;

g) procedura për pastrimin dhe/ose shkatërrimin e pajisjeve TIK.

4. Për rastet kur sistemi është i përbërë nga një kompjuter *stand alone* dhe pajisje periferike të lidhura me të (printer, skaner), dokumentet KO, DKSS dhe



PMR lejohet të përmbliidhen në një dokument të vetëm.

Neni 19

Kërkesa shtesë për dokumentacionin

1. AKAS-i ka të drejtë të kërkojë dokumente shtesë, në përputhje me politikën e sigurisë së NATO-s, BE-së, shteteve dhe organizatave të huaja me të cilat Republika e Shqipërisë ka marrëveshje sigurie, në varësi të SKI-ve.

2. Për sistemet e shteteve ose organizatave ndërkombëtare dokumentet plotësohen në 2 kopje, një në gjuhën angleze dhe një në gjuhën shqipe.

KREU IV AKREDITIMI I SIGURISË SË SKI

Neni 20

Të përgjithshme

1. Sistemet që trajtojnë informacion të klasifikuar akreditohen në përputhje me kërkesat e përcaktuara në këtë rregullore.

2. Procesi i akreditimit të sigurisë përcakton nivelin e përshtatshëm të mbrojtjes së sistemit, si dhe identifikon e pranon riskun e mbetur, që duhet të monitorohet përgjatë jetëgjatësisë së sistemit.

3. AKAS mban, administron dhe përditëson të dhënat, ku pasqyrohen kërkesat për akreditim dhe statusi i akreditimit të SKI-ve kombëtare dhe shteteve apo organizatave ndërkombëtare.

Neni 21

Mjediset e sigurisë së sistemeve

1. Ndarja e mjedisëve të sigurisë së sistemeve bëhet me qëllim përcaktimin e përgjegjësive për sigurinë e SKI-ve.

2. Mjediset e sigurisë së sistemeve janë:

a) Mjedisi i Sigurisë Globale (MSG) përfaqëson zonën e sigurisë, ku ndodhet sistemi, por që është jashtë kontrollit të AOS. MSG përfshin aspektet e sigurisë së ndërtesës, vendndodhjen gjeografike, sigurinë e ndërlikimit të sistemeve dhe mjedisin e përgjithshëm të kërcënimeve;

b) Mjedisi i Sigurisë Lokale (MSL) është zona e sigurisë nën ndikimin e AOS. MSL përfshin masat e sigurimit fizik, sigurisë së personelit, sigurisë së informacionit dhe sigurisë procedurale;

c) Mjedisi i Sigurisë Elektronike (MSE) është zona e sigurisë që përfshin mekanizmat e sigurisë elektronike të SKI-ve të implementuar brenda arkitekturës së sigurisë së SKI-ve dhe që ofrojnë funksionet e nevojshme të sigurisë. MSE përfshin:

i. ndërfaqet individ–makinë;

ii. ndërfaqet e brendshme (ndërfaqet ndërmjet pjesëve të SKI-ve që përfaqësojnë klasa të ndryshme të sigurisë p.sh. particionet e sigurisë në sistem);

iii. ndërfaqet e jashtme (*firewall, gateway* etj.).

Neni 22

Mënyrat e sigurisë së operimit të sistemit

1. SKI-të që trajtojnë informacion të klasifikuar në nivel “konfidencial” e lart operojnë në një nga mënyrat e mëposhtme të sigurisë:

a) Mënyrë e dedikuar në të cilën të gjithë individët me të drejtë akses në SKI janë të certifikuar në nivelin më të lartë të klasifikimit që trajtohet në SKI dhe me nevojë të përbashkët për njohje për të gjithë informacionin që trajtohet në SKI;

b) Mënyrë e lartë në të cilën të gjithë individët me të drejtë akses në SKI janë të certifikuar në nivelin më të lartë të klasifikimit që trajtohet në SKI, por jo të gjithë individët kanë të njëjtën nevojë për njohje për informacionin që ruhet, përpunohet ose transmetohet në sistem. Miratimi për akses në informacionin që trajtohet në sistem jepet në nivel individual sipas funksionit që ka individ;

c) Mënyra me shumë nivele në të cilën jo të gjithë individët me të drejtë akses në SKI janë të certifikuar në nivelin më të lartë të klasifikimit që trajtohet në SKI dhe jo të gjithë individët me të drejtë akses në SKI kanë të njëjtën nevojë për njohje me informacionin që ruhet, përpunohet ose transmetohet në sistem.

2. SKI-të që trajtojnë informacion të klasifikuar në nivel “i kufizuar” operojnë në një nga mënyrat e mëposhtme të sigurisë:

a) Mënyrë e dedikuar, në të cilën të gjithë individët me të drejtë akses në SKI kanë të njëjtën nevojë për njohje për informacionin që trajtohet në SKI;

b) “Mënyra e lartë” është mënyra e operimit në të cilën jo të gjithë individët kanë të njëjtën nevojë për njohje për informacionin që trajtohet në SKI. Miratimi për akses në informacionin që trajtohet në SKI jepet në nivel individual, sipas funksionit që ka individ.



Neni 23

Bazat e akreditimit të sigurisë

Bazë për akreditimin e sigurisë së SKI-ve konsiderohet, si më poshtë vijon:

1. Vlerësimi i arkitekturës së sigurisë së sistemit;
2. Vlerësimi i dokumentacionit të sigurisë së sistemit;
3. Verifikimi i implementimit dhe efektivitetit të masave të sigurisë së SKI-ve;
4. Analiza e riskut të mbetur dhe proceseve për menaxhimin e vazhdueshëm të riskut të sigurisë;
5. Monitorimi i vazhdueshëm i statusit të sigurisë së SKI-ve.

Neni 24

Procesi i akreditimit të sigurisë

1. Procesi i akreditimit të sigurisë është tërësia e hapave që ndërmerren për të përcaktuar nëse masat e sigurisë së sistemit janë implementuar sipas kërkesave të kësaj rregulloreje. Procesi i akreditimit të sigurisë është mekanizmi që garanton sigurinë e SKI.

2. Procesi i akreditimit të sigurisë ndryshon në varësi të arkitekturës së SKI, në përputhje me këtë rregullore.

3. Procesi i akreditimit kalon në fazat si më poshtë:

- a) fillimi i procesit;
- b) verifikimi i sistemit;
- c) miratimi;
- ç) aktivitetet pas akreditimit.

Neni 25

Fillimi i procesit

1. Fillimi i procesit të akreditimit ka si objektivi njohjen me misionin e sistemit, përshkrimin e aspekteve funksionale dhe arkitekturën e sigurisë së sistemit, me qëllim përcaktimin e kërkesave për akreditimin e sistemit.

2. Kjo fazë përfshin këto aktivitete:

- a) Iniciumi i kërkesës:
 - i. Kërkesa për akreditimin e sistemit drejtuar AKAS, duhet të përfshijë përshkrimin e sistemit sipas konceptit të operimit;
 - ii. Pas marrjes së kërkesës, AKAS-i e konsideron procesin e akreditimit të hapur dhe kërkon shpjegime të nevojshme ose korrigjime, nëse nevojitet;

iii. Në rastet e kërkesës për riakreditim dërgohet versioni i fundit i Konceptit të Operimit;

b) Negociumi:

i. Për çdo kërkesë akreditimi AKAS-i përcakton procesin e akreditimit në PASS;

ii. AOS-i raporton tek AKAS-i çdo lloj kushti shtesë (operacional, komercial ose strategjik), nëse ka, për t'u marrë në konsideratë nga AKAS-i për t'i dhënë prioritet akreditimit të këtij sistemi në fazat pasardhëse të procesit;

c) Implementimi dhe dokumentimi i masave të sigurisë:

i. pas miratimit të konceptit të operimit merren masa për përgatitjen e dokumentacionit të sigurisë së sistemit, si dhe identifikimin e përmbyshjen e aktiviteteve për akreditimin e sistemit;

ii. dokumentacioni i sigurisë së sistemit, së bashku me dokumente të tjera shtesë për aspekte të sigurisë së informacionit, personelit, fizike dhe sigurimit industrial, dërgohet tek AKAS-i për miratim.

Neni 26

Verifikimi i sistemit

1. Verifikimi ka si objektivi rishikimin e dokumentacionit të sigurisë së sistemit dhe verifikimin e masave të sigurisë së sistemit, me qëllim konfirmimin e sigurisë së sistemit dhe identifikimin e kërkesave të sigurisë që nuk janë përmbyshur dhe dobësitë e sistemit.

2. Verifikimi i masave të sigurisë së sistemit kryhet me një nga këto metoda:

- a) testim;
- b) ekzaminim;
- c) intervistim.

3. Autoritetet e sigurisë kryejnë verifikimin e masave të sigurisë në përputhje me PASS dhe dokumentojnë rezultatet dhe riskun e mbetur në raportet përkatëse.

4. Sistemi dhe dokumentacioni përditësohen me rekomandimet e rezultateve të verifikimit.

Neni 27

Auditimi i sigurisë

1. Auditimi i sigurisë është një proces sistematik i rishikimit të sigurisë të implementuar në SKI, me qëllim identifikimin e dobësive dhe mundësive që çojnë në komprometimin e objektivave të sigurisë.



Proceset e auditimit kryhen si pjesë e procesit të vazhdueshëm të menaxhimit të riskut apo si pjesë e procesit të akreditimit të sigurisë së sistemit kur përcaktohet në PASS.

2. Të gjitha SKI-të ku trajtohet informacion i klasifikuar “Sekret shtetëror” janë subjekt i auditimit të sigurisë nën drejtimin dhe miratimin e AKAS-it.

3. Qëllimi dhe procesi i auditimit të sigurisë përcaktohet qartë dhe dokumentohet.

4. Proceset e auditimit të sigurisë kryhen në përputhje me udhëzimin e miratuar nga drejtori i përgjithshëm i AKAS-it.

Neni 28 Miratimi

1. Miratimi ka si objektiv autorizimin e sistemit për të operuar brenda kushteve të sigurisë.

2. AKAS-i vendos për:

a) lëshimin e Deklaratës së Akreditimit të Sigurisë për një periudhë të caktuar kohore për mjedisin e planifikuar operacional, në të cilin përmbushen të gjitha kërkesat e sigurisë. Deklarata e Akreditimit të Sigurisë përcakton kushtet nën të cilat është i vlefshëm akreditimi i sigurisë. Periudha e vlefshmërisë së akreditimit ndryshon në varësi të nivelit të klasifikimit, si më poshtë:

- i. tepër sekret ose ekuivalent – 2 vjet;
- ii. sekret ose ekuivalent – 3 vjet;
- iii. konfidencial ose ekuivalent – 4 vjet;
- iv. i kufizuar ose ekuivalent – 5 vjet;

b) lëshimin e Deklaratës së Përkohshme të Akreditimit të Sigurisë për një periudhë të caktuar kohore për mjedisin e planifikuar operacional, në të cilin nuk janë përmbushur të gjitha kërkesat e sigurisë. Deklarata e Përkohshme e Akreditimit të Sigurisë përcakton periudhën e vlefshmërisë, si dhe kushtet dhe aktivitetet që duhen kryer për të kaluar në Deklaratë të Akreditimit të Sigurisë;

c) lëshimin e Autorizimit për Operim të Kufizuar nëse procesi i akreditimit nuk ka mbaruar. Ky lloj autorizimi lëshohet vetëm në rrethana të jashtëzakonshme deri në gjashtë muaj, pa të drejtë shtyrjeje, kur kërkesat operationale tejkalojnë kërkesat e sigurisë. Për këtë lloj autorizimi duhet më parë të miratohet koncepti i operimit;

ç) refuzimin e akreditimit të sigurisë duke treguar mangësitë specifike dhe masat korrigjuese. AKAS-i kërkon hartimin e planit të veprimit për marrjen e masave korrigjuese;

d) shfuqizimin e akreditimit ekzistues të sigurisë, duke treguar mangësitë specifike dhe masat korrigjuese. AKAS-i kërkon hartimin e planit të veprimit për marrjen e masave korrigjuese.

3. Akreditimi i sistemeve që trajtojnë informacion të klasifikuar të NATO-s, BE-së apo shteteve e organizatave të tjera ndërkombëtare bëhet në përputhje me marrëveshjet e sigurisë për mbrojtjen e ndërsjellë të informacionit të klasifikuar, si dhe duke aplikuar këtë rregullore në të gjitha aspektet e mundshme.

Neni 29

Aktivitetet pas akreditimit

1. Aktivitetet pas akreditimit fillojnë pasi sistemi është autorizuar për operim.

2. Kjo fazë përfshin këto aktivitete:

a) Përdorimi i sistemit:

i. Sistemi operon dhe ruan kushtet e sigurisë nën të cilat u bë i mundur lëshimi i DAS.

ii. AKAS-i mbikëqyr sigurinë e SKI-ve nën përgjegjësinë e saj nëpërmjet verifikimeve periodike të sigurisë, auditimeve të sigurisë për të garantuar që sistemet e akredituara trajtojnë informacion të klasifikuar në të njëjtat kushte sigurie në të cilat u dha akreditimi;

b) Riakreditimi, i cili kryhet në këto raste:

i. Pas përfundimit të periudhës së vlefshmërisë së Deklaratës së Akreditimit të Sigurisë, sistemi nuk është i autorizuar të trajtojë informacion të klasifikuar;

ii. Nëse ndodhin ndryshime në sistem që ndikojnë në kushtet e sigurisë të tilla si:

- Ndryshimet në nivelin e informacionit të klasifikuar që trajtohet në SKI;

- Ndryshimet në kërkesat e sigurisë që vijnë si pasojë e ndryshimeve të legjislacionit për sigurinë e informacionit të klasifikuar;

- Ndryshimet në arkitekturën e sistemit;

- Ndryshimet në konfigurimet e sigurisë së SKI-ve;

- Ndryshimet në kërkesat operationale;

- Identifikimi i kërcënimeve ose dobësive të reja në sisteme;

- Identifikimi i mosfunksionimit të masave të sigurisë;

- Përhapja e një incidenti të rëndë të sigurisë kompjuterike ose të sigurisë në përgjithësi dhe që ndikon në akreditimin e sigurisë së sistemit;



- Ndryshimet e rëndësishme në strukturën fizike të ndërtesës ose të POS;

c) Nxjerrja jashtë përdorimit e sistemit:

i. Të merren masa për arkivimin ose deklasifikimin ose shkatërrimin e SKI-ve dhe informacionit që ruhet në të, si dhe raportimin tek AKAS-i që në fazën e planifikimit të nxjerrjes jashtë përdorimit;

ii. Procedurat që do të ndiqen përcaktohen në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe dokumentet e sigurisë së sistemit.

PJESA II KËRKESAT E SIGURISË SË SISTEMEVE

KREU I SIGURIA FIZIKE E SISTEMEVE

Neni 30

Mjediset dhe infrastruktura e rrjetit

1. Për mbrojtjen e sistemeve aplikohen masa të sigurisë fizike në mjediset dhe infrastrukturën e rrjetit.

2. Sistemet ku trajtohet informacion i klasifikuar “Konfidencial” e lart instalohen dhe operojnë në zona sigurie të klasit I ose II.

3. Sistemet ku trajtohet informacion i klasifikuar “I kufizuar” kur nevoja operationale kërkon operimin e tyre jashtë zonave të sigurisë, instalohen minimalisht në zonë administrative.

4. Në rastet e shkëmbimit të informacionit të klasifikuar në formë elektronike jashtë zonave të sigurisë aplikohet mbrojtja kriptografike e informacionit.

Neni 31

Sigurimi fizik i serverëve dhe pajisjeve të komunikimit

1. Serverët dhe pajisjet e komunikimit vendosen në ambiente të veçanta të ndara nga zyrat e përdoruesve.

2. Sallat e serverëve dhe pajisjeve të komunikimit vendosen në zona sigurie të klasit I.

3. Sallat e serverëve dhe pajisjeve të komunikimit, si dhe *rack*-et sigurohen nga aksesit i paautorizuar ose dëmtimet fizike.

4. Çelësat ose mekanizmat ekuivalentë të aksesit të dhomave të serverëve dhe pajisjeve të

komunikimit, si dhe *rack*-eve kontrollohen përshtatshëm.

5. Në ambientet ku administrohen materiale ose sisteme të një rëndësie të veçantë (p.sh. materiale kriptografike) vendosen masa shtesë sigurie, si: përforcimi i integritetit të sigurisë nëpërmjet dy personave, ku të gjitha veprimet dëshmojnë nga minimalisht një person tjetër i kualifikuar. Në këto zona sigurohen të gjitha pikat e hyrjeve dhe daljeve.

Neni 32

Sigurimi fizik i pajisjeve dhe mediave kompjuterike

1. Pajisjet dhe mediat elektronike që ruajnë informacion të klasifikuar regjistrohen në regjistra të veçantë me numër unik identifikimi dhe ruhen në përputhje me kërkesat e sigurisë, si gjatë orarit zyrtar të punës, ashtu edhe jashtë tij.

2. Pajisjet dhe mediat elektronike që ruajnë informacion të klasifikuar administrohen brenda zonave të sigurisë dhe pajisen me çelës për mbrojtjen ndaj ndërhyrjeve të paautorizuara.

3. Në rastet kur nuk është e mundur të aplikohen masat e përshtatshme të sigurimit fizik të pajisjeve dhe mediave kompjuterike, të bëhet fshirja e memories RAM, si dhe të përdoret një nga metodat e mëposhtme:

a) përdorimi i hard diskut të jashtëm, i cili të ruhet në kasafortë jashtë orarit zyrtar të punës;

b) konfigurimi i sistemit për të penguar ruajtjen e të dhënave lokalisht;

c) përdorimi i programeve kriptografike për kriptimin e pajisjeve dhe mediave kompjuterike.

KREU II

SIGURIA E PERSONELIT TË SISTEMEVE

Neni 33

Edukimi për sigurinë e informacionit

Me qëllim njohjen e personelit me rolet dhe përgjegjësitë, pasojat në rast moszbatimi të rregullave të sigurisë, si dhe risqet e mundshme të sigurisë e masat përkatëse, hartohen dhe aplikohen programe të edukimit të personelit për sigurinë e informacionit.



Neni 34

Autorizimi, certifikimi dhe brifimi i personelit

1. Aksesit në sistem lejohet vetëm për personat e autorizuar, të certifikuar përshtatshëmish dhe të brifuar për aksesin në sistem.

2. Në çdo rast:

a) kufizohet aksesit në sistem sipas nevojës për njohje;

b) lejohet aksesit në sistem vetëm pas autorizimit të kërkesës për akses dhe njohjen me procedurat e operimit të sigurt të sistemit;

c) u jepen përdoruesve të drejtat minimale që u nevojiten për kryerjen e detyrave të tyre;

ç) rishikohen autorizimet dhe të drejtat e aksesit të paktën një herë në vit, si dhe kur personeli ndryshon detyrën. Gjatë rishikimit të autorizimeve për akses, të konfirmohet vlefshmëria e nevojës për aksesimin e sistemit, në të kundërt të hiqet e drejta e aksesit;

d) mbahen rekorde të sakta për:

i. të gjithë personelin e autorizuar për të aksesuar sistemin;

ii. personin/personat që dhanë autorizimin për të aksesuar sistemin;

iii. datën e dhënies së autorizimit;

iv. datat e rishikimit të autorizimit;

v. datën e heqjes së autorizimit.

3. Rekordet mbahen gjatë të gjithë jetëgjatësisë së sistemit, në të cilin është lejuar aksesit.

Neni 35

Siguria industriale

Në rastet e prokurimit të mallrave, punëve dhe shërbimeve për sisteme, ku trajtohet informacion i klasifikuar “Sekret shtetëror”, NATO-ja, BE-ja, operatorët ekonomikë që do të ofrojnë produkte ose shërbime të jenë të certifikuar përshtatshëmish me tipin dhe nivelin e informacionit që do të aksesojnë.

KREU III

SIGURIA E KOMUNIKIMEVE

Neni 36

Infrastruktura e komunikimeve (menaxhimi i kablllove)

1. Kabllot grupohen në kanalina, si më poshtë vijon:

a) grupi 1 – kabllot e sistemeve të paklasifikuara;

Faqe | 218

b) grupi 2 – kabllot e sistemeve “I kufizuar”, “Konfidencial” dhe “Sekret”;

c) grupi 3 – kabllot e sistemeve “Tepër sekret”.

2. Fibrat optike, pavarësisht grupit ku bëjnë pjesë, mund të grupohen në të njëjtën kanalinë.

3. Kabllot e informacionit të klasifikuar të përfundojnë në kabinete të veçanta.

4. Në rast të niveleve të ndryshme të klasifikimit, kabinetet të ndahen me pllaka ndarëse për secilin nivel klasifikimi.

5. Kabinetet e sistemeve të klasifikuara të jenë në largësi nga kabinetet e sistemeve të paklasifikuara minimalisht 50 cm.

6. Rrjetet e kabllimit të përfundojnë sa më afër kabineteve.

7. Kabllot etiketohen me numrin unik të identifikimit dhe të shenjzohen në pikat e inspektimit, me shenja dalluese, sipas skemës së mëposhtme:

a) shirit portokalli – “Tepër sekret”;

b) shirit i kuq – “Sekret”;

c) shirit blu – “Konfidencial”;

ç) shirit i bardhë – “I kufizuar”.

8. Prizat e rrjetit etiketohen me nivelin e klasifikimit, numrin e kabllot dhe numrin e prizës së rrjetit.

9. Kabllot dhe prizat e rrjetit dokumentohen në regjistrin e kablllove dhe prizave të rrjetit me numrin përkatës dhe nivelin e klasifikimit. Për secilin kabull dokumentohet burimi dhe destinacioni.

10. Procedura e etiketimit dhe regjistrimit të kablllove dhe prizave të rrjetit dokumentohet në POS.

11. Patch panelet e sistemeve të klasifikuar ndahen fizikisht nga ato të paklasifikuara, duke i instaluar ato në kabinete të veçanta.

Neni 37

Siguria e emetimeve

Sistemet që përdoren për trajtimin e informacionit të klasifikuar “Konfidencial” e lart mbrohen nga emetimet elektromagnetike komprometuese, studimi dhe kontrolli i të cilave referohet si “TEMPEST”, sipas rregullave dhe procedurave.



Neni 38

Sistemet dhe pajisjet e komunikimit
(Pajisjet RF, *infrared* dhe *bluetooth*)

1. Në zonat e sigurisë ndalohet përdorimi i pajisjeve të tilla si:

- a) *access point*;
- b) pajisje periferike me *infrared*, *bluetooth* ose *wireless*;
- c) pajisje RF.

2. Përfshirë bëhet vetëm në rastet kur merret autorizimi nga AKAS-i.

Neni 39

Sistemet dhe pajisjet e komunikimit

1. Për shkëmbimin e informacionit të klasifikuar përdoren pajisje faks të akredituara.

2. Mesazhet faks kriptohen në përputhje me nivelin e informacionit që transmetohet.

3. Pajisjet faks multifunksionale, të lidhura me rrjete kompjuterike të klasifikuara, ndalohet të lidhen drejtpërdrejt me rrjete të telefonisë digjitale të paakredituara përshtatshmërisht.

4. Pajisjet faks multifunksionale të lidhura me rrjete kompjuterike të klasifikuara ndalohen të përdoren për skanimin ose fotokopjimin e dokumenteve në nivel më të lartë klasifikimi.

5. Sistemet dhe pajisjet e radiokomunikimit, që përdoren për komunikim të sigurt, sipas niveleve të miratuara, t'i nënshtrohen procesit të akreditimit nga Autoriteti Kombëtar i Akreditimit të Sigurisë.

Neni 40

Telefonat dhe sistemet telefonike

1. Sistemet telefonike të klasifikuara duhet të akreditohen përshtatshmërisht.

2. Trafiku i të dhënave të klasifikuara të kriptohet përshtatshmërisht.

3. Nuk lejohet përdorimi i telefonave (receptorëve telefonikë) pa kordë për informacionin e klasifikuar, pavarësisht nëse lidhet me pajisje të sigurta telefonike.

KREU IV

SIGURIA E TEKNOLOGJISË SË INFORMACIONIT

Neni 41

Siguria e pajisjeve TIK

1. Në SKI përdoren produkte të vlerësuara sipas një liste të njohur sipas standardeve kombëtare të NATO-s, BE-së, përveç nëse është vlerësuar, pranuar e dokumentuar risku i sigurisë që lidhet me përdorimin e tyre.

2. Kontrollon dokumentacioni i vlerësimit të produktit, përcaktohen kërkesat specifike të produktit dhe përmbushen këto kërkesa për përdorimin e sigurt të produktit.

3. Produktet transportohen në përputhje me legjislacionin për sigurinë e informacionit.

4. Përdorimi i produkteve që ofrojnë funksione sigurie identifikohet gjatë procesit të akreditimit dhe miratohet rast pas rasti nga AKAS-i.

5. AKAS-i mban dhe përditëson listën e produkteve të miratuara.

Neni 42

Kufizime

Ndalohet përdorimi në SKI i produkteve, të cilat nuk janë prodhuar nga vendet e NATO-s, BE-së, që nuk janë pronë e institucionit, pronë e AKSHI-t ose për rastet e akreditimit të SKI-ve për operatorët ekonomikë, pronë e vetë operatorit, me përjashtim të rasteve kur ka marrëveshje sigurie me shtete dhe organizata ndërkombëtare.

Neni 43

Siguria e produkteve
(instalimi dhe konfigurimi i produkteve)

1. Produktet dhe pajisjet TIK etiketohen sipas nivelit më të lartë të informacionit që trajtojnë.

2. Produktet dhe pajisjet TIK etiketohen me numrin unik të identifikimit dhe nivelin e klasifikimit përkatës e shenjzohen me shenja dalluese sipas skemës së mëposhtme:

- a) Shirit portokalli – “Tepër sekret”;
- b) Shirit i kuq – “Sekret”;
- c) Shirit blu – “Konfidencial”;
- ç) Shirit i bardhë – “I kufizuar”.



Neni 44

Siguria e produkteve (mirëmbajtja dhe riparimi i produkteve)

1. Mirëmbajtja dhe riparimi i produkteve dhe pajisjeve të TIK-ut bëhet brenda zonave të sigurisë dhe nga personel i certifikuar përshtatshëm.

2. Kur mirëmbajtja dhe riparimi i produkteve dhe pajisjeve të TIK-ut është e pamundur të bëhet nga personel i certifikuar ose brenda zonave të sigurisë, përmbushen këto detyrime:

a) Dokumentohet rasti dhe nevoja për një ndërhyrje të tillë;

b) Nëse është e mundur, hiqen pjesët e memories dhe deklasifikohet produkti ose pajisja e TIK-ut që do të mirëmbahet apo riparohet përpara ndërhyrjes nga persona të pacertifikuar ose jashtë zonës së sigurisë;

c) Nëse vlerësohet, pastrohet dhe deklasifikohet produkti ose pajisja e TIK-ut që do të mirëmbahet apo riparohet përpara ndërhyrjes për mirëmbajtje ose riparim jashtë zonës së sigurisë;

ç) Personeli teknik që do të kryejë mirëmbajtjen mbikëqyret gjatë të gjithë kohës nga personel i AOS i certifikuar përshtatshëm dhe brifuar.

Neni 45

Pastrimi dhe nxjerrja jashtë përdorimit e pajisjeve TIK

1. Pastrimi i pajisjeve të TIK-ut nënkupton pastrimin e komponentëve memorizues të tyre në mënyrë të pakthyeshme.

2. Komponentët memorizues brenda pajisjeve të TIK-ut janë:

a) komponentë me memorie elektrostатike;

b) memoriet magnetike të qëndrueshme;

c) memoriet me gjysmëpërcjellës;

ç) memoriet e paqëndrueshme.

3. Pas procedurave të pastrimit, pajisjet TIK dhe komponentët e tyre memorizues trajtohen si më poshtë:

Niveli i klasifikimit para pastrimit	Niveli i klasifikimit pas pastrimit
Tepër sekret	Tepër sekret
Sekret	Konfidencial
Konfidencial	I paklasifikuar
I kufizuar	I paklasifikuar

4. Procedurat e pastrimit iniciohen nga pajisje të tjera TIK, të ndryshme nga pajisjet që i nënshtrohen procesit të pastrimit.

5. Rast përjashtimi nga ripërdorimi në rrjet të klasifikuar është kur në komponentët memorizues të pajisjeve TIK është ruajtur çelës kriptografik statik.

Neni 46

Shkatërrimi dhe asgjësimi i pajisjeve TIK

1. Për shkatërrimin e pajisjeve TIK përdoret një nga metodat si në tabelë:

Produkti <i>hardware</i>	Metodat e shkatërrimit					
	Furrë djegieje	Mulli me goditje	Disintegrator /shpërbërës	Grirës/ grimcues	Prerës	<i>Degausser</i> / demagneti zues
Pajisje memorie elektrostатike	PO	PO	PO	PO	JO	JO
<i>Floppy disk</i> magnetik	PO	PO	PO	JO	PO	PO
<i>Hard disk</i> magnetik	PO	PO	PO	PO	JO	PO
Shirit magnetik	PO	PO	PO	JO	PO	PO
Disk optik	PO	PO	PO	PO	PO	JO
Memorie me gjysmëpërcjellës	PO	PO	PO	JO	JO	JO



2. Në rastet e përdorimit të pajisjes *degausser/* demagnetizues për shkatërrim, pajisja duhet të jetë sipas një liste të njohur, sipas standardeve kombëtare të NATO-s, BE-së.

3. Procedura për shkatërrimin e komponentëve memorizues të pajisjeve TIK, mbikëqyret nga të paktën tre punonjës të certifikuar në nivelin e klasifikimit të pajisjeve që po i nënshtrohen kësaj procedure.

Neni 47

Siguria e aplikacioneve (të përgjithshme)

1. Në SKI përdoren aplikacione të licencuara, të miratuara nga AKAS-i.

2. Aplikacionet në përdorim regjistrohen, kontrollohen dhe ruhen për arsye *back up*.

3. Funksionet e sigurisë së aplikacioneve dokumentohen në dokumentet e sigurisë së sistemit (DSS ose POS).

Neni 48

Siguria e aplikacioneve (kufizime)

1. Ndalohen ndryshimet në konfigurimet e aplikacioneve ose në vetë aplikacionin pa miratim paraprak. Nëse këto ndryshime ndikojnë në profilin e sigurisë së sistemit, merret paraprakisht miratimi i AKAS-it.

2. Ndalohet përdorimi i autorizuar dhe i paautorizuar i SKI-ve të aksesojë sistemin duke përdorur kredenciale dhe identitete të tjera.

3. Ndalohet përdorimi i llogarive në grup në sisteme të klasifikuara në nivel “Konfidencial” e lart, që operojnë në mënyrën e lartë të sigurisë ose në mënyrën me shumë nivele. Në SKI-të që operojnë në mënyrën e dedikuar, mund të përdoren llogaritë në grup me kusht që të miratohen nga AKAS-i rast pas rasti. Në çdo rast të merren masat përkatëse për identifikimin, autentifikimin dhe mbajtjen në llogari të individëve që aksesojnë llogaritë në grup.

Neni 49

Mjediset e operimit standard të aplikacioneve

Në mjediset e operimit standard merren masat për:

1. çaktivizimin, riuajtjen ose ndryshimin e fjalëkalimeve të llogarive *default* të sistemeve operative;

2. fshirjen ose çaktivizimin e llogarive të përdoruesve, aplikacioneve, komponentëve, shërbimeve dhe funksionaliteteve të panevojshme në sistem;

3. çaktivizimin e llogarive të administratorëve lokalë dhe përdorimin e llogarive të *domain*-it me të drejta administrative lokale;

4. aktivizimin dhe konfigurimin e funksioneve të sigurisë që ofrojnë aplikacionet;

5. ndjekjen e udhëzimeve të prodhuesve, për konfigurimin e sigurt, përditësimin e produkteve të tyre;

6. përdorimin e metodave të kontrollit të aplikacioneve për kufizimin e ekzekutimit të programeve, *dll*-ve dhe skripteve sipas një liste të miratuar;

7. konfigurimin e mekanizmave të kontrollit të aplikacioneve për gjenerimin e *log*-eve gjatë ndërhyrjeve të dështuara dhe regjistrimin e informacionit në lidhje me skedarët e bllokuar, kohën dhe përdoruesin;

8. përdorimin e sistemeve të parandalimit të ndërhyrjeve *host-based* në serverë që administrojnë informacion të klasifikuar në nivel “Sekret” dhe “Tepër sekret”;

9. përdorimin e aplikacioneve për kontrollin e trafikut të rrjetit;

10. përdorimin e aplikacioneve të kontrollit të pajisjeve periferike për të parandaluar përdorimin e paautorizuar të mediave kompjuterike dhe pajisjeve në kompjuterë dhe serverë;

11. moslejimin e përdoruesve të çaktivizojnë ose tejkalojnë mekanizmat e kontrollit të aplikacioneve;

12. moslejimin e përdoruesve të instalojnë, çinstalojnë ose çaktivizojnë aplikacione;

13. moslejimin e pajisjeve të lidhen njëkohësisht në dy rrjete të ndryshme.

Neni 50

Mbrojtja nga aplikacionet keqdashëse dhe viruset kompjuterike

1. Të përdoren programe kundër aplikacioneve keqdashëse dhe vireseve kompjuterike, dhe të dokumentohen detajet që lidhen me to, përfshirë kërkesat dhe procedurat për përditësim dhe skanim,



si dhe personat përgjegjës për përditësimin e tyre dhe ndjekjen e procedurave të sigurisë.

2. Instruksionet për veprimet që duhen ndërmarrë dhe raportimin e incidenteve që lidhen me infektimet e aplikacioneve keqdashëse dhe viruseve kompjuterike dokumentohen në POS.

Neni 51

Përditësimi (*patching*) i *software*-eve

1. Procedurat e menaxhimit të përditësimeve të sistemeve operative, aplikacioneve, *driver*-ave dhe *firmware* të pajisjeve të përfshihen në POS.

2. Të monitorohen burimet e informacionit për dobësitë e reja dhe përditësimet përkatëse për sistemet operative, aplikacionet, *drive*-rat dhe *firmware* e pajisjeve.

3. Sistemet operative, aplikacionet dhe pajisjet *hardware* që nuk suportohen më nga prodhuesi të zëvendësohen me një version që suportohet nga prodhuesi ose me një version të suportueshëm nga një prodhues tjetër.

Neni 52

Zhvillimi i aplikacioneve

1. Gjatë zhvillimit të aplikacioneve për trajtimin e informacionit të klasifikuar, merren në konsideratë përmbushja e objektivave të sigurisë gjatë të gjithë fazave të zhvillimit të aplikacioneve (disenjimi, zhvillimi, shpërndarja dhe mirëmbajtja).

2. Aplikacionet u nënshtrohen procesit të testimit të sigurisë, menaxhimit të konfigurimeve dhe kontrollit të ndryshimeve.

3. Të mos lejohet akses i paautorizuar në kodin burim të aplikacioneve.

Neni 53

Implementimi i teknologjisë *web* në sistemet e klasifikuara

Gjatë implementimit të shërbimeve *intranet* në SKI:

1. hartohen dhe dokumentohen në POS procedurat për implementimin dhe përdorimin e sigurt të shërbimeve *intranet*;

2. shenjzohen faqet *web* përshtatshëmish me nivelin më të lartë të klasifikimit të informacionit që përmbahet në atë faqe;

3. sigurohet vlefshmëria dhe pastrimi i të gjithë *input*-it në aplikacionet *web*;

4. implementohen kontrollet e sigurisë së shfletuesit për mbrojtjen e aplikacioneve *web* dhe përdoruesve të tyre.

Neni 54

Sistemet e databazave

Në databaza, ku trajtohet informacion i klasifikuar:

1. fshihen të gjithë skedarët dhe *log*-et e përkohshme të instalimit pas instalimit të sistemeve për menaxhimin e databazave;

2. konfigurohen në mënyrë të sigurt sistemet e menaxhimit të databazave në përputhje me udhëzimet e prodhuesit;

3. fshihen të gjitha databazat model që instalohen me sistemin e menaxhimit të databazave;

4. sigurohet ruajtja e fjalëkalimeve të kriptuara me algoritme të forta kriptimi në databaza;

5. aplikohen kontrole aksesi në skedarët e databazave në përputhje me përcaktimet e AOS-it;

6. shenjzohen përshtatshëmish me informacionin e klasifikuar që përmbajnë;

7. ndahen privilegjet e përdoruesve të databazës sipas nevojës për njohje duke u dhënë atyre privilegjet e nevojshme për akses, futje të dhënash, modifikim ose fshirje të dhënash në databazë sipas detyrave përkatëse, në përputhje me përcaktimet e AOS-it;

8. çaktivizohen, rriemërohen ose ndryshohen fjalëkalimet e llogarive *default* të administratorëve;

9. fshihen llogaritë anonime të databazave;

10. ndahen funksionalisht serverët e databazave dhe serverët *web*, nëpërmjet një ndarjeje fizike ose virtuale;

11. vendosen serverët e databazave në një segment rrjeti të ndryshëm nga kompjuterët e përdoruesve;

12. filtrohen të gjithë pyetësorët (*queries*) nga aplikacionet *web* për përmbajtje të ligjshme dhe sintaksë korrekte;

13. përdoren pyetësorë me parametra të caktuar ose procedura të ruajtura në vend të pyetësorëve të gjeneruar automatikisht;

14. kontrollohet, monitorohet qasja te skedarët e databazës

15. disenjohen aplikacione *web* që të ofrojnë sa më pak informacion të sistemit të menaxhimit të



databazave dhe skemave të databazave për përdoruesit gjatë gabimeve që mund të ndodhin në sistem;

16. nuk lejohen ose nuk fshihen të gjitha funksionet dhe procedurat e ruajtura të panevojshme të sistemeve për menaxhimin e databazave;

17. nuk lejohen opsionet e sistemit të menaxhimit të databazave për leximin e filave lokale nga serveri;

18. nuk kryhen aktivitetet e testimit dhe të zhvillimit të databazave në serverët e databazave që janë në përdorim;

19. nuk përdoret informacioni i klasifikuar në mjediset e testimit dhe të zhvillimit të databazave, përveç nëse janë akredituar përshtatshëmish me nivelin më të lartë të informacionit që trajtojnë.

Neni 55

Siguria e *email*-eve

Gjatë implementimit të shërbimeve të postës elektronike në sistemet e klasifikuara:

1. Sigurohet që infrastruktura e postës elektronike të jetë pjesë e sistemit të klasifikuar dhe të mos ketë lidhje me sisteme të tjera të paakredituara përshtatshëmish.

2. Dokumentohen procedura në POS për përdorimin e sigurt të postës elektronike të klasifikuar.

3. Shenjëzohen mesazhet e postës elektronike, në përputhje me nivelin e informacionit që mesazhi përmban dhe nivelin e informacionit të dokumenteve bashkëlidhur.

Neni 56

Kontrolli i aksesit

1. Për kontrollin e aksesit në SKI përcaktohet skema e kontrollit të aksesit, ku përshkruhen atributet e çdo entiteti që ka qasje në SKI apo në informacionin e klasifikuar që trajtohet në të, bazuar në parimin “nevojë për njohje”, si dhe duke autorizuar dhe lejuar privilegjet që nevojiten për kryerjen e detyrave.

2. Skema e kontrollit të aksesit hartohet sipas një modeli që siguron:

a) Administrimin e entiteteve dhe attributeve, privilegjeve dhe kredencialeve të tyre gjatë të gjithë jetëgjatësisë së tyre;

b) Shërbimet e autentifikimit dhe në varësi të rezultateve të raportit të vlerësimit të riskut, implementimin e një metode të kombinuar autentifikimi;

c) Auditimin e aksesit të informacionit nga përdoruesit, shërbimet e SKI-ve;

ç) Kufizimin sipas parimit nevojë për njohje dhe monitorimin e llogarive të përdoruesve me të drejta të privileguara;

d) Auditimin e përdoruesve dhe aktiviteteve të SKI-ve;

dh) Parandalimin e vjedhjes së kredencialeve, si dhe ripërdorimit të tyre nga persona të paautorizuar;

e) Mbështetjen e investigimit të incidenteve dhe auditimit të sigurisë.

3. Në varësi të rezultateve të raportit të vlerësimit të riskut, implementohet një metodë e kombinuar autentifikimi për përdoruesit e privilegjuar, si:

a) administrator sistemi;

b) administrator *database*-i;

c) përdorues me të drejta jo të kufizuara;

ç) përdorues me të drejta të aksesit në largësi;

d) përdorues.

Neni 57

Auditimi dhe ruajtja e *log*-eve të sigurisë

1. Në çdo SKI ruhen dhe auditohen ngjarje që lidhen me:

a) veprimet e privileguara;

b) shtimin, fshirjen dhe modifikimin e të drejtave të aksesit të përdoruesve dhe grupeve;

c) përpjekjet e dështuara për akses/qasje në sisteme dhe *fil*-e kritike;

ç) paralajmërime (*alert*) dhe dështime që lidhen me sigurinë e sistemit;

d) hyrjet dhe/ose daljet në sistem;

dh) përpjekjet e dështuara për hyrje në sistem.

2. Për çdo ngjarje ruhet:

a) data dhe ora e ngjarjes;

b) përdoruesi apo procesi që lidhet me ngjarjen;

c) përshkrimi i ngjarjes;

ç) dështimi apo sukcesi i ngjarjes;

d) burimi i ngjarjes (p.sh. emri i aplikacionit);

dh) vendndodhja/identifikimi i pajisjes, ku ka ndodhur.

3. Këto rekorde ruhen sipas një periudhe të rënë dakord ndërmjet AKAS-it dhe AOS-it të specifikuar në DSS-në dhe POS-në përkatëse. Për



informacionin e klasifikuar në nivel “Tepër sekret” kjo periudhë të jetë minimalisht 5 vjet.

4. Informacioni i auditimit të mbrohet nga aksesit, ndryshimi ose fshirja e paautorizuar.

Neni 58

Menaxhimi i rrjetit

1. Rrjetet menaxhohen në mënyrë të përqendruar.

2. Ndryshimet në konfigurimet e rrjetit miratohen paraprakisht.

3. Konfigurimet e rrjetit kontrollohen vazhdimisht për përputhje me konfigurimet e dokumentuara.

4. Dokumentacioni i konfigurimeve të rrjetit përfshin:

a) diagramin e rrjetit, ku tregohen të gjitha lidhjet e rrjetit;

b) diagramin logjik të rrjetit, ku tregohen të gjitha pajisjet e rrjetit, shërbimet dhe serverët;

c) konfigurimet e pajisjeve të rrjetit.

5. Dokumentacioni i konfigurimeve të rrjetit përditësohet me ndryshimet e fundit dhe klasifikohet në tërësi me nivelin më të lartë të informacionit që trajtohet në rrjet.

6. Dokumentacioni i rrjetit që u vihet në dispozicion palëve të treta të përmbajë vetëm detajet e nevojshme për përmbushjen e detyrimeve, shërbimeve sipas kontratës.

7. Pajisjet e rrjetit inventarizohen rregullisht.

Neni 59

Disenjimi dhe konfigurimi i rrjetit

Në disenjimin dhe konfigurimin e rrjetit sigurohet:

1. implementimi i kontrolleve mbi aksesimin e rrjetit për të kufizuar trafikun, sipas nevojës, për njohje brenda dhe ndërmjet segmenteve të rrjetit;

2. çaktivizim i portave fizike të papërdorura në pajisjet e rrjetit;

3. çaktivizim, riemërtim ose ndryshim i fjalëkalimeve dhe llogarive *default* në pajisjet e rrjetit;

4. sinkronizim i kohës në të gjitha pajisjet e rrjetit;

5. zhvillim, implementim, mirëmbajtje e procedurave të sistemeve të detektimit dhe parandalimit të ndërhyrjeve, ku përfshihen:

a) sistemet NISP, NISD;

b) procedura dhe burime për mirëmbajtjen dhe kontrollin e nënshkrimeve elektronike;

c) procedura dhe burime për analizimin e *log*-eve dhe paralajmërimeve (*alert*) në kohë reale;

ç) procedura dhe burime për përgjigje ndaj incidenteve të detektuara (zbuluara);

d) frekuencat e rishikimit të procedurave dhe burimeve të detektimit (zbulimit) dhe parandalimit.

6. Aplikimi i sistemeve të detektimit dhe parandalimit të ndërhyrjeve në të gjitha nyjat e ndërlidhjes në rastet e ndërlidhjes së sistemeve.

7. Përdorimi i VLAN-it për ndarjen e trafikut të rrjetit vetëm ndërmjet rrjeteve në të njëjtin nivel klasifikimi.

Neni 60

Videokonferencat, rrjeti telefonik dhe telefonia IP

1. Telefonia IP të konfigurohet në mënyrë të tillë që:

a) telefonat IP të autentifikojnë vetveten te menaxhuesi i thirrjeve gjatë regjistrimit;

b) të çaktivizohet funksioni i vetëregjistrimit të pajisjeve dhe të lejohet aksesit në rrjet vetëm për një listë të mirëpërcaktuar të pajisjeve të autorizuara;

c) të bllokohen pajisjet e paautorizuara;

ç) të çaktivizohen funksionet e papërdorura dhe të ndaluara.

2. Trafiku i videokonferencave dhe telefonisë IP të ndahet fizikisht ose logjikisht nga trafiku i të dhënave të tjera të rrjetit.

KREU V

SIGURIMI KRIPTOGRAFIK

Neni 61

Të përgjithshme

1. Për kriptimin e informacionit të klasifikuar “Sekret shtetëror” të palëvizshëm ose në transit përdoren produkte, algoritme ose protokolle kriptografike të vlerësuara nga Autoriteti Kombëtar i Sigurimit të Komunikimeve dhe të miratuara nga AKAS-i.

2. AKAS-i mban listën e produkteve, algoritmeve dhe protokolleve kriptografike të miratuara për përdorim.

3. Për kriptimin e të dhënave të palëvizshme përdoret:



- a) kriptimi i plotë i diskut;
 - b) kriptimi i pjesshëm i diskut me kusht që të lejohet shkrimi vetëm në particione të kriptuara.
4. Produktet kriptografike do të ofrojnë një mënyrë për rikuperimin e të dhënave në rast të humbjes ose të dëmtimit të çelësit kriptografik.
5. Në rastet kur informacioni i klasifikuar shkëmbehet nëpërmjet infrastrukturës së rrjeteve publike ose rrjeteve me nivel më të ulët të klasifikimit përdoret kriptimi i të dhënave në transit.

Neni 62

Menaxhimi i materialit kriptografik

1. Pajisjet dhe materialet kriptografike vendosen në zona sigurie të klasit I.
2. Për çdo pajisje dhe material kriptografik mbahet dhe përditësohet regjistri i aksesit, në të cilin ruhen:
- a) detaje të personelit që ka akses në sistem në nivel administratori;
 - b) detaje të personelit që i është hequr aksesit në sistem në nivel administratori;
 - c) detaje të dokumenteve të sistemit;
 - ç) aktivitetet e mbajtjes në llogari të transaksioneve me pajisjet dhe materialet kriptografike;
 - d) aktivitetet e kontrollit të sigurisë së sistemit.
3. Përpara dhënies së aksesit personelit për sigurinë e komunikimeve sigurohet që personat:
- a) kanë nevojën për akses;
 - b) njihen me Planin e Menaxhimit të Materialit Kriptografik për sistemin kriptografik që përdorin;
 - c) janë të pajisur me certifikatë të përshtatshme të sigurisë së personelit;
 - ç) mbrojnë dhe nuk nxjerrin informacionin e autentifikimit të sistemit kriptografik;
 - d) pranojnë të mbajnë përgjegjësi për të gjitha veprimet nën llogarinë e tyre;
 - dh) raportojnë problemet që lidhen me sigurinë në instancat e duhura.
4. Materiali kriptografik inventarizohet:
- a) gjatë kalimit të përgjegjësive administrative (dorëzimit dhe/ose marrjes të detyrës) për sistemin kriptografik;
 - b) gjatë ndryshimit të personelit që ka akses në sistemin kriptografik;
 - c) të paktën 2 (dy) herë në vit për gjendjen faktike, sipas dokumenteve dhe administrimit e tyre.

5. Kontrolli i inventarit kryhet nga strukturat e autorizuar dhe të trajnuar për aspektet e sigurisë së komunikimeve.

6. Anulohen materialet çelës ose certifikatat nëse dyshohet se janë kompromentuar.

7. Raportohet te AKAS-i dhe AKSK-ja për çdo material çelës ose certifikatë që dyshohet se është kompromentuar, si dhe çdo incident kriptografik.

KREU VI

**SIGURIA E NDËRLIDHJES SË
SISTEMEVE TË KLASIFIKUARA**

Neni 63

Të përgjithshme

1. Ndërlidhja e SKI-ve kalon në procesin e akreditimit të sigurisë.
2. Pajisjet/produktet me funksione sigurie kalojnë procesin e vlerësimit, të miratimit nga AKAS-i.
3. SKI-të mund të përdorin internetin ose rrjetet e ngjashme të *domain*-it publik vetëm si bartëse, me kusht që në to të implementohet mbrojtja e duhur kriptografike, e miratuar nga AKAS-i.

Neni 64

Rastet e ndalimit

1. Ndalohet ndërlidhja e SKI-ve që trajtojnë informacion të klasifikuar në nivel “Tepër sekret”.
2. Ndalohet ndërlidhja e SKI-ve në kaskadë.
3. Ndalohet ndërlidhja e SKI-ve me rrjete të paklasifikuara, me përjashtim të rasteve:
- a) ndërlidhje njëdrejtimëshe nëpërmjet përdorimit të diodës së të dhënave;
 - b) ndërlidhje me SKI-të në nivel “I kufizuar”.

Neni 65

Pajisjet gateway

Gjatë ndërlidhjes:

1. Sistemet të mbrohen nga sistemet e *domain*-eve të tjera me një ose më shumë pajisje *gateway*.
2. Pajisjet *gateway* të përmbajnë mekanizma për filtrimin e rrjedhës së të dhënave në shtresën e rrjetit (nivel rrjeti).
3. Të gjitha lidhjet ndërmjet *domain*-eve të sigurisë të përmbajnë mekanizma për inspektimin dhe



filtrimin e rrjedhës së të dhënave për shtresën e transportit dhe më lart sipas modelit OSI.

4. Sigurohet që pajisjet *gateway*:

a) janë të vetmet rrugë komunikimi ndërmjet rrjeteve;

b) në gjendje *default* pengojnë të gjitha lidhjet brenda dhe jashtë rrjetit;

c) lejojnë vetëm lidhjet e autorizuara në mënyrë eksplicite;

ç) janë konfiguruar me masat e përshkruara në këtë rregullore;

d) menaxhohen nëpërmjet një *path*-i të sigurt të izoluar nga rrjetet e lidhura (fizikisht me *gateway* ose në një rrjet administrues të dedikuar);

dh) ofrojnë regjistrim *log*-esh dhe kapacitete të mjaftueshme për identifikimin e incidenteve të sigurisë kompjuterike, përpjekjet për ndërhyrje dhe *pattern* të përdorimit të pazakontë;

e) ofrojnë paralajmërimet (*alert*) në kohë reale.

5. Për ofrimin e shërbimeve që aksesohen nga autoritetet e tjera të ndërlidhura përdoren zonat e demilitarizuara (DMZ).

6. Kryhet vlerësimi i riskut të sigurisë në pajisjet *gateway* dhe konfigurimet përkatëse përpara implementimit të tyre.

7. Dokumentohen e vlerësohen të gjitha ndryshimet në arkitekturën e pajisjeve *gateway*.

8. Kufizohet aksesimi në funksionet administrative të pajisjeve *gateway*.

9. Sigurohet që administratorët janë të trajnuar për menaxhimin e pajisjeve *gateway*.

10. Ruhen *log*-et e të gjitha veprimeve (*events*).

Neni 66

Pajisjet *firewall*

Në ndërlidhje sistemesh përdoren pajisje *firewall* si pjesë e infrastrukturës në të gjitha pikat e ndërlidhura, në mënyrë të pavarur.

Neni 67

Diodat e të dhënave

1. Në ndërlidhje sistemesh njëdrejtimësh përdoren dioda të dhënash sipas një liste të njohur sipas standardeve kombëtare, të NATO-s, BE-së dhe të certifikuar me nivelin më të lartë të informacionit, i cili trajtohet në këto SKI.

2. Gjatë përdorimit të diodës së të dhënave monitorohet volumi i të dhënave që transferohet.

Neni 68

Përmbajtjet dhe lidhjet *web*

Në rastin e implementimit të faqeve *web* në ndërlidhje sistemesh:

1. dokumentohen në POS politikat e përdorimit të sigurt të *web*-it;

2. aksesimi i faqeve *web* kryhet nëpërmjet një *web proxy*. *Web proxy* autentifikon përdoruesit dhe ruan *log*-et me detajet e faqeve *web*, që aksesohen:

a) adresa URL;

b) koha/data;

c) përdoruesi;

ç) sasia e të dhënave të *upload*-uara dhe *download*-uara;

d) adresa IP.

Neni 69

Pajisjet KVM *switch*

1. Gjatë ndërlidhjes së SKI-ve, përdoren pajisje KVM *switch* sipas një liste të njohur sipas standardeve kombëtare të NATO-s, BE-së për aksesimin e sistemeve sipas rasteve:

a) sistem i klasifikuar dhe sistem i paklasifikuar;

b) sisteme me nivele të ndryshme klasifikimi;

c) sisteme në të njëjtin nivel klasifikimi por në *domain*-e të ndryshme.

2. Pajisjet KVM *switch*:

a) operohen manualisht;

b) kanë të ndarë përshtatshmëri dhe në mënyrë të dukshme kabllot nga sisteme të ndryshme;

c) përmbajnë tregues për të njoftuar përdoruesin në rastet kur kalohet në sisteme të paklasifikuara;

ç) inspektohen rregullisht lidhur me mirëfunksionimin e tyre.

3. Pajisjet KVM *switch* nuk duhet të kenë procesor ose memorie të brendshme.

4. Pajisjet KVM *switch* nuk lejohet të lidhen me sisteme të paklasifikuara, të cilat kanë konvertues analog–digjital.

Neni 70

Politika dhe procedurat e transferimit të të dhënave

Gjatë ndërlidhjes së SKI-ve sigurohet që:

1. veprimet e përdoruesve që shkëmbejnë të dhëna ndërmjet sistemeve ruhen në *log*-e;



2. përdoruesit parandalojnë incidentet kompjuterike nëpërmjet:

a) kontrollit të shenjzimeve për të siguruar që sistemi destinacion është i përshtatshëm për administrimin e të dhënave që transferohen;

b) kryerjen e kontrollit kundër viruseve në të dhënat që transferohen;

c) ndjekjen e proceseve dhe procedurave për transferimin e të dhënave;

3. të dhënat e importuara në sistem:

a) skanohen për përmbajtje keqdashëse dhe aktive;

b) kontrollohet formati i të dhënave;

c) ruhen *log*-et për çdo ngjarje;

ç) monitorohen për identifikimin e modeleve të pazakonta të përdorimit;

4. të dhënat e eksportuara në sistem:

a) kontrollohen për shenjzimet përkatëse;

b) ruhen *log*-et për çdo ngjarje;

c) monitorohen për identifikimin e modele të pazakonta të përdorimit;

ç) kontrollohet formati i të dhënave;

d) bëhen kontrole të fjalëve;

dh) kontrollohet madhësia e skedarëve;

5. transferimi i të dhënave kryhet në përputhje me procedurat e përcaktuara në POS.

KREU VII

PUNA JASHTË ZONAVE TË SIGURISË

Neni 71

Pajisjet e lëvizshme

1. Dokumentohen në POS procedurat e përdorimit të sigurt të pajisjeve të lëvizshme.

2. Risku që lidhet me përdorimin e pajisjeve të lëvizshme të vlerësohet dhe dokumentohet.

3. Në rast të përdorimit të pajisjeve të lëvizshme për komunikimin e informacionit të klasifikuar për infrastrukturën e rrjeteve publike, përdorin produkte kriptografike të miratuara nga AKAS-i.

4. Në rast të lejimit të pajisjeve të lëvizshme për aksesimin e informacionit të klasifikuar, ndalohet instalimi dhe çinstalimi i aplikacioneve nga përdoruesit.

5. Në rast të lejimit të pajisjeve të lëvizshme për aksesimin e informacionit të klasifikuar, ndalohet çaktivizimi i funksioneve të sigurisë nga përdoruesit.

6. Në rast se ofrohet funksion i zerimit ose sanitizimit të pjesës memorizuese në pajisjet e

lëvizshme, ky funksion të përdoret si pjesë e procedurave të asgjësimit në raste emergjence.

7. Për përpunimin ose ruajtjen e informacionit të klasifikuar në nivel “Tepër sekret”, nuk lejohet përdorimi i pajisjeve të lëvizshme përveçse me miratim të AKAS-it.

8. Pajisjet e lëvizshme që nuk janë në zotërim të institucionit nuk lejohen të përdoren për aksesimin ose administrimin e informacionit të klasifikuar.

9. Pajisjet e lëvizshme që nuk janë në zotërim të institucionit nuk lejohet të futen pa autorizimin me shkrim të titullarit të AOS-it.

10. Nuk lejohen funksionet *bluetooth*, *wireless* apo *infrared* në pajisjet e lëvizshme.

Neni 72

Pajisjet e lëvizshme jashtë zonave të sigurisë

1. Pajisjet e lëvizshme transportohen në mënyrë të sigurt jashtë zonave të sigurisë pas autorizimit të AOS-it.

2. Pajisjet e lëvizshme jashtë zonave të sigurisë të mbahen nën mbikëqyrje të vazhdueshme.

3. Në pajisjet e lëvizshme kur përdoren jashtë shtetit sigurohet:

a) aplikimi i përditësimeve të aplikacioneve dhe i sistemeve operative;

b) implementimi i autentifikimit multifaktorial;

c) kryerja e *back up*-it të të dhënave;

ç) heqja e informacioneve të panevojshme nga pajisja;

d) çaktivizimi i aplikacioneve që nuk janë të rëndësishme për periudhën e udhëtimit;

dh) çaktivizimi i lidhjeve *bluetooth*, *wireless* dhe *infrared*;

e) mbajtja nën kontroll gjatë të gjithë kohës;

4. Në rast se ofrohet funksion i zerimit ose sanitizimit të pjesës memorizuese në pajisjet e lëvizshme, ky funksion të përdoret si pjesë e procedurave të asgjësimit në raste emergjence.



KREU VIII
INCIDENTET E SIGURISË
KOMPJUTERIKE DHE PROCEDURAT E
RAPORTIMIT

Neni 73

**Përgjigjja ndaj incidenteve të sigurisë
kompjuterike**

1. Për trajtimin e incidenteve të sigurisë caktohet personel me kualifikimin e duhur profesional.
2. Incidentet që lidhen me sigurinë e sistemeve regjistrohen në regjistër të veçantë. Në këta regjistra regjistrohen minimalisht të dhënat e mëposhtme:
 - a) data e verifikimit të incidentit të sigurisë;
 - b) data kur ka ndodhur incidenti i sigurisë;
 - c) një përshkrim i incidentit të sigurisë, përfshirë personelin dhe mjediset e përfshira;
 - ç) veprimet e marra;
 - d) kujt i është raportuar incidenti;
 - dh) dokumenti referencë i përfshirë në incident (nëse ka të tillë).
3. Incidentet që lidhen me sigurinë e sistemeve të raportohen në strukturat e duhura, me qëllimin përgjigjen, hetimin dhe inspektimin në përputhje me legjislacionin për sigurinë e SKI-ve.

Neni 74

Njoftimi i AKAS-it për incidentet

- Kushtet, në të cilat AKAS-i duhet njoftuar menjëherë pas ndodhjes së incidentit janë:
1. thyerjet e sigurisë që prekin informacionin e klasifikuar;
 2. përhapje e paautorizuar e informacionit në mediat publike ose në entitete të tjera;
 3. akses i paautorizuar i të dhënave;
 4. dyshime për spiunazh, sabotim ose terrorizëm;
 5. aktivitete të brendshme keqdashëse (p.sh. kërcënim i brendshëm);
 6. incidente që përfshijnë akses të privilegjuar në SKI;
 7. incidente që përfshijnë elemente kriptografike;
 8. incidente që cenojnë sigurinë kombëtare.

Neni 75

Operatorët ekonomikë

1. Operatorët ekonomikë, gjatë realizimit të kontratave të klasifikuara, përdorin SKI të akredituara përshtatshëm.
2. Periudha e vlefshmërisë së akreditimit është në përputhje me afatet e zbatimit të kontratës së klasifikuar, por jo më tepër se 3 (tre) vjet.
3. Për operatorët ekonomikë ndalohet akreditimi i SKI-ve në nivel “Tepër sekret” ose ekuivalent.
4. Ndalohet ndërlydhja e SKI-ve për operatorët ekonomikë/kontraktorët me SKI-në e institucioneve shtetërore.

Neni 76

Dispozita kalimtare dhe të fundit

1. Ministrinë, institucionet shtetërore dhe operatorët ekonomikë marrin masa për zbatimin e kërkesave të kësaj rregulloreje.
2. Autoriteti Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar ngarkohet për kontrollin e zbatimit të kërkesave të kësaj rregulloreje.
3. Autoriteti Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar ngarkohet për nxjerrjen e modeleve në zbatim të shkronjës “a”, të pikës 2, të nenit 18, dhe udhëzimin, në zbatim të pikës 4, të nenit 27, të kësaj rregulloreje, brenda 90 ditëve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi.

VENDIM

Nr. 806, datë 28.12.2023

**PËR MIRATIMIN E LISTAVE TË
MALLRAVE, QË MUND TË PËRDOREN
OSE NUK KANË PËRDORIM TJETËR
PËRVEÇ QËLLIMIT TË DËNIMIT ME
VDEKJE, TORTURËS OSE DËNIME APO
TRAJTIME MIZORE, ÇNJERËZORE OSE
POSHTËRUESE, TË CILAT JANË
OBJEKT I KONTROLLIT SHTETËROR
TË TRANSFERIMEVE
NDËRKOMBËTARE²**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 3, pika 5, 9, pika 5, dhe 13, pika 6, të ligjit nr. 27/2023, “Për kontrollin e tregtimit të produkteve

² Ky vendim është përafuar pjesërisht me rregulloren (BE) 2019/125 të Parlamentit Evropian dhe Këshillit, datë 16 janar 2019, “Për tregtinë e mallrave të caktuara, të cilat mund të përdoren për dënim me vdekje, torturë apo trajtime ose dënime të tjera mizore, Faqe | 228

çnjerezore ose poshteruese”, të ndryshuar. Numri CELEX 32019R0125, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian, seria L, nr. 30, datë 31.1.2019, f. 1–57.



që mund të përdoren për dënime me vdekje, torturë ose dënime apo trajtime mizore, çnjerëzore ose poshtëruese”, me propozimin e ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës së mallrave, që nuk kanë përdorim tjetër përveç qëllimit të dënimit me vdekje, torturës ose dënime apo trajtime mizore, çnjerëzore ose poshtëruese, sipas shtojcës nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi, të cilat janë objekt i kontrollit shtetëror të transferimeve ndërkombëtare.

2. Miratimin e listës së mallrave, që mund të përdoren për qëllime torture ose ndëshkime mizore,

çnjerëzore apo poshtëruese, sipas shtojcës nr. 2, që i bashkëlidhet këtij vendimi, të cilat janë objekt i kontrollit shtetëror të transferimeve ndërkombëtare.

3. Miratimin e listës së mallrave, që mund të përdoren për dënimin me vdekje, sipas shtojcës nr. 3, që i bashkëlidhet këtij vendimi, të cilat janë objekt i kontrollit shtetëror të transferimeve ndërkombëtare.

4. Ngarkohet Autoriteti i Kontrollit Shtetëror të Eksporteve për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

SHTOJCA I

LISTA E MALLRAVE, TË CILAT NUK KANË PËRDORIM TJETËR PËRVEÇ QËLLIMIT TË DËNIMIT ME VDEKJE, TORTURËS OSE DËNIME APO TRAJTIME MIZORE, ÇNJERËZORE OSE POSHTËRUESE

Shënim hyrës.

Kodet “NK” në këtë shtojcë i referohen kodeve të specifikuar në Nomenklaturën e Kombinar të Mallrave, bazuar në Sistemin e Harmonizuar Doganor.

Në rastin kur pjesa “ish” paraprin kodin “NK”, mallrat e përshkruar në këtë shtojcë përbëjnë vetëm një pjesë të fushës së veprimit të kodit “NK” dhe përcaktohen, si nga përshkrimi në këtë shtojcë edhe nga fusha e veprimit e kodit “NK”.

Shënime:

1. Artikujt 1.3 dhe 1.4 në seksionin 1, që kanë të bëjnë me mallrat e përgatitur për ekzekutimin e qenieve njerëzore nuk përfshijnë mallrat mjekësore-teknike.

2. Objekti i kontroleve në këtë shtojcë nuk duhet të përfshijë eksportet e mallrave të palistuar (përfshirë bimët), që përmbajnë një ose më shumë prej pjesëve të listuara, kur pjesa ose pjesët e kontrolluara janë elementi kryesor i mallrave dhe mund të hiqen ose përdoren praktikisht për qëllime të tjera.

NB: Në vlerësimin nëse pjesa ose pjesët e kontrolluara duhet të konsiderohen si elementi kryesor, është e nevojshme të peshohen faktorët e sasisë, vlerës dhe njohuritë teknologjike të përfshira, si edhe rrethana të tjera të veçanta, të cilat mund ta klasifikojnë pjesën ose pjesët e kontrolluara si elementin kryesor të mallrave që po merren.

Kodi NK	Përshkrimi
	1. Mallrat e dizenuar për ekzekutimin e qenieve njerëzore, si më poshtë:
ish 4421 90 97 ish 8208 90 00	1.1. Trekëmbësh, gjytina dhe tehet për gjytinat.
ish 8543 70 90 ish 9401 79 00 ish 9401 80 00 ish 9402 10 00	1.2. Karrige elektrike për ekzekutimin e qenieve njerëzore.



ish 9406 00 38 ish 9406 00 80	1.3. Struktura hermetike, të bëra për shembull prej çeliku dhe xhami, të ndërtuara për ekzekutimin e qenieve njerëzore me anë të përdorimit të një gazi ose substance vdekjeprurëse.
ish 8413 81 00 ish 9018 90 50 ish 9018 90 60 ish 9018 90 84	1.4. Sisteme automatike për injektimin e ilaçit të përgatitura për ekzekutimin e qenieve njerëzore me anë të përdorimit të një substance kimike vdekjeprurëse.
	2. Mallrat të cilat nuk janë të përshtatshme që të përdoren nga autoritetet ligjzbatuese për të kufizuar qeniet njerëzore, si më poshtë:
ish 8543 70 90	2.1. Pajisjet elektroskok të cilat synohen që të mbahen në trup nga një person i kufizuar, të tillë si: rripat, mëngët dhe prangat, të ndërtuara për kufizimin e qenieve njerëzore nën përdorimin e shokëve elektrikë.
ish 7326 90 98 ish 7616 99 90 ish 8301 50 00 ish 3926 90 97 ish 4203 30 00 ish 4203 40 00 ish 4205 00 90	2.2. Prangat për gishtat e mëdhenj të duarve, prangat për gishtat e duarve, morsat për gishtat e mëdhenj dhe morsat për gishtat. Shënim. Ky artikull përmban si prangat dhe morsat e dhëmbëzuara dhe ato të padhëmbëzuara.
ish 7326 90 98 ish 7616 99 90 ish 8301 50 00 ish 3926 90 97 ish 4203 30 00 ish 4203 40 00 ish 4205 00 90 ish 6217 10 00 ish 6307 90 98	2.3. Pranga për kyçet e këmbëve, kufizues të rëndë për këmbët dhe kufizues për disa persona, duke përfshirë si prangat për këmbët edhe kufizuesit për këmbët. Shënim. 1. Prangat për kyçet e këmbëve janë hallka ose unaza për kyçet e këmbëve, të lidhura me një mekanizëm i cili mbyllet me kyç, të lidhura me një shufër të fortë, e cila përbëhet nga metal. 2. Ky artikull përfshin prangat e këmbëve ose kufizuesit e rëndë të këmbëve, të cilët lidhen me prangat normale të duarve me anë të një zinxhiri.
ish 7326 90 98 ish 7616 99 90 ish 8301 50 00 ish 3926 90 97 ish 4203 30 00 ish 4203 40 00 ish 4205 00 90 ish 6217 10 00 ish 6307 90 98	2.4. Pranga për kufizimin e qenieve njerëzore, të dizenuara për t'u pozicionuar në një mur, dysHEME ose tavan.
ish 9401 61 00 ish 9401 69 00 ish 9401 71 00 ish 9401 79 00 ish 9401 80 00 ish 9402 10 00	2.5. Karrige kufizuese: karrige me unaza ose pajisje të tjera kufizuese për të kufizuar qeniet njerëzore. Shënim. Ky artikull nuk pengon karriget të përshtatura me rripa lidhës.



ish 9402 90 00 ish 9403 20 20 ish 9403 20 80 ish 9403 50 00 ish 9403 70 00 ish 9403 81 00 ish 9403 89 00	2.6. Tabela dhe shtretër me unaza kufizuese: tabela dhe shtretër me unaza kufizuese ose me pajisje të tjera për të kufizuar një qenie njerëzore. Shënim. Ky artikull nuk pengon tabelat ose shtretërit të përshtatur vetëm me rripa kufizues.
ish 9402 90 00 ish 9403 20 20 ish 9403 50 00 ish 9403 70 00 ish 9403 81 00 ish 9403 89 00	2.7. Shtretërit kafaz: shtretërit të përbërë nga një kafaz (katër anë dhe një tavan), ose struktura të ngjashme ku kufizohet një qenie njerëzore brenda krevatit, tavanit ose njëtrës ose më shumë anëve, të cilat kanë shufra metalike ose të llojeve të tjera dhe të cilat mund të hapen vetëm nga jashtë.
ish 9402 90 00 ish 9403 20 20 ish 9403 50 00 ish 9403 70 00 ish 9403 81 00 ish 9403 89 00	2.8. Shtretër me rrjetë: shtretërit të cilët kanë një kafaz (katër anë dhe një tavan), ose një strukturë të ngjashme ku kufizohet një qenie njerëzore brenda krevatit, tavanit ose njëtrës ose më shumë anëve, të cilat kanë rrjetë dhe të cilat mund të hapen vetëm nga jashtë.
	3. Pajisje portative, të cilat nuk janë të përshtatshme për përdorim nga autoritetet ligjzbatuese për qëllimin e kontrollit të revoltave ose vetëmbrojtje, si më poshtë:
ish 9304 00 00	3.1. Shkopinj të prej metali ose material tjetër të cilët kanë një bosht me maja metalike.
ish 3926 90 97 ish 7326 90 98	3.2. Mburojë me maja metalike.
	4. Kamxhikët, si më poshtë:
ish 6602 00 00	4.1. Kamxhikë me disa fshikuj ose rripa, si për shembull kamxhikët tufë ose me shumë fije.
ish 6602 00 00	4.2. Frushkuj me një ose më shumë fije me tela me gjemba, rripa, maja, objekte me tela ose të tjerë të ngjashëm të cilët kanë ndikimin e fshikullit ose rripit.

SHTOJCA 2

LISTA E MALLRAVE, QË MUND TË PËRDOREN PËR QËLLIME TORTURE OSE NDËSHKIME MIZORE, ÇNJERËZORE APO POSHTËRUESE

Kodet “NK” në këtë shtojcë i referohen kodeve të specifikuara në Nomenklaturën e Kombinar të Mallrave, bazuar në Sistemin e Harmonizuar Doganor

Në rastin kur pjesa “ish” paraprin kodin “NK”, mallrat e përshkruar në këtë shtojcë përbëjnë vetëm një pjesë të fushës së veprimit të kodit “NK” dhe përcaktohen si nga përshkrimi në këtë shtojcë edhe nga fusha e veprimit e kodit “NK”.

Shënime.

1. Objekti i kontroleve në këtë shtojcë nuk duhet të përfshijë eksportet e mallrave të palistuar (përfshirë bimët), që përmbajnë një ose më shumë prej pjesëve të listuara, kur pjesa ose pjesët e kontrolluara janë elementi kryesor i mallrave dhe mund të hiqen ose përdoren praktikisht për qëllime të tjera.



NB: Në vlerësimin nëse pjesa ose pjesët e kontrolluara duhet të konsiderohen si elementi kryesor, është e nevojshme të peshohen faktorët e sasisë, vlerës dhe njohuritë teknologjike të përfshira, si edhe rrethana të tjera të veçanta, të cilat mund ta klasifikojnë pjesën ose pjesët e kontrolluara si elementin kryesor të mallrave që po merren.

1. Në disa raste, kimikatet listohen sipas emrit dhe numrit CAS. Lista shkon për kimikate me të njëjtën formulë strukturore (duke përfshirë hidratet) pavarësisht emrit ose numrit CAS. Numrat CAS jepen për të ndihmuar në identifikimin e një kimikati ose përzierje të caktuar, pavarësisht listës. Numrat CAS nuk mund të përdoren si identifikues unikë, sepse disa forma të kimikateve të listuara kanë numra të ndryshëm CAS dhe përzierjet që përmbajnë një kimikat të listuar mund të kenë po ashtu numra të tjerë CAS.

Kodi NK	Përshkrimi
	1. Mallrat e dizenuar për të kufizuar qeniet njerëzore, si më poshtë:
ish 7326 90 98 ish 7616 99 90 ish 8301 50 00 ish 3926 90 97 ish 4203 30 00 ish 4203 40 00 ish 4205 00 90 ish 6217 10 00 ish 6307 90 98	<p>1.1. Unazat dhe zinxhirët për grupe njerëzish.</p> <p>Shënime:</p> <ol style="list-style-type: none"> Unazat janë kufizues të përbërë nga dy njësi kufizuese ose unaza me një mekanizëm mbyllës, me një zinxhir ose shufër lidhëse. Ky artikull nuk kontrollon kufizuesit e këmbëve dhe zinxhirët për grupe njerëzish të ndaluar nga artikulli 2.3, i shtojcës I. Ky artikull nuk kontrollon “prangat e zakonshme të duarve”. Prangat e zakonshme të duarve janë të gjitha prangat të cilat përmbushin kushtet si më poshtë: <ul style="list-style-type: none"> Dimensioni i tyre i përgjithshëm duke përfshirë zinxhirin, nga ana e jashtme e një prange te tjetra është midis 150 dhe 280 mm, kur mbyllen të dyja prangat; Perimetri i brendshëm i secilës prangë është maksimumi 165 mm, kur nyja kapet në pikën e fundit e cila hyn në mekanizmin e mbylljes; Perimetri i brendshëm i secilës prangë është 200 mm, kur nyja hyn kapet në pikën e parë, e cila hyn në mekanizmin e mbylljes; dhe Prangat nuk janë modifikuar për të shkaktuar dhimbje ose vuajtje fizike.
ish 7326 90 98 ish 7616 99 90 ish 8301 50 00 ish 3926 90 97 ish 4203 30 00 ish 4203 40 00 ish 4205 00 90 ish 6217 10 00 ish 6307 90 98	<p>1.2. Pranga ose unazat me një mekanizëm mbyllës, me një perimetër të brendshëm që i kalon 165 mm, kur nyja hyn në pikën e fundit që hyn në mekanizmin e mbylljes.</p> <p>Shënim. Ky artikull përfshin kufizuesit e qafës dhe pranga ose unaza të tjera individuale me një mekanizëm mbyllës, të cilat lidhen me pranga të zakonshme duarsh me anë të një zinxhiri .</p>
ish 6505 00 10 ish 6505 00 90 ish 6506 91 00 ish 6506 99 10 ish 6506 99 90	<p>1.3. Kapuçat frenues për të pështyrë: kapuçi ku përfshihen kapuçat e bërë nga rrjeta, me një mbulesë për gojën, e cila ndalon personin të pështyjë.</p> <p>Shënim. Ky artikull përfshin kapuçat frenues për të pështyrë të cilët lidhen me prangat e duarve me anë të një zinxhiri.</p>
	2. Armë dhe pajisje të dizenuara për kontrollin e trazirave ose për vetëmbrojtje, si më poshtë:
ish 8543 70 90 ish 9304 00 00	<p>2.1. Armë portative me shkarkim elektrik, të cilat targetojnë vetëm një person për çdo rast ku lëshohet një shok elektrik, duke përfshirë por pa u kufizuar shkopinjët e shokut elektrik, mburojat me shok elektrik, armë trulllosëse dhe armët me shigjeta me shok elektrik.</p> <p>Shënime:</p> <ol style="list-style-type: none"> Ky artikull nuk përfshin rripat me shok elektrik dhe pajisje të tjera nën artikullin 2.1, të shtojcës 1. Ky artikull nuk kontrollon pajisjet me shok elektrik individuale, kur shoqërojnë përdoruesin e tyre për mbrojtjen personale të përdoruesit.



ish 8543 90 00 ish 9305 99 00	<p>2.2. Sete që përmbajnë elemente esenciale për bashkimin e armëve portative me shkarkim elektrik të kontrolluara nga artikulli 2.1</p> <p>Shënim. Mallrat e mëposhtëm konsiderohen të jenë elemente të rëndësishme:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Njësia që prodhon shokun elektrik; - Çelësi, qoftë një telekomandë ose jo; dhe - Elektrodat, ku është e mundur, telat me anë të të cilave administrohet shoku elektrik.
ish 8543 70 90 ish 9304 00 00	<p>2.3. Armët fikse ose të montueshme me shkarkim elektrik të cilat mbulojnë një zonë të gjerë dhe mund të shënjestrojnë disa individë me shok elektrikë.</p>
ish 8424 20 00 ish 8424 89 00 ish 9304 00 00	<p>3. Armë dhe pajisje që përhapin substanca neutralizuese ose irrituese për kontrollin e trazirave ose për vetëmbrojtje dhe substanca të tjera të lidhura me to, si më poshtë:</p> <p>3.1. Armë dhe pajisje portative, të cilat ose administrojnë një dozë me substanca kimike neutralizuese ose irrituese të cilat traqetojnë një individ, ose përhapin një dozë të një substancë e cila mbulon një zonë të vogël, për shembull në formë e mjegullës ose resë sprucuese, kur substanca kimike administrohet ose përhapet.</p> <p>Shënime:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Ky artikull nuk kontrollon pajisjet e kontrolluar nga artikulli ML7(e) i Listës së Mallrave Ushtarake. 2. Ky artikull nuk kontrollon pajisjet portative, edhe nëse përmbajnë substanca kimike, kur shoqërojnë përdoruesin e tyre për mbrojtje personale të përdoruesit. 3. Gjithashtu, përveç substancave kimike, si për shembull agjentët për kontrollin e trazirave ose PAVA, mallrat e kontrolluar nga artikujt 3.3 dhe 3.4 do të vlerësohen si substanca kimike neutralizuese ose irrituese.
ish 2924 29 98	<p>3.2. Vanillamid acid pelargomic (PAVA) (CAS RN 2444-46-4).</p>
ish 3301 90 30	<p>3.3. Oleoresin capsicum (OC) (CAS RN 8023-77-6).</p>
ish 2924 29 98 ish 2939 99 00 ish 3301 90 30 ish 3302 10 90 ish 3302 90 10 ish 3302 90 90 ish 3824 90 97	<p>3.4. Përzierjet që përmbajnë të paktën 0,3 % në peshë PAVA ose një tretës (si etanol, 1-propanol ose heksan), të cilat mund të administrohen si agjentë neutralizues ose irritues, veçanërisht në aerosolë dhe në lëngje, ose mund të përdoren për prodhimin e agjentëve neutralizues ose irritues.</p> <p>Shënime:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Ky artikull nuk kontrollon salcat dhe përgatitjet prej tyre, supat ose përgatitjet prej tyre, dhe erëzat e përzierja, nëse PAVA ose OC nuk janë shijet e vetme përbërëse në to. 2. Ky artikull nuk kontrollon produktet mjekësore për të cilat është dhënë një autorizimin marketingu, sipas legjislacionit të fushës.
ish 8424 20 00 ish 8424 89 00	<p>3.5. Pajisje fikse për përhapjen e substancave kimike neutralizuese ose irrituese, të cilat mund të vendosen në mur ose tavan brenda një ndërtese, ku përfshihet një njësi me agjendë kimikë irritues ose neutralizues dhe aktivizohet duke përdorur një sistem me telekomandë.</p> <p>Shënim. Gjithashtu, përveç substancave kimike, si për shembull agjentët për kontrollin e trazirave ose PAVA, mallrat e kontrolluar nga artikujt 3.3 dhe 3.4 do të vlerësohen si substanca kimike neutralizuese ose irrituese.</p>
ish 8424 20 00 ish 8424 89 00 ish 9304 00 00	<p>3.6. Pajisje fikse ose të montueshme për përhapjen e agjentëve neutralizues ose irritues, e cila mbulon një zonë të gjerë dhe nuk është dizenuar për t'u vendosur në një mur ose në një tavan brenda ndërtesës.</p> <p>Shënime:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Ky artikull nuk kontrollon pajisjet e kontrolluara nda ML7 (e) të Listës së Mallrave Ushtarake. 2. Ky artikull kontrollon edhe topat e ujit 3. Gjithashtu, përveç substancave kimike, si për shembull agjentët për kontrollin e trazirave ose PAVA, mallrat e kontrolluar nga artikujt 3.3 dhe 3.4 do të vlerësohen si substanca kimike neutralizuese ose irrituese.



SHTOJCA 3
LISTA E MALLRAVE, QË MUND TË PËRDOREN PËR DËNIMIN ME VDEKJE

Kodi NK	Përshkrimi
	1. Produktet që mund të përdoren për ekzekutimin e qenieve njerëzore me anë të një injeksioni vdekjeprurës, si më poshtë:
	1.1. Agjentë anestetikë barbituratë që veprojnë për një kohë të shkurtër dhe mesatare, ku përfshihen, por pa u kufizuar:
ish 2933 53 90 [(a) to (f)] ex 2933 59 95 [(g) dhe (h)]	a) amobarbital (CAS RN 57-43-2); b) amobarbital sodium salt (CAS RN 64-43-7); c) pentobarbital (CAS RN 76-74-4); d) kripë natriumi pentobarbital (CAS 57-33-0); e) secobarbital (CAS RN 76-73-3); f) kripë natriumi secobarbital (CAS RN 309-43-3); g) tiopental (CAS RN 76-75-5); h) kripë natriumi tiopental (CAS RN 71-73-8), i njohur edhe si natrium tiopenton.
ish 3003 90 00 ish 3004 90 00 ish 3824 90 96	Shënim. Ky artikull kontrollon edhe produktet të cilat përmbajnë një nga agjentët anestetik të listuar nën agjentët anestetikë barbituratë me fuqi vepruese për një kohë të shkurtër ose mesatare.

VENDIM

Nr. 823, datë 28.12.2023

**PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME
NË VENDIMIN NR. 41, DATË 24.1.2018, TË
KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR
ELEMENTET E PROGRAMEVE TË
STUDIMIT TË OFRUARA NGA
INSTITUCIONET E ARSIMIT TË
LARTË”, TË NDRYSHUAR³**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 71, të ligjit nr. 80/2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e ministrit të Arsimit dhe Sportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 41, datë 24.1.2018, të Këshillit të Ministrave, “Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të

lartë”, të ndryshuar, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

a) Shkronjat “b”, “c”, “ç” dhe “d”, të pikës 2.1, ndryshohen, si më poshtë vijon:

“b) Një krediti i korrespondojnë 25 (njëzet e pesë) deri në 30 (tridhjetë) orë mësimore pune të studentit;

c) Sasia mesatare e punës së kryer gjatë një viti studimesh në arsimin e lartë nga një student me kohë të plotë është 60 (gjashtëdhjetë) kredite ose 1 500 (një mijë e pesëqind) deri në 1 800 (një mijë e tetëqind) orë mësimore pune të studentit, të cilat përfshijnë orë në auditor dhe orë pune të pavarur të tij;

ç) Orët për punë të pavarur të studentit zënë jo më pak se gjysmën e fondit të përgjithshëm të orëve mësimore vjetore, përveç programeve të studimit në “Mjekësi e përgjithshme”, “Infermieri”, “Stomatologji” dhe “Mami”, për të cilat fondi i përgjithshëm i orëve mësimore përcaktohet duke marrë në konsideratë orët minimale mësimore të formimit teorik dhe atij praktik, sipas shtojcës nr. 4,

³ Ky vendim është përafërur pjesërisht me nenet 24, 31, 34, 38, 40, 41, 44 dhe 46 të direktivës 2005/36/KE të Parlamentit Evropian dhe Këshillit, datë 7 shtator 2005, për njohjen e kualifikimeve profesionale, numri CELEX 32005L0036, botuar me Fletoren Zyrtare të Bashkimit Evropian seria L, numri 255, datë 30.9.2005, faqja 22–142, ndryshuar me direktivën 2013/55/BE të Parlamentit Evropian dhe Këshillit, datë 20 nëntor 2013, numri CELEX 32013L0055, botuar me Fletoren Zyrtare të Bashkimit Evropian, seria L, nr. 354/132, datë 28.12.2013, faqja 132–

170 si edhe Rekomandimin (2017 / C 189/03) të Këshillit të Evropës, datë 22 maj 2017, “Mbi Kornizën Evropiane të Kualifikimeve për të mësuarit gjatë të gjithë jetës dhe shfaqurimin e rekomandimit të Parlamentit Evropian dhe Këshillit të datës 23 prill 2008, për krijimin e Kornizës Evropiane të Kualifikimeve për të mësuarit gjatë të gjithë jetës”,



tabela 4.2, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij;

d) Ngarkesa mësimore javore në auditor për leksione, seminare, ushtrime e laboratorë, forma të kontrollit të vazhdueshëm dhe seanca të praktikave të zhvilluara në auditor është deri në 30 (tridhjetë) orë mësimore 50-minutëshe.”

b) Pas shkronjës “c”, të pikës 2.3, shtohet shkronja “ç”, me këtë përmbajtje:

“ç) rezultatet e të nxënit dhe kompetencat për programet e studimit në “Mjekësi e përgjithshme”, “Infermieri”, “Stomatologji”, “Mami”, “Mjekësi veterinarë”, “Farmaci” dhe “Arkitekturë” përcaktohen në përputhje me rezultatet e të nxënit dhe kompetencat minimale të parashikuara në shtojcën nr. 4, tabela 4.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.”

c) Pas shkronjës “c”, të pikës 2.5, shtohen shkronjat “ç” dhe “d”, me këtë përmbajtje:

“ç) Programet e studimit “Mjekësi e përgjithshme”, “Infermieri”, “Stomatologji”, “Mami”, “Mjekësi veterinarë”, “Farmaci” dhe “Arkitekturë” hartohen nga IAL-të në përputhje me veprimtaritë formuese minimale, të përcaktuara në shtojcën nr. 4, tabela 4.2.

d) Veprimtaritë formuese grupohen nga institucioni i arsimit të lartë që ofron program studimi të formimit të vazhduar, në bazë të numrit të krediteve të atij programi, si dhe duke iu referuar

përcaktimeve në Kornizën Shqiptare të Kualifikimeve gjatë përshkrimit të kualifikimeve individuale, për sa u përket njohurive, aftësive dhe kompetencave të fituara me përfundimin e studimeve.”

ç) Pas pikës 2.13 shtohet pika 2.14, me këtë përmbajtje:

“2.14 Përshtatja nga IAL-të e programeve të studimit “Mjekësi e përgjithshme”, “Infermieri”, “Stomatologji”, “Mami”, “Mjekësi veterinarë”, “Farmaci” dhe “Arkitekturë” me orët minimale të formimit, veprimtaritë formuese, rezultatet e të nxënit dhe kompetencat profesionale minimale të parashikuara në shtojcën nr. 4, kryhet jo më vonë se viti akademik 2027–2028.”

2. Pas shtojcës nr. 3, bashkëlidhur vendimit, shtohet shtojca nr. 4, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

3. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Sportit, Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë, Qendra e Shërbimeve Arsimore, Agjencia Kombëtare e Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit, Agjencia Kombëtare e Financimit të Arsimit të Lartë dhe institucionet e arsimit të lartë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

SHTOJCË NR. 4

Tabela 4.1. Parashikime lidhur me rezultatet e të nxënit dhe kompetencat që duhet të fitohen në përfundim të programeve të studimit “Mjekësi e përgjithshme”, “Infermieri”, “Stomatologji”, “Mami”, “Mjekësi veterinarë”, “Farmaci” dhe “Arkitekturë”

Rezultatet e të nxënit dhe kompetencat profesionale	
4.1.1. Formimi bazë për programin e studimit “Mjekësi e përgjithshme”	1. Formimi bazë për programin e studimit “Mjekësi e përgjithshme” duhet të sigurojë fitimin e njohurive dhe aftësive të mëposhtme: a) njohuri të përshtatshme për shkencat mbi të cilat bazohet mjekësia dhe kuptim të mirë të metodave shkencore, duke përfshirë parimet e matjes së funksioneve biologjike, vlerësimin e fakteve të vërtetuara shkencërisht dhe analizën e të dhënave; b) kuptim të mjaftueshëm të strukturës, funksioneve dhe sjelljes së personave të shëndetshëm dhe të sëmurë, si dhe marrëdhëniet ndërmjet gjendjes shëndetësore dhe mjedisit fizik dhe social të qenies njerëzore; c) njohuri të përshtatshme për disiplinat dhe praktikat klinike, duke i siguruar studentit një pasqyrë koherente të sëmundjeve mendore dhe fizike, të mjekësisë nga pikëpamja e profilaksisë, diagnostikimit dhe terapisë dhe riprodhimit njerëzor; ç) përvojë të përshtatshme klinike në spitale nën mbikëqyrjen e duhur.
4.1.2 Formimi për programin e studimit “Infermieri”	1. Formimi për infermierët përgjegjës për kujdesin e përgjithshëm duhet të sigurojë përfundimin e njohurive dhe aftësive të mëposhtme: a) njohuri gjithëpërfshirëse të shkencave në të cilat bazohet infermiera e përgjithshme, duke përfshirë kuptimin e mjaftueshëm të strukturës, funksioneve fiziologjike dhe sjelljes së personave të shëndetshëm dhe të sëmurë, dhe të marrëdhënies ndërmjet gjendjes së shëndetit dhe mjedisit fizik dhe social të njeriut; b) njohuri për natyrën dhe etikën e profesionit dhe për parimet e përgjithshme të shëndetit dhe infermierisë;



	<p>c) përvojë të përshtatshme klinike, e cila zgjidhet për vlerën e saj të formimit, nën mbikëqyrjen e personelit të kualifikuar infermieror dhe në vendet ku numri i personelit të kualifikuar dhe pajisjet janë të përshtatshme për kujdesin infermieror të pacientit;</p> <p>ç) aftësinë për të marrë pjesë në formimin praktik të personelit shëndetësor dhe përvojë pune me këtë personel;</p> <p>d) përvojë pune në bashkëpunim me anëtarë të profesioneve të tjera në sektorin e shëndetësisë.</p> <p>2. Kualifikimi formal si infermier përgjegjës për kujdesin e përgjithshëm duhet të dëshmojë se profesionisti zotëron të paktën kompetencat e mëposhtme, pavarësisht nëse trajnimi është kryer në universitete, institucione të arsimit të lartë të një niveli të njohur si ekuivalent apo shkolla profesionale ose përmes programeve të formimit profesional për infermierinë:</p> <p>a) kompetencën për të diagnostikuar në mënyrë të pavarur kujdesin infermieror të kërkuar duke përdorur njohuritë aktuale teorike dhe klinike dhe për të planifikuar, organizuar dhe zbatuar kujdesin infermieror gjatë trajtimit të pacientëve në bazë të njohurive dhe aftësive të fituara në përputhje me sa parashikohet në këtë Shtojcë;</p> <p>b) kompetencën për të punuar së bashku në mënyrë efektive me aktorë të tjerë në sektorin e shëndetësisë, duke përfshirë pjesëmarrjen në trajnimin praktik të personelit shëndetësor në bazë të njohurive dhe aftësive të fituara, në përputhje me sa parashikohet në shkronjat “ç” dhe “d”, të nënparagrafit të parë, të pikës 4.1.2, të kësaj shtojce nr. 4;</p> <p>c) kompetencën për të ndërgjegjësuar individët, familjet dhe grupet drejt një stili jetese të shëndetshëm dhe të kujdesit për veten në bazë të njohurive dhe aftësive të fituara në përputhje me sa parashikohet në këtë pikë 4.1.2, të kësaj shtojce nr. 4;</p> <p>ç) kompetencën për të ndërmarrë në mënyrë të pavarur masa të menjëhershme për ruajtjen e jetës dhe për të zbatuar masa në situata krizash dhe fatkeqësish;</p> <p>d) kompetencën për të dhënë këshilla, udhëzuar dhe mbështetur në mënyrë të pavarur personat që kanë nevojë për kujdes dhe personat e lidhur me ta;</p> <p>dh) kompetencën për të siguruar dhe vlerësuar në mënyrë të pavarur cilësinë e kujdesit infermieror;</p> <p>e) kompetencën për të komunikuar në mënyrë gjithëpërfshirëse dhe profesionale dhe për të bashkëpunuar me profesionistë të tjerë në sektorin e shëndetësisë;</p> <p>ë) kompetencën për të vlerësuar cilësinë e kujdesit infermieror me qëllim përmirësimin gjatë ushtrimit të profesionit si infermier.</p>
4.1.3 Formimi për programin e studimit “Stomatologji”	<p>1. Formimi bazë stomatologjik duhet të sigurojë përfitimin e njohurive dhe aftësive të mëposhtme:</p> <p>a) njohuri të përshtatshme të shkencave mbi të cilat bazohet stomatologjia dhe një kuptim të mirë të metodave shkencore, duke përfshirë parimet e matjes së funksioneve biologjike, vlerësimin e fakteve të vërtetuara shkencërisht dhe analizën e të dhënave;</p> <p>b) njohuri të përshtatshme për strukturën, fiziologjinë dhe sjelljen e personave të shëndetshëm dhe të sëmurë, si dhe ndikimin e mjedisit natyror dhe social në gjendjen e shëndetit të njeriut, për aq sa këta faktorë ndikojnë në stomatologji;</p> <p>c) njohuri të përshtatshme për strukturën dhe funksionin e dhëmbëve, gojës, nofullave dhe të indeve të lidhura me to, të shëndetshme dhe të sëmura, dhe marrëdhëniet e tyre me gjendjen e përgjithshme shëndetësore dhe me mirëqenien fizike dhe sociale të pacientit;</p> <p>ç) njohuri të përshtatshme për disiplinat dhe metodat klinike, që i ofrojnë stomatologut një pamje koherente të anomalive, lezioneve dhe sëmundjeve të dhëmbëve, gojës, nofullave dhe indeve të lidhura me to, dhe të stomatologjisë parandaluese, diagnostikuese dhe terapeutike;</p> <p>d) përvojë e përshtatshme klinike nën mbikëqyrjen e duhur.</p> <p>2. Ky formim siguron përftimin e aftësive të nevojshme për kryerjen e të gjitha aktiviteteve që përfshijnë parandalimin, diagnostikimin dhe trajtimin e anomalive dhe sëmundjeve të dhëmbëve, gojës, nofullave dhe indeve përkatëse.</p>
4.1.4 Formimi për programin e studimit “Mjekësi veterinarë”	<p>1. Formimi si mjek veterinar duhet të sigurojë përfitimin e njohurive dhe aftësive të mëposhtme:</p> <p>a) njohuri të përshtatshme të shkencave në të cilat bazohen aktivitetet e një mjeku veterinar dhe të legjislativitetit të zbatueshëm në lidhje me këto aktivitete;</p> <p>b) njohuri të përshtatshme për strukturën, funksionet, sjelljen dhe nevojat fiziologjike të kafshëve, si dhe aftësitë dhe kompetencat e nevojshme për mbarëshkrimin, ushqimin, mirëqenien, riprodhimin dhe higjienën e tyre në përgjithësi;</p> <p>c) aftësitë dhe kompetencat klinike, epidemiologjike dhe analitike të kërkuara për parandalimin, diagnostikimin dhe trajtimin e sëmundjeve të kafshëve, duke përfshirë anestezinë, kirurgjinë aseptike dhe vdekjen pa dhimbje, nëse konsiderohen individualisht ose në grup, duke përfshirë njohuritë specifike të sëmundjeve që mund të transmetohet te njerëzit;</p> <p>ç) njohuritë, aftësitë dhe kompetencat e duhura për mjekësinë parandaluese, duke përfshirë kompetencën për të ndërmarrë inspektime dhe certifikime;</p> <p>d) njohuri të përshtatshme për higjienën dhe teknologjinë e përfshirë në prodhimin, përpunimin dhe vënien në qarkullim të ushqimeve për kafshë ose ushqimeve me origjinë shtazore të destinuara për konsum njerëzor, duke përfshirë aftësitë dhe kompetencat e nevojshme për të kuptuar dhe shpjeguar praktikën e mira në këtë drejtim;</p> <p>dh) njohuritë, aftësitë dhe kompetencat e kërkuara për përdorimin e përgjegjshëm dhe të arsyeshëm të produkteve medicinale veterinarë, me qëllim trajtimin e kafshëve dhe për të garantuar sigurinë e zinxhirit ushqimor dhe mbrojtjen e mjedisit.</p>



4.1.5 Formimi për programin e studimit “Mami”	<p>1. Formimi si mami duhet të sigurojë përfitimin e njohurive dhe aftësive të mëposhtme:</p> <p>a) njohuri të hollësishme të shkencave në të cilat bazohen aktivitetet e mamive, veçanërisht mamia, obstetrika dhe gjinekologjia;</p> <p>b) njohuri të përshtatshme për etikën e profesionit dhe legjislacionin përkatës për ushtrimin e profesionit;</p> <p>c) njohuri të përshtatshme për njohuritë e përgjithshme mjekësore (funksionet biologjike, anatominë dhe fiziologjinë) dhe farmakologjinë në fushën e obstetrikës dhe të të porsalindurve, si dhe njohuri për marrëdhëniet midis gjendjes shëndetësore dhe mjedisit fizik dhe social të qenies njerëzore dhe sjelljen e tyre;</p> <p>ç) përvojë të përshtatshme klinike të fituar në institucione të miratuara që i mundëson mamisë të jetë në gjendje, në mënyrë të pavarur dhe nën përgjegjësinë e saj, në masën e nevojshme dhe duke përjashtuar situatat patologjike, të menaxhojë kujdesin antenatal, të kryejë pritjen e foshnjës dhe pasojat e saj në institucionet e miratuara; dhe për të mbikëqyrur procesin përpara dhe gjatë lindjes, kujdesin pas lindjes dhe reanimacionin neonatal gjatë pritjes së një mjeku;</p> <p>d) të kuptuarit e duhur të formimit të personelit shëndetësor dhe përvojës së punës me këtë personel.</p>
4.1.6 Formimi për programin e studimit “Farmaci”	<p>1. Formimi për farmacistët duhet të sigurojë përfitimin e njohurive dhe aftësive të mëposhtme:</p> <p>a) njohuri të përshtatshme për barnat dhe substancat e përdorura në prodhimin e barnave;</p> <p>b) njohuri të përshtatshme për teknologjinë farmaceutike dhe testimin fizik, kimik, biologjik dhe mikrobiologjik të produkteve mjekësore;</p> <p>c) njohuri të përshtatshme për metabolizmin dhe efektet e produkteve mjekësore dhe për veprimin e substancave toksike, si dhe për përdorimin e produkteve medicinale;</p> <p>ç) njohuri të përshtatshme për të vlerësuar të dhënat shkencore në lidhje me barnat në mënyrë që të jetë në gjendje të ofrojë informacionin e duhur mbi bazën e këtyre njohurive;</p> <p>d) njohuri të përshtatshme në lidhje me kërkesat ligjore dhe çdo kërkesë tjetër që lidhet me ushtrimin e profesionit të farmacistë.</p>
4.1.7 Formimi për programin e studimit “Arkitekturë”	<p>1. Formimi në fushën e arkitekturës duhet të sigurojë të paktën përvetësimin e njohurive, aftësive dhe kompetencave të mëposhtme:</p> <p>a) aftësive për të krijuar dizajne arkitekturore që plotësojnë kërkesat estetike dhe teknike;</p> <p>b) njohuri të përshtatshme mbi historinë dhe teorinë e arkitekturës dhe të arteve, teknologjive, dhe shkencave njerëzore përkatëse;</p> <p>c) njohjen e arteve të bukura dhe ndikimin në cilësinë e dizajnit arkitekturor;</p> <p>ç) njohuri të përshtatshme për projektimin urban, planifikimin dhe aftësitë e përfshira në procesin e planifikimit;</p> <p>d) të kuptuarit e marrëdhënieve midis njerëzve dhe ndërtesave, dhe midis ndërtesave dhe mjedisit të tyre, dhe nevojës për të lidhur ndërtesat dhe hapësirat ndërmjet tyre me nevojat njerëzore dhe shkallën;</p> <p>dh) të kuptuarit e profesionit të arkitektit dhe rolit të arkitektit në shoqëri, veçanërisht për përgatitjen e informacioneve që marrin parasysh faktorët socialë;</p> <p>e) të kuptuarit e metodave të hulumtimit dhe përgatitjes së përmbledhjes për një projekt arkitektonik;</p> <p>ë) të kuptuarit e projektimit strukturor dhe problemeve ndërtimore dhe inxhinierike që lidhen me projektimin e ndërtesave;</p> <p>f) njohuri të përshtatshme të problemeve fizike dhe teknologjive dhe të funksionit të ndërtesave me qëllim garantimin e komoditetit në brendësi të tyre, si dhe mbrojtjen ndaj kushteve klimaterike në kuadër të zhvillimit të qëndrueshëm;</p> <p>g) aftësitë e nevojshme të projektimit për të përmbushur kërkesat e përdoruesve të ndërtesave brenda kufizimeve të vendosura nga kostot dhe kuadrit rregullator në fushën e ndërtimit;</p> <p>gj) njohuri të përshtatshme për industrinë, organizatat, rregulloret dhe procedurat e përfshira në përkthimin e koncepteve të projektimit në ndërtesa dhe integrimin e planeve në planifikimin e përgjithshëm.</p>

Tabela 4.2: Parashikime lidhur me veprimtaritë formuese minimale që duhet të përfshihen në programet e studimit “Mjekësi e Përgjithshme”, “Infermieri”, “Stomatologji”, “Mami”, “Mjekësi veterinar”, “Farmaci” dhe “Arkitekturë”

MJEKËSI E PËRGJITHSHME
4.2.1 Formimi bazë në mjekësi të përgjithshme përbëhet nga të paktën 5 500 (pesë mijë e pesëqind) orë formimi teorik dhe praktik.
INFIERMIERI
4.2.2 Formimi për përgatitjen e infermierëve përbëhet nga të paktën 4 600 (katër mijë e gjashtëqind) orë formimi teorik dhe klinik, nga të cilat formimi teorik përfshin të paktën një të tretën dhe formimi praktik të paktën gjysmën e kohëzgjatjes së formimit. Institucionet që ofrojnë formimin për infermierinë janë përgjegjëse për koordinimin e formimit teorik dhe klinik për gjatë të gjithë programit të studimit. Formimi klinik përbën atë pjesë të formimit të infermierëve nëpërmjet të cilit praktikanti infermier mëson, si pjesë e një ekipi dhe në kontakt të drejtpërdrejtë me një individ dhe/ose komunitet të shëndetshëm ose të sëmurë, të organizojë, japë dhe vlerësojë kujdesin e nevojshëm gjithëpërfshirës infermior, në bazë të njohurive, aftësive dhe kompetencave që kanë përfutur. Praktikanti infermier mëson jo vetëm si të punojë në ekip, por edhe si ta drejtojë atë dhe të organizojë kujdesin e përgjithshëm infermior, duke përfshirë edukimin shëndetësor për individë dhe grupe të vogla, brenda institutëve shëndetësore ose në komunitet. Ky trajnim zhvillohet në spitale dhe institucione të tjera shëndetësore dhe në komunitet, nën përgjegjësinë e mësuesve të infermierisë, në bashkëpunim dhe të asistuar nga infermierë të tjerë të kualifikuar. Në procesin mësimor mund të marrë pjesë edhe personel tjetër i kualifikuar. Infermieri praktikant merr pjesë në aktivitetet e departamentit në fjalë për aq sa këto aktivitete i shërbejnë formimit të tij, me qëllim për të mësuar të ndërmarrë përgjegjësitë e përfshira në kujdesin infermior.



4.2.3 Një ose më shumë nga veprimtaritë formuese/lëndëve të mëposhtme mund të ofrohen për mësim si pjesë e disiplinave të tjera ose në lidhje me to. Formimi teorik balancohet dhe koordinohet me formimin klinik në mënyrë të tillë që njohuritë dhe aftësitë e përmendura në këtë shtojcë nr. 4 të fitohen në mënyrë të përshtatshme.

A. Formimi teorik	B. Formimi klinik
<p>a) Infermieria:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Natyra dhe etika e profesionit; - Parimet e përgjithshme të shëndetit dhe infermierisë; - Parimet e infermierisë në lidhje me: - mjekësinë e përgjithshme dhe të specializuar; - kirurgjinë e përgjithshme dhe të specializuar; - kujdesin për fëmijët dhe pediatriinë; - kujdesin për nënat; - shëndetin mendor dhe psikiatriinë; - kujdesin për të moshuarit dhe geriatriinë. <p>b) Shkencat themelore:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Anatomia dhe fiziologjia; - Patologjia; - Bakteriologjia, virologjia dhe parazitologjia; - Biofizikë, biokimi dhe radiologjia; - Dietetikë; - Higjienë: - mjekësi parandaluese; - edukim shëndetësor; - Farmakologjia. <p>c) Shkenca shoqërore:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Sociologjia; - Psikologjia; - Parime të administrimit; - Parime të mësimdhënies; - Legjislacioni për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore; - Aspekte ligjore të infermierisë. 	<ul style="list-style-type: none"> - Infermieria në lidhje me: - mjekësinë e përgjithshme dhe të specializuar - kirurgjinë e përgjithshme dhe të specializuar - kujdesin për fëmijët dhe pediatriinë - kujdesin e për nënat dhe fëmijët gjatë shtatzënisë si edhe gjatë e pas lindjes - shëndetin mendor dhe psikiatriinë - kujdesin për të moshuarit dhe geriatriinë - infermierinë në shtëpi

STOMATOLOGJI

4.2.4 Formimi për përgatitjen e stomatologëve përbëhet nga të paktën 5 000 (pesë mijë) orë formimi teorik dhe praktik.

4.2.5 Programi i studimeve që çon në lëshimin e dëshmive të kualifikimit formal në stomatologji përfshin të paktën veprimtarinë formuese të mëposhtme. Një ose më shumë nga këto veprimtari formuese mund të ofrohen për mësim si pjesë të disiplinave të tjera ose në lidhje me to.

A. Lëndët bazë	B. Lëndët mjeko-biologjike dhe lëndë të mjekësisë së përgjithshme	C. Lëndët e lidhura drejtpërdrejt me stomatologjinë
<ul style="list-style-type: none"> - Kimi; - Fizikë; - Biologji. 	<ul style="list-style-type: none"> - Anatomia; - Embriologji; - Histologji, përfshirë citologjinë; - Fiziologji; - Biokimi (ose kimi fiziologjike); - Anatomia patologjike; - Patologji e përgjithshme; - Farmakologji; - Mikrobiologji; - Higjienë; - Mjekësi parandaluese dhe epidemiologji; - Radiologji; - Fizioterapi; - Kirurgji e përgjithshme; - Mjekësi e përgjithshme, përfshirë pediatriinë; - Otorinolaringologji; - Dermato-venereologji; - Psikologji e përgjithshme; - Psikopatologji; - Neuropatologji; - Anestetikët. 	<ul style="list-style-type: none"> - Protetodonci; - Materialet dhe pajisjet dentare; - Stomatologji konservative; - Stomatologji parandaluese; - Anestetikët dhe sedacioni; - Kirurgji speciale; - Patologji speciale; - Praktikë klinike; - Pedodonci; - Ortodonci; - Periodontikë; - Radiologji dentare; - Okluzioni dentar dhe funksionimi i nofullës; Organizimi profesional, etika dhe legjislacioni; Aspektet sociale të praktikës dentare.

MJEKËSI VETERINARE



4.2.6 Programi i studimit që çon në lëshimin e dëshmimeve dhe kualifikimeve formale në mjekësinë veterinare përfshin të paktën veprimtaritë formuese të renditura më poshtë. Mësimi për një ose më shumë nga këto veprimtari formuese mund të ofrohet si pjesë ose në lidhje me veprimtari formuese të tjera.

4.2.7 Formimi praktik mund të jetë në formën e një periudhe trajnimi, me kushtin që ky trajnim të kryhet me kohë të plotë dhe nën mbikëqyrjen e drejtpërdrejtë të urdhrit profesional përkatës dhe, në mungesë të tij, ministrisë përkatëse, sipas fushës së përgjegjësisë, me kohëzgjatje deri në gjashtë muaj, që përfshihen brenda periudhës së përgjithshme të formimit prej pesë vitesh studimi. Shpërndarja e formimit teorik dhe praktik midis grupeve të ndryshme të veprimtarive formuese balancohet dhe koordinohet në mënyrë të tillë që njohuritë dhe përvoja të fitohen në një mënyrë që t'u mundësojë veterinerëve të gjitha detyrat e tyre.

A. Lëndët bazë	B. Lëndët specifike
<ul style="list-style-type: none"> - Fizikë; - Kimi; - Biologji e kafshëve; - Biologji e bimëve; - Biomatematikë. 	<p>a) Shkenca bazë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Anatomi (përfshirë histologjinë dhe embriologjinë); - Fiziologji; - Biokimi; - Gjenetikë; - Farmakologji; - Farmaci; - Toksikologji; - Mikrobiologji; - Imunologji; - Epidemiologji; - Etikë profesionale. <p>b) Shkenca klinike:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Obstetrikë; - Patologji (përfshirë anatominë patologjike); - Parazitologji; - Mjekësi klinike dhe kirurgji (përfshirë anestetikët); - Leksione klinike për kafshët e ndryshme shtëpiake, shpendët dhe speciet e tjera të kafshëve; - Mjekësi parandaluese; - Radiologji; - Riprodhimi dhe çrregullimet e riprodhimit; - Shërbimi veterinar shtetëror dhe shëndeti publik; - Legjislacioni veterinar dhe mjekësia ligjore; - Terapeutikë; - Propedeutikë. <p>c) Prodhimi i shtazor</p> <ul style="list-style-type: none"> - Prodhimi shtazor; - Të ushqyerit e kafshëve; - Agronomi; - Ekonomi rurale; - Blegtori; - Higjienë veterinare; - Etologji dhe mbrojtje e kafshëve. <p>d) Higjiena e ushqimit</p> <ul style="list-style-type: none"> - Inspektimi dhe kontrolli i produkteve ushqimore shtazore ose ushqimeve me origjinë shtazore; - Higjiena dhe teknologjia e ushqimit; - Praktikë (përfshirë praktikën në vendet ku bëhet therja dhe përpunimi i produkteve ushqimore).

MAMI

4.2.8 Programi i formimit për mami të përbëhet nga të paktën 4 600 (katër mijë e gjashtëqind) orë formimi teorik dhe praktik, me të paktën një të tretën e kohëzgjatjes minimale që përfaqëson formimin klinik.

4.2.9 Formimi teorik dhe teknik (pjesa A e programit) balancohet dhe koordinohet me formimin klinik (pjesa B e programit) në mënyrë të tillë që njohuritë dhe kompetencat e përcaktuara në këtë shtojcë nr. 4 të mund të fitohen në mënyrë të përshtatshme. Institucionet që ofrojnë formime për mami të janë përgjegjëse për koordinimin e teorisë dhe praktikës përgjatë të gjithë programit të studimit.

4.2.10 Formimi klinik zhvillohet në formën e trajnimit të mbikëqyrur gjatë shërbimit në departamentet e spitalit ose shërbime të tjera shëndetësore të miratuara nga autoriteti kompetent. Si pjesë e këtij trajnimi, studentët mami marrin pjesë në aktivitetet e departamenteve përkatëse për aq sa këto aktivitete kontribuojnë në formimin e tyre. Gjatë trajnimit të mbikëqyrur, studentëve u mësohen përgjegjësitë e përfshira në aktivitetet e mamive.

A. Formimi teorik dhe teknik	B. Formimi praktik dhe klinik
<p>a) Lëndët e përgjithshme:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Anatomi dhe fiziologji bazë; - Patologji bazë; - Bakteriologji bazë, virologji dhe parazitologji; - Biofizika bazë, biokimi dhe radiologji; - Pediatria, me fokus të veçantë të të porsalindurit; 	<p>Ky trajnim duhet të kryhet nën mbikëqyrjen e duhur:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Këshillimi i grave shtatzëna, që përfshin të paktën 100 ekzaminime para lindjes. - Mbikëqyrja dhe kujdesi i të paktën 40 grave shtatzëna. - Kryerja e të paktën 40 procedurash lindjeje nga studenti; kur ku ky numër nuk mund të arrihet për shkak të mungesës së grave të disponueshme për të lindur, ai mund të reduktohet në një minimum prej 30, me kusht që studenti të asistojë më tej në 20 lindje të tjera. - Pjesëmarrje aktive në lindje podalike. Kur kjo nuk mund të realizohet për shkak të mungesës së lindjeve podalike, praktika mund të zhvillohet në një situatë të simuluar.



<ul style="list-style-type: none"> - Higjienë, edukim shëndetësor, mjekësi parandaluese, diagnostikim i hershëm i sëmundjeve; - Të ushqyerit dhe dietetika, me fokus të veçantë te gratë, të porsalindurit dhe foshnjat; - Çështje bazë të sociologjisë dhe çështje socio-mjekësore; - Farmakologji bazë; - Psikologji; - Parime dhe metoda të mësimdhënies; - Legjislacioni i sigurimeve shëndetësore dhe shoqërore dhe organizimi shëndetësor; - Etika profesionale dhe legjislacioni profesional; - Edukim seksual dhe planifikim familjar; - Mbrojtje ligjore e nënës dhe foshnjës. <p>b) Veprimtari formuese specifike për aktivitetet e mamive</p> <ul style="list-style-type: none"> - Anatomi dhe fiziologji; - Embriologji dhe zhvillimi i fetusit; - Shtatzënia, lindja dhe puerperiumi; - Patologji gjinekologjike dhe obstetrike; - Përgatitje për lindjen e fëmijës dhe prindërimin, duke përfshirë aspektet psikologjike; - Përgatitje për lindje (përfshirë njohuritë dhe përdorimin e pajisjeve teknike në obstetrikë); - Analgezi, anestezi dhe reanimim; - Fiziologji dhe patologji e foshnjës së porsalindur; - Kujdesi dhe mbikëqyrja e foshnjës së porsalindur; - Faktorët psikologjikë dhe socialë. 	<ul style="list-style-type: none"> - Kryerja e epiziotomisë dhe hyrje në suturim. Mësimi përfshin formim teorik dhe praktikë klinike. Praktika e suturimit përfshin qepjen e plagës pas një epiziotomie dhe çarjeje të thjeshtë perineale. Kjo praktikë mund të zhvillohet në një situatë të simuluar nëse vlerësohet absolutisht e nevojshme. - Mbikëqyrja dhe kujdesi i 40 grave në rrezik gjatë shtatzënisë, lindjes ose periudhës pas lindjes. - Mbikëqyrja dhe kujdesi (përfshirë ekzaminimin) e të paktën 100 grave pas lindjes dhe foshnjave të porsalindura të shëndetshme. - Vëzhgimi dhe kujdesi i të porsalindurit që kërkon kujdes të veçantë, duke përfshirë të lindurit para kohe, me vonesë, nën peshë ose të sëmurë. - Kujdesi për gratë me sëmundje patologjike në fushën e gjinekologjisë dhe obstetrikës. - Hyrje në fushën e kujdesit për mjekësinë dhe kirurgjinë. Mësimi përfshin formim teorik dhe praktikë klinike.
FARMACI	
<p>4.2.11 Gjatë balancimit të formimit teorik dhe praktik për çdo veprimtari formuese, rëndësi e veçantë i jepet aspektit teorik për të ruajtur karakterin universitar të studimit.</p>	
<p>4.2.12 Gjatë ose në fund të formimit teorik dhe praktik, studenti duhet të kryejë një praktikë gjashtëmujore në një farmaci e cila është e hapur për publikun ose në një spital nën mbikëqyrjen e departamentit farmaceutik të atij spitali.</p>	
<ul style="list-style-type: none"> - Biologji e bimëve dhe e kafshëve; - Fizikë; - Kimi e përgjithshme dhe inorganike; - Kimi organike; - Kimi analitike; - Kimi farmaceutike, përfshirë analizat e produkteve medicinale; - Biokimi e përgjithshme dhe e aplikuar (mjekësore); - Anatomi dhe fiziologji; terminologji mjekësore; - Mikrobiologji; - Farmakologji dhe farmakoterapi; - Teknologji farmaceutike; - Toksikologji; - Farmakognozi; - Legjislacioni dhe, sipas rastit, etika profesionale. 	
ARKITEKTURË	
<p>Arkitektura duhet të jetë komponenti kryesor i studimit. Studimi duhet të përmbajë një ekuilibër midis aspekteve teorike dhe praktike të formimit arkitektonik dhe garanton të paktën përvetësimin e njohurive, aftësive dhe kompetencave të përcaktuara në pikën 4.1.7, të tabelës 4.1, të kësaj shtojce nr. 4.</p>	

**VENDIM****Nr. 826, datë 28.12.2023****PËR ORGANIZIMIN DHE
FUNKSIONIMIN E DREJTORISË SË
SHËRBIMEVE TË PESHKIMIT DHE
AKUAKULTURËS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 3, të nenit 66, të ligjit nr. 64/2012, “Për peshkimin”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:**I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME**

1. Organizimin dhe funksionimin e Drejtorisë së Shërbimeve të Peshkimit dhe Akuakulturës (në vijim DSHPA), si person juridik, publik, buxhetor, në varësi të ministrit përgjegjës për peshkimin (në vijim ministri), me seli në Tiranë.

2. DSHPA-ja financohet nga buxheti i shtetit dhe burime të tjera të ligjshme. Buxheti i DSHPA-së përbën zë të veçantë në buxhetin e ministrisë përgjegjëse për peshkimin.

3. DSHPA-ja ka si mision të garantojë menaxhimin e infrastrukturës së peshkimit dhe të lidhur me peshkimin, aktivitetet e kontrollit, inspektimit, monitorimit të hapësirës detare dhe grumbullimin e të dhënave në fushën e peshkimit e të akuakulturës.

4. DSHPA-ja e ushtron veprimtarinë në këto fusha përgjegjësie:

a) kryerjen e aktiviteteve të shërbimeve në peshkim dhe akuakulturë;

b) menaxhimin e infrastrukturës së peshkimit dhe të lidhur me peshkimin, sipas njëtrës prej mënyrave të parashikuara në legjislacionin në fuqi për peshkimin;

c) kryerjen e aktiviteteve të kontrollit e të inspektimit.

**II. PËRGJEGJËSITË FUNKSIONALE TË
DREJTORISË SË SHËRBIMEVE TË PESHKI-
MIT DHE AKUAKULTURËS**

DSHPA-ja ka përgjegjësi të organizojë punën për:

a) aktivitetet e kontrollit e të inspektimit për të garantuar zbatimin efektiv të legjislacionit të peshkimit e të akuakulturës;

b) grumbullimin, përpunimin dhe raportimin e të dhënave për sektorin e peshkimit e të akuakulturës në ministri;

c) menaxhimin efektiv të infrastrukturës së peshkimit e të infrastrukturës së lidhur me peshkimin;

ç) ofrimin e shërbimeve publike në peshkim dhe akuakulturë;

d) zhvillimin profesional, nëpërmjet trajnimeve dhe formave të tjera të inspektorëve të peshkimit.

**III. ORGANIZIMI DHE FUNKSIONIMI I
DREJTORISË SË SHËRBIMEVE TË PESHKI-
MIT DHE AKUAKULTURËS**

1. DSHPA-ja e shtrin veprimtarinë e vet në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë dhe organizohet në nivel qendror.

2. DSHPA-ja drejtohet nga drejtori, i cili organizon dhe drejton veprimtarinë e saj, përfaqëson drejtorinë në marrëdhënie me të tretët dhe përgjigjet para ministrit.

3. Drejtori i DSHPA-së drejton veprimtarinë e përditshme të institucionit dhe ushtron kompetencat e mëposhtme:

a) përcakton objektivat vjetorë, në përputhje me objektivat strategjike të ministrisë;

b) planifikon, bashkërendon dhe monitoron veprimtarinë e sektorëve të DSHPA-së;

c) siguron unifikimin e praktikave të kontrollit e të menaxhimit të peshkimit dhe akuakulturës;

ç) miraton dhe monitoron zbatimin e programit dhe raportin vjetor të monitorimit, kontrollit dhe menaxhimit të infrastrukturës;

d) propozon dhe monitoron zbatimin e buxhetit të DSHPA-së;

dh) nxjerr urdhra organizativë për mbarëvajtjen e vazhdueshme të punës për përcaktimin e procedurave, kompetencave, detyrave dhe funksioneve për kryerjen e veprimtarive të kontrollit, inspektimit dhe menaxhimit të infrastrukturës për strukturat e DSHPA-së;

e) bashkërendon veprimtarinë e DSHPA-së me organet e tjera shtetërore në fushën e kontrollit, inspektimit dhe menaxhimit në fushën e peshkimit dhe akuakulturës, me të cilat është lidhur një marrëveshje bashkëpunimi;

ë) siguron zbatimin e akteve ligjore e nënligjore, përfshirë aktet nënligjore të ministrit, që rregullojnë veprimtarinë në fushën e peshkimit e të akuakulturës;



f) përgatit një vlerësim të të ardhurave e të shpenzimeve dhe zbaton buxhetin e alokuar;

g) monitoron rezultatet e drejtorisë kundrejt objektivave operacionale dhe përgatit një raport të përgjithshëm vjetor të cilin ia paraqet ministrit;

gj) merr masa për funksionimin e një rrjeti informacioni me institucionet kombëtare dhe ndërkombëtare;

h) përgatit programin vjetor të inspektimit dhe, pas konsultimit me Inspektoratin Qendror, e paraqet për miratim në ministri;

i) përgatit programin vjetor të punës dhe ia dërgon ministrit për miratim;

j) nxjerr akte administrative për zbatimin e politikave, strategjive, programeve të miratuara, si dhe për menaxhimin administrativ, financiar, të burimeve njerëzore;

k) rast pas rasti ngre Njësinë Operacionale të Inspektimit;

l) kryen detyra të tjera të përcaktuara nga legjislacioni në fuqi për peshkimin e akuakulturën, si dhe për organizimin e funksionimin e administratës shtetërore.

4. DSHPA-ja ka për detyrë:

a) menaxhimin e veprimtarisë së qendrave të ripopullimit dhe aseteve të tjera që ka në administrim;

b) vëzhgimin e hapësirës detare nëpërmjet Sistemit të Monitorimit të Anijeve të Peshkimit, VMS, duke siguruar që shfrytëzimi i burimeve peshkore kryhet në përputhje me legjislacionin për peshkimin;

c) miradministrimin e fondeve buxhetore të miratuara;

ç) kontrollin, inspektimin dhe marrjen e masave administrative, në përputhje me legjislacionin në fuqi;

d) hedhjen e të dhënave për hyrje-daljet e anijeve të peshkimit nga portet shqiptare në Sistemin e Bazës së të Dhënave Shtetërore “Për trafikun detar”;

dh) bashkëpunimin me autoritetet kompetente të organizatave ndërkombëtare të peshkimit dhe të vendeve të tjera për garantimin e përmbushjeve të detyrimeve të marrëveshjeve ndërkombëtare në fuqi;

e) hartimin e programit të punës afatmesëm dhe afatgjatë ku përcaktohen:

i. objektivat e përgjithshëm, detyrat, treguesit e performancës dhe prioritetet;

ii. mjetet e kontrollit e të inspektimit që ka në dispozicion;

iii. shtesat, ndryshimet ose fshirjet në krahasim me programin e punës të vitit të kaluar, si dhe progresin e bërë në arritjen e objektivave dhe prioritetëve të përgjithshme të programit shumëvjeçar të punës;

ë) realizimin e analizave të riskut në bazë të:

i. të dhënave të peshkimit (zëniet, zbarkimet dhe sforcionet e peshkimit);

ii. zbarkimeve të paraportuara, në veçanti duke krahasuar të dhënat mbi zëniet dhe importet dhe të dhënat e eksporteve e të konsumit kombëtar;

f) hartimin, bazuar në vlerësimin e riskut e të planeve të kontrollit në baza vjetore, raportimin e realizimit e të efektivitetit të tyre te ministri;

g) hartimin dhe përditësimin e programeve të trajnimit, sipas standardeve ndërkombëtare për inspektorët e peshkimit dhe organizimin e kurseve dhe seminareve për të gjithë personelin e përfshirë në aktivitetet e kontrollit e të inspektimit;

gj) hartimin dhe përditësimin e manualeve që përcaktojnë procedurat e harmonizuara të inspektimit;

h) hartimin dhe përditësimin e materialeve udhëzuese mbi programet e inspektimit e të kontrollit të disa formave të peshkimit, të miratuara nga ministri;

i) ndjekjen e procedurave për transferimin e menaxhimit të infrastrukturës së peshkimit dhe të lidhur me peshkimin, sipas legjislacionit në fuqi për peshkimin.

5. Marrëdhëniet e punës së drejtorit dhe nëpunësve të tjerë rregullohen në bazë të dispozitave të legjislacionit për nëpunësin civil, ndërsa marrëdhëniet e punës së punonjësve administrativë rregullohen sipas dispozitave të Kodit të Punës.

6. Struktura dhe organika e DSHPA-së miratohen me urdhër të Kryeministrit, sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore.

7. Rregullorja për metodat e brendshme të punës dhe sjelljen e personelit të DSHPA-së miratohet nga ministri, me propozimin e drejtorit të saj.

8. DSHPA-ja ka stemën, logon dhe vulën e vet zyrtare. Stema e drejtorisë përbëhet nga stema e Republikës së Shqipërisë, me shënimet: “Republika e Shqipërisë, Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Drejtoria e Shërbimeve të Peshkimit dhe



Akuakulturës”, në përputhje me përcaktimet e vendimit të Këshillit të Ministrave për mënyrën e përdorimit të stemës së Republikës së Shqipërisë.

9. Vula e DSHPA-së ka formën dhe elementet e përcaktuara në vendimin nr. 390, datë 6.8.1993, të Këshillit të Ministrave, “Për rregullat e prodhimit, të administrimit, kontrollit dhe ruajtjes së vulave zyrtare”. Vula prodhohet, administrohet dhe ruhet në përputhje me legjislacionin në fuqi.

IV. DISPOZITA TË FUNDIT

1. Vendimi nr. 719, datë 20.10.2011, i Këshillit të Ministrave, “Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Drejtorisë së Shërbimeve të Mëdhjes dhe Peshkimit, Sarandë”, i ndryshuar, shfuqizohet.

2. Ngarkohen Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dhe Drejtoria e Shërbimeve të Peshkimit dhe Akuakulturës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

VENDIM
Nr. 827, datë 28.12.2023

**PËR DEKLARIMIN SI PASURI
KULTURORE E PALUAJTSHME
“QENDËR HISTORIKE” TË NJË ZONE
NË QYTETIN-MUZE TË BERATIT,
PËRCAKTIMIN E ZONËS MBROJTËSE
TË SAJ DHE MIRATIMIN E PLANIT
PËR RUAJTJEN, MBROJTJEN DHE
ADMINISTRIMIN E SAJ**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 9, pika 3, shkronjat “a” e “ç”, të ligjit nr. 27/2018, “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë”, me propozimin e ministrit të Kulturës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Deklarimin si pasuri kulturore e paluajtshme “Qendër historike” të një zone në qytetin-muze të Beratit, sipas koordinatave dhe hartave të zonifikimit në Kornizën Referuese Gjeodezike Shqiptare (në vijim, KRGJSH), që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Përcaktimin e zonës mbrojtëse të “Qendrës historike” të një zone në qytetin-muze të Beratit, sipas koordinatave dhe hartave të zonifikimit në KRGJSH, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

3. Miratimin e planit për ruajtjen, mbrojtjen dhe administrimin e këtyre zonave, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

4. Vendimi nr. 767, datë 12.11.2014, i Këshillit të Ministrave, “Për shpalljen ‘Qendër historike’ të një zone në qytetin-muze të Beratit dhe miratimin e rregullores ‘Për mbrojtjen, konservimin e integruar, administrimin e ‘Qendrës historike’ dhe zonës së mbrojtur të qytetit të Beratit’”, shfuqizohet.

5. Ngarkohet Autoriteti Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor të publikojë hartën e “Qendrës historike” të një zone në qytetin-muze të Beratit dhe të zonës mbrojtëse të saj në Gjeoportalin Kombëtar.

6. Ngarkohen Ministria e Kulturës, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Bashkia Berat për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

**PLANI PËR RUAJTJEN, MBROJTJEN DHE
ADMINISTRIMIN E “QENDRËS
HISTORIKE” TË NJË ZONE TË QYTETIT-
MUZE TË BERATIT DHE TË ZONËS
MBROJTËSE TË SAJ**

Neni 1
Qëllimi dhe objektivat

Ky plan përcakton rregullat, procedurat, autoritetet shtetërore përgjegjëse për ruajtjen, mbrojtjen dhe administrimin e “Qendrës historike” dhe të zonës mbrojtëse të qytetit-muze të Beratit, si dhe përcaktimin e kufijve të tyre.

Neni 2
Objekti

Objekt i këtij plani:

1. është administrimi i “Qendrës historike” dhe i zonës mbrojtëse të qytetit-muze të Beratit sipas hartës së zonifikimit, që i bashkëngjitet këtij plani si pjesë integrale e saj;



2. është mbrojtja, konservimi dhe restaurimi i vlerave historiko-kulturore të “Qendrës historike” të qytetit-muze të Beratit;

3. janë mënyrat e bashkëpunimit me njësitë e vetëqeverisjes vendore të qytetit të Beratit për administrimin, mbrojtjen dhe restaurimin e vlerave të trashëgimisë kulturore të “Qendrës historike” të qytetit-muze të Beratit.

Neni 3

Hapësira urbane në mbrojtje

1. Hapësira urbane në mbrojtje e qytetit të Beratit përbëhet nga:

- a) qendra historike;
- b) zona mbrojtëse.

2. Brenda zonave të përcaktuara në pikën 1, të këtij neni, përfshihen ansamble arkitektonike-urbane, monumente kulture të kategorisë I dhe monumente kulture të kategorisë II, zona të gjelbra, sheshe dhe objekte pa status.

3. Plani i përgjithshëm vendor i qytetit të Beratit duhet të marrë parasysh kufijtë dhe kriteret e mbrojtjes së “Qendrës historike” dhe të zonës mbrojtëse.

4. Organet e njësisë të vetëqeverisjes vendore, në bashkëpunim me institucionet shtetërore të specializuara, sigurojnë ruajtjen dhe mbrojtjen e “Qendrës historike”, zonës mbrojtëse përreth saj, si dhe të monumenteve të kulturës brenda kësaj hapësire.

Neni 4

“Qendra historike” dhe kufijtë e saj

1. “Qendra historike” është pjesa me vlera urbanistiko-arkitektonike e qytetit të Beratit. Ajo ruan gjini të ndryshme ndërtimore të periudhave prej shekullit IV p.e.s. dhe deri më sot, në shkallë të ndryshme autenticiteti. Këto ndërtime janë të lidhura me mjedisin tradicional, i cili është pjesë e “Qendrës historike”.

2. “Qendra historike” përmbledh brenda kufijve të saj: lagjen “Kala”, lagjen “Mangalem”, lagjen “Goricë”, si dhe Qendrën Mesjetare Islamike.

3. Kufijtë e “Qendrës historike” janë kufijtë e shpallur “Pasuri botërore” dhe paraqiten sipas koordinatave e hartave të zonifikimit, në KRGJSH, pjesë përbërëse e këtij plani.

Neni 5

Zona mbrojtëse e “Qendrës historike” dhe kufijtë e saj

1. Zona mbrojtëse shtrihet përreth “Qendrës historike”. Ajo me vlerën e saj historiko-kulturore, plotëson edhe pasuron vlerat e “Qendrës historike”.

2. Zona mbrojtëse ruhet në përbërësit urbanistikë, arkitekturorë dhe mjedisorë.

3. Kufijtë e zonës mbrojtëse janë kufijtë e shpallur “Pasuri botërore”.

4. Zona mbrojtëse, për veçoritë e ndryshme që ka në të gjithë hapësirën e saj, ndahet në katër nënzona (sipas hartës bashkëngjitur), si më poshtë:

- a) Nënzona I (veriperëndimore);
- b) Nënzona II (jugore);
- c) Nënzona III (lindore fushore);
- ç) Nënzona IV (lindore kodrinore).

5. Kufijtë e zonës mbrojtëse paraqiten sipas koordinatave dhe hartave të zonifikimit në KRGJSH, pjesë përbërëse e këtij plani.

Neni 6

Ndërhyrjet e lejuara në “Qendrën historike”

1. Ndërhyrjet në “Qendrën historike” kanë si qëllim ruajtjen dhe mbrojtjen e vlerave të trashëgimisë kulturore, historike, urbanistike, arkitektonike të qytetit të Beratit.

2. Në “Qendrën historike” nuk lejohen ndërtimet e reja.

3. Me qëllim ruajtjen e vlerave urbanistiko-arkitekturorë të “Qendrës historike”, brenda kësaj zone lejohen vetëm këto ndërhyrje:

a) Ndërhyrje sistematike konservuese, restauruese dhe të mirëmbajtjes, sipas parimeve të konservimit të integruar;

b) Ruajtja dhe përfshirja e vlerave mjedisore, duke mbajtur të pandryshuar konfiguracionin e truallit dhe llojshmërinë e drurëve dhe të bimësisë tradicionale (kur drurët përbëjnë rrezik shembjeje ose janë bartës të sëmundjeve specifike, si dhe për çdo rast tjetër të ngjashëm, organet përgjegjëse vendosin asgjësimin, heqjen, asimilimin e tij). Lidhur me konfigurimin e truallit, ruhet gjendja e *status quo* për aq kohë sa nuk veprojnë forca madhore apo dukuri të tipit shembje, shkarje etj.;

c) Konservimi i rrënojave të ndërtimeve me konture të qarta murature, në hapësirën e “Qendrës



historike”, për të penguar degradimin e mëtejshëm të tyre. Kur rrënojat ruhen në lartësi mbi 3 m dhe cenojnë dukshëm njësinë e ansambleve, brenda të cilëve përfshihen, mund të kryhet rikonstruksioni në të njëjtin volum, mbi strukturën ekzistuese (mureve perimetrale) bazuar në dokumentacionin e qartë fotografik, grafik, mbështetur në tipologjinë, trajtimin arkitektonik dhe teknikën tradicionale në pjesët e dukshme;

c) Rikonstruksione/rindërtime të ndërtesave mbi strukturat ekzistuese, sipas formulimit kompozicional dhe arkitektonik origjinal, duke u bazuar në materiale arkivore dhe fotografike pa cenuar vlerat e nëntokës.

92	496194.1324	4507491.125
93	496213.1902	4507475.475

94	496224.62	4507469.597
95	496254.1139	4507435.322
96	496265.9352	4507386.443
97	496266.5395	4507383.945
98	496268.3743	4507375.544
99	496277.1024	4507357.291
100	496303.0123	4507303.104



NR	X	Y
1	495954.1945	4507842.685
2	495955.5076	4507841.866
3	495994.3046	4507822.925
4	496001.6861	4507819.332
5	496007.7244	4507816.457
6	496016.2228	4507812.41
7	496058.4775	4507791.687
8	496177.5643	4507735.085
9	496218.15	4507717.443
10	496248.257	4507704.356
11	496263.7018	4507697.642
12	496267	4507694.887
13	496271.0796	4507691.48
14	496274.5632	4507688.57
15	496279.4099	4507682.527
16	496292.0126	4507666.813
17	496303.7602	4507646.845
18	496327.8878	4507610.715
19	496331.5955	4507607.634
20	496335.5747	4507605.329
21	496354.9237	4507594.829
22	496404.4884	4507568.386
23	496408.3243	4507566.34
24	496413.1318	4507563.773
25	496440.7227	4507549.038
26	496441.5017	4507548.622
27	496466.076	4507535.256
28	496498.4089	4507517.669
29	496535.1201	4507497.701
30	496552.6566	4507491.038
31	496578.9638	4507480.744
32	496601.6441	4507472.784
33	496617.2162	4507468.071
34	496614.5275	4507457.977
35	496600.2198	4507462.025
36	496574.0264	4507469.997
37	496556.7463	4507438.272
38	496549.4651	4507423.792
39	496545.198	4507410.304
40	496537.3997	4507414.749
41	496533.1655	4507407.321
42	496529.2391	4507405.027
43	496527.9678	4507401.674
44	496530.0313	4507395.682
45	496527.4968	4507390.587
46	496522.6659	4507381.985



47	496519.4546	4507375.222
48	496507.3049	4507353.873
49	496501.9785	4507345.543
50	496499.9705	4507342.703
51	496494.9804	4507333.851
52	496492.1824	4507328.84
53	496488.7293	4507319.861
54	496478.5456	4507304.121
55	496475.2185	4507306.485
56	496465.6105	4507291.403
57	496461.7884	4507287.594
58	496449.6101	4507292.237
59	496376.517	4507335.137
60	496355.038	4507296.864
61	496342.8711	4507289.474
62	496329.7257	4507315.319
63	496303.0123	4507303.104
64	496277.1024	4507357.291
65	496268.3743	4507375.544
66	496266.5395	4507383.945
67	496265.9352	4507386.443
68	496254.1139	4507435.322
69	496224.62	4507469.597
70	496213.1902	4507475.475
71	496194.1324	4507491.125
72	496193.0956	4507496.023
73	496180.7627	4507505.135
74	496181.1366	4507505.65
75	496182.9069	4507507.881
76	496073.8651	4507592.97
77	496072.4922	4507591.231
78	496016.0073	4507635.019
79	495956.7406	4507681.258
80	495941.4847	4507692.194
81	495930.6911	4507699.706
82	495918.513	4507704.21
83	495891.6572	4507712.815
84	495869.1308	4507716.369
85	495841.6131	4507721.237
86	495826.4949	4507723.911
87	495814.3554	4507726.058
88	495814.3113	4507731.071
89	495800.3547	4507732.959
90	495797.2177	4507733.822
91	495782.6089	4507736.879
92	495751.6829	4507742.881
93	495744.7061	4507743.283



94	495731.9622	4507742.83
95	495719.1671	4507740.93
96	495718.5938	4507750.778
97	495742.6021	4507754.787
98	495762.1223	4507761.194
99	495788.0356	4507774.978
100	495799.6855	4507783.781
101	495806.6168	4507795.679
102	495822.5706	4507837.821
103	495826.8711	4507843.898
104	495834.5775	4507847.972
105	495849.578	4507850.525
106	495862.725	4507850.579
107	495886.3375	4507849.766
108	495901.931	4507848.52
109	495900.7992	4507838.274
110	495907.1794	4507837.677
111	495911.2551	4507838.19
112	495918.2574	4507837.245
113	495919.1663	4507837.284
114	495936.4367	4507838.032
115	495949.5498	4507835.236
116	495954.1945	4507842.685



NR	X	Y
1	496617.2162	4507468.071
2	496601.6441	4507472.784
3	496578.9638	4507480.744
4	496552.6566	4507491.038
5	496535.1201	4507497.701
6	496498.4089	4507517.669
7	496466.076	4507535.256
8	496441.5017	4507548.622
9	496440.7227	4507549.038
10	496413.1318	4507563.773
11	496408.3243	4507566.34
12	496404.4884	4507568.386
13	496354.9237	4507594.829
14	496335.5747	4507605.329
15	496331.5955	4507607.634
16	496327.8878	4507610.715
17	496303.7602	4507646.845
18	496292.0126	4507666.813
19	496279.4099	4507682.527
20	496274.5632	4507688.57
21	496271.0796	4507691.48
22	496267	4507694.887
23	496263.7018	4507697.642
24	496248.257	4507704.356
25	496218.15	4507717.443
26	496177.5643	4507735.085
27	496058.4775	4507791.687
28	496016.2228	4507812.41
29	496007.7244	4507816.457
30	496001.6861	4507819.332
31	495994.3046	4507822.925
32	495955.5076	4507841.866
33	495954.1945	4507842.685
34	495958.0459	4507848.862
35	495962.5549	4507853.094
36	495967.7735	4507860.281
37	495983.4605	4507878.635
38	495987.7384	4507874.986
39	495987.7446	4507874.98
40	495990.0901	4507876.505
41	495993.0996	4507870.413
42	495996.2522	4507868.436
43	496002.5463	4507871.447
44	495998.2056	4507878.614
45	495995.1149	4507881.654
46	495992.5853	4507885.362



47	495982.4387	4507891.582
48	495995.2542	4507912.261
49	495999.8593	4507911.521
50	496005.4504	4507927.242
51	495996.2569	4507930.594
52	495996.0708	4507930.709
53	495991.2061	4507933.711
54	495981.144	4507945.866
55	495977.6616	4507943.725
56	495975.8265	4507937.875
57	495971.6554	4507932.566
58	495959.1858	4507922.983
59	495951.7083	4507921.478
60	495923.7968	4507903.561
61	495928.9667	4507898.119
62	495912.7622	4507885.108
63	495907.8427	4507882.581
64	495901.7348	4507886.675
65	495890.3397	4507898.363
66	495882.345	4507906.563
67	495873.8351	4507916.063
68	495869.2452	4507922.944
69	495853.8228	4507939.525
70	495852.647	4507941.508
71	495838.8246	4507957.073
72	495848.2587	4507967.25
73	495821.1925	4508000.185
74	495819.6971	4508003.376
75	495811.7956	4508003.913
76	495808.1758	4508003.158
77	495806.8206	4508004.982
78	495803.2725	4508012.342
79	495801.4121	4508017.238
80	495795.7064	4508025.901
81	495793.9364	4508032.258
82	495792.4469	4508034.711
83	495790.1188	4508034.702
84	495788.3252	4508040.448
85	495783.3621	4508041.081
86	495769.3968	4508059.552
87	495763.3839	4508065.452
88	495763.1025	4508067.199
89	495759.4754	4508073.236
90	495751.9372	4508083.163
91	495728.0897	4508113.405
92	495727.0393	4508114.425
93	495718.4719	4508125.818



94	495715.966	4508128.019
95	495707.0042	4508139.925
96	495698.113	4508150.276
97	495685.7217	4508167.834
98	495678.353	4508183.259
99	495667.8271	4508205.294
100	495662.5807	4508214.976
101	495658.9326	4508224.509
102	495656.2702	4508229.153
103	495639.5589	4508256.049
104	495618.5784	4508287.306
105	495588.3447	4508332.35
106	495588.1475	4508332.585
107	495584.5603	4508336.874
108	495571.7515	4508354.935
109	495571.5075	4508358.708
110	495548.3284	4508398.706
111	495536.552	4508421.069
112	495524.7755	4508443.432
113	495520.8559	4508449.795
114	495516.071	4508457.738
115	495506.4386	4508471.744
116	495500.6622	4508481.3
117	495500.417	4508481.91
118	495498.3965	4508487.883
119	495497.2505	4508497.626
120	495495.4743	4508504.062
121	495511.1291	4508510.205
122	495510.9395	4508510.697
123	495516.7218	4508513.17
124	495524.8123	4508515.007
125	495532.7309	4508520.501
126	495543.5125	4508522.814
127	495559.1783	4508527.52
128	495565.9973	4508530.97
129	495583.8583	4508540.004
130	495593.0786	4508540.133
131	495595.9153	4508539.244
132	495608.2469	4508534.331
133	495615.0666	4508529.867
134	495620.209	4508525.187
135	495623.4298	4508520.104
136	495624.625	4508518.291
137	495632.2536	4508504.238
138	495640.7253	4508486.962
139	495657.0369	4508462.136
140	495662.0771	4508452.444



141	495675.2927	4508433.388
142	495681.8877	4508424.992
143	495703.6174	4508409.181
144	495737.7896	4508386.486
145	495752.9068	4508380.013
146	495770.1892	4508376.311
147	495792.8343	4508367.907
148	495805.7042	4508362.485
149	495819.4113	4508354.791
150	495838.5213	4508347.194
151	495866.5782	4508330.281
152	495872.7126	4508328.286
153	495877.135	4508327.862
154	495908.82	4508328.624
155	495918.675	4508330.864
156	495926.9832	4508333.633
157	495930.6469	4508335.755
158	495930.2385	4508338.445
159	495948.3018	4508352.218
160	495954.0168	4508354.881
161	495959.331	4508359.616
162	495963.5798	4508365.04
163	495966.0736	4508368.727
164	496004.2317	4508353.502
165	496071.4386	4508287.272
166	496070.8027	4508258.808
167	496063.0446	4508243.067
168	496078.8926	4508243.322
169	496097.598	4508224.44
170	496109.7226	4508224.167
171	496130.5157	4508220.405
172	496138.4597	4508216.368
173	496148.2075	4508212.377
174	496151.8962	4508211.233
175	496157.2648	4508209.933
176	496158.0496	4508198.601
177	496160.3442	4508188.226
178	496165.8957	4508191.031
179	496181.3074	4508204.082
180	496191.7489	4508217.421
181	496204.2238	4508226.891
182	496211.9739	4508236.576
183	496218.6025	4508227.375
184	496211.6427	4508216.423
185	496205.4814	4508201.78
186	496203.4308	4508188.558
187	496187.4471	4508148.316



188	496218.2707	4508140.624
189	496217.0549	4508136.524
190	496222.1308	4508134.766
191	496223.0148	4508136.546
192	496225.1493	4508136.041
193	496234.3168	4508127.954
194	496238.8697	4508125.381
195	496238.9814	4508124.355
196	496241.3685	4508123.11
197	496243.296	4508117.812
198	496251.1035	4508112.753
199	496253.7168	4508116.906
200	496257.2399	4508114.32
201	496258.2166	4508113.589
202	496259.3523	4508113.255
203	496263.6186	4508110.066
204	496268.2977	4508107.233
205	496289.6945	4508085.925
206	496294.3039	4508094.341
207	496297.4552	4508097.449
208	496306.5224	4508112.45
209	496306.3794	4508124.594
210	496309.4019	4508125.105
211	496313.6208	4508124.371
212	496316.371	4508125.322
213	496322.4028	4508132.087
214	496328.1106	4508140.076
215	496331.1776	4508138.231
216	496343.3014	4508126.847
217	496365.0883	4508115.162
218	496377.9546	4508137.713
219	496384.8035	4508139.01
220	496404.7996	4508137.104
221	496416.2764	4508133.155
222	496421.5797	4508127.829
223	496426.4271	4508119.663
224	496427.4346	4508119.563
225	496441.581	4508113.502
226	496442.2135	4508111.355
227	496442.0183	4508097.303
228	496448.6349	4508091.312
229	496455.9809	4508101.745
230	496456.4897	4508140.182
231	496467.3603	4508166.747
232	496470.6166	4508174.705
233	496483.6987	4508170.409
234	496487.2065	4508170.004



235	496494.1944	4508169.195
236	496500.3012	4508162.38
237	496499.1771	4508157.483
238	496497.1453	4508148.631
239	496492.3614	4508131.692
240	496489.6961	4508121.961
241	496489.9416	4508119.524
242	496490.5572	4508117.682
243	496493.0361	4508114.673
244	496499.144	4508112.101
245	496502.7156	4508111.651
246	496503.8623	4508111.506
247	496519.8052	4508112.227
248	496528.4934	4508113.662
249	496539.7417	4508114.813
250	496539.9932	4508114.789
251	496554.2607	4508113.444
252	496560.4217	4508110.038
253	496559.7566	4508101.104
254	496557.9994	4508099.489
255	496556.9461	4508098.694
256	496556.0592	4508098.024
257	496556.0302	4508098.015
258	496555.5562	4508097.867
259	496544.8	4508094.517
260	496539.1984	4508093.95
261	496530.3125	4508091.455
262	496521.9287	4508087.47
263	496515.7091	4508082.401
264	496510.2949	4508074.512
265	496504.7499	4508062.909
266	496503.7386	4508059.385
267	496502.3603	4508053.174
268	496501.2317	4508046.712
269	496498.5419	4508034.417
270	496496.7794	4508027.135
271	496496.0622	4508025.002
272	496491.0811	4508010.677
273	496481.1934	4507989.027
274	496480.7224	4507986.425
275	496482.0851	4507985.04
276	496487.1517	4507986.167
277	496495.5877	4507993.472
278	496527.4473	4508009.039
279	496530.5956	4508007.36
280	496545.8506	4508011.542
281	496558.5278	4508020.64



282	496563.264	4508021.962
283	496567.8014	4508022.997
284	496583.3051	4508030.376
285	496585.1141	4508026.575
286	496591.5821	4508029.229
287	496591.8725	4508029.359
288	496602.3344	4508034.051
289	496612.1643	4508039.299
290	496614.537	4508035.825
291	496614.9895	4508031.082
292	496616.4012	4508028.107
293	496604.7689	4508020.903
294	496595.0044	4508010.271
295	496606.1308	4507995.94
296	496621.5126	4507976.127
297	496643.5578	4507994.59
298	496674.6988	4508001.893
299	496708.2908	4507971.852
300	496714.8852	4507939.101
301	496702.2675	4507915.273
302	496713.3084	4507868.76
303	496708.1534	4507866.964
304	496700.9257	4507864.492
305	496697.5997	4507862.859
306	496688.6436	4507856.182
307	496675.1792	4507843.741
308	496666.8884	4507837.282
309	496656.0795	4507832.001
310	496643.9724	4507827.573
311	496637.3293	4507822.095
312	496628.7081	4507810.149
313	496624.6314	4507805.68
314	496621.2839	4507802.893
315	496614.3198	4507798.104
316	496607.8013	4507790.162
317	496598.7202	4507766.876
318	496592.3464	4507755.509
319	496584.1773	4507746.865
320	496583.5044	4507742.212
321	496583.56	4507719.887
322	496589.8932	4507719.765
323	496598.5079	4507719.892
324	496606.7686	4507717.931
325	496618.0327	4507712.637
326	496620.7371	4507707.77
327	496621.6749	4507701.14
328	496623.6508	4507692.072



329	496626.0803	4507687.892
330	496638.439	4507676.24
331	496645.8351	4507674.349
332	496654.6765	4507674.387
333	496659.8725	4507674.41
334	496658.9188	4507667.91
335	496659.8714	4507658.998
336	496668.0044	4507641.443
337	496670.2605	4507637.112
338	496674.4548	4507627.642
339	496661.7345	4507627.602
340	496654.6057	4507626.258
341	496656.5791	4507615.785
342	496662.2538	4507602.814
343	496658.7462	4507588.893
344	496655.6473	4507570.825
345	496646.7778	4507556.085
346	496637.4977	4507545.94
347	496634.8775	4507541.837
348	496630.047	4507520.781
349	496624.8377	4507499.219
350	496623.8848	4507488.629
351	496623.2376	4507486.576
352	496618.3436	4507472.303
353	496617.2162	4507468.071

URDHËR
Nr. 1, datë 3.1.2024

PËR DELEGIMIN E KOMPETENCAVE

Në mbështetje të pikës 4 të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; të shkronjës “d”, të nenit 28, të ligjit nr. 9000, datë 30.1.2003, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”; të nenit 22, 28 dhe 29, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”; të pikës 2, të nenit 11, të ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e Administratës Shtetërore”; të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”, të pikës 2, të nenit 73, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.5.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencave të titullarit të Autoritetit Kontraktor, znj. Ledina Beqiraj Agalliu, me detyrë Sekretar i Përgjithshëm pranë Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, për të gjitha procedurat e prokurimit publik me fonde buxhetore për Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit.

2. Kompetencat e deleguara të titullarit të Autoritetit Kontraktor të Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit do të ushtrohen për periudhën nga hyrja në fuqi e këtij urdhri deri në datën 31 dhjetor 2024.

3. Ngarkohet për zbatimin e këtij urdhri Sekretari i Përgjithshëm.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I TURIZMIT DHE MJEDISIT
Mirela Kumbaro Furxhi



URDHËR
Nr. 1, datë 4.1.2024

PËR DELEGIM TË KOMPETENCAVE

Në mbështetje të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”; të nenit 21, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”; të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”; të ligjit nr. 10296, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, të ndryshuar; të ligjit nr. 97/2023, “Për buxhetin e shtetit të vitit 2024”, si dhe të nenit 24, të rregullores “Për veprimtarinë e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit”, dhe të nenit 6, të rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e administratës së KPK-së”,

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencave të titullarit të Autoritetit Kontraktor të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, të Sekretari i Përgjithshëm i institucionit, z. Edmond Verçani, për nisjen dhe zhvillimin e procedurave të prokurimit për blerjet me vlera të vogla apo direkte, si dhe veprimet me degën e Thesarit Tiranë për këto prokurime.

2. Kompetenca e deleguar, sipas pikës 1 të këtij urdhri, do të ushtrohet nga data e hyrjes në fuqi e këtij urdhri deri më 31.12.2024.

3. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për zbatimin e këtij urdhri.

4. Ngarkohet Drejtoria Ekonomike dhe e Shërbimeve Mbështetëse për komunikimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Roland Ilia

GJYKATA EVROPIANE E TË DREJTAVE
TË NJERIUT

SEKSIONI I TRETË
ÇËSHTJA OSMANI KUNDËR
SHQIPËRISË
(Kërkesa nr. 8706/18)

VENDIM

STRASBURG
5 dhjetor 2023

Ky vendim është i formës së prerë, por mund të bëhet subjekt i rishikimit redaktues.

Në çështjen Osmani kundër Shqipërisë,

Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (Seksioni i Tretë), e mbledhur si një Komitet i përbërë nga:

Georgios A. Serghides, *kryetar,*

Darian Pavli,

Oddný Mjöll Arnardóttir, *gjyqtarë*

dhe Olga Chernishova, *zëvendëssekretare e Seksionit,*

Duke marrë në konsideratë:

kërkesën (nr. 8706/18) kundër Republikës së Shqipërisë depozituar pranë Gjykatës, në mbështetje të nenit 34 të Konventës për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore (“Konventa”) më 12 shkurt 2018, nga një shtetas shqiptar, z. Fiqiri Osmani (“kërkuesi”), lindur në vitin 1960 dhe banues në Vorë, i cili u përfaqësua nga znj. S. Mëneri, një avokate që e praktikon ligjin në Tiranë;

vendimin për të njoftuar mbi kërkesën qeverinë shqiptare (“Qeveria”), të përfaqësuar nga agjentët e saj, znj. A. Hiçka, z. A. Metani dhe më pas nga z. O. Moçka, Avokati i Përgjithshëm i Shtetit; vërejtjet e palëve;

Pasi diskutoi me dyer të mbyllura më 14 nëntor 2023,

Shpall vendimin e mëposhtëm, i cili u miratua në po atë datë:

OBJEKTI I ÇËSHTJES

1. Çështja ka të bëjë me një ankesë të bërë në mbështetje të nenit 6 § 1 të Konventës dhe nenit 1 të Protokollit nr. 1, sipas së cilës gjykatat vendase nuk dhanë arsye për shumën që kërkuesi kishte të drejtë të merrte si kompensim për shpronësimin e pasurisë së tij.



I. PROCESET PRANË GJYKATAVE TË RRETHIT DHE TË APELIT

A. Informacion i përgjithshëm mbi ngjarjen

2. Më 27 korrik 2010, Inspektorati Ndërtimor dhe Urbanistik Vorë (“Inspektorati”) informoi kërkuesin se pranë pronës së tij ishte planifikuar të ndërtohej një rrugë, dhe i kërkonte që të lironte “pronën që ishte shpronësuar” prej tij për këtë qëllim brenda pesë ditësh.

3. Pas një kërkesë të bërë nga kërkuesi, më 4 gusht 2010, Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve (“DPRR”), që në atë periudhë ishte organi përgjegjës për infrastrukturën rrugore në vend, e informoi kërkuesin se asnjë pasuri nuk ishte shpronësuar prej tij, sepse “projekti për ndërtimin e rrugëve nuk ishte zbatuar plotësisht”.

4. Më 11 gusht 2010, Inspektorati informoi kërkuesin se çdo gardh dhe objekt brenda perimetrit, i ndërtuar me ose pa autorizim, që pengonte projektin për ndërtimin e rrugës, duhej të prishej vullnetarisht brenda pesë ditësh.

5. Më 6 shtator 2010, inspektorët konstatuan se kërkuesi kishte ndërtuar pa autorizim një shtesë në ndërtesë dhe një mur që e rrethonte pronën e tij. Më 7 shtator, autoritetet vendosën t’i prishnin këto ndërtime dhe më 8 shtator, ata e ekzekutuan atë vendim.

B. Procedurat gjyqësore

6. Më 13 shtator 2010, kërkuesi depozitoi në gjykatë një padi për dëme ndaj bashkisë për ndërtimet e prishura, që sipas këndvështrimit të tij ishin ndërtuar në përputhje me lejet përkatëse. Ai shtoi se gjatë procesit të shkatërrimit, autoritetet kishin prishur edhe një sërë pemësh dekorative në kopshtin e tij, një pus me ujë, një tendë, sende shtëpiake etj. Në fund, ai kërkoi kompensim për një pjesë të pacaktuar të truallit të tij, që *de facto* ishte shpronësuar nga autoritetet për të ndërtuar rrugën e re,

7. Më 13 qershor 2011, me kërkesë të kërkuesit, DPRR-ja iu bashkua procedurave si palë e tretë.

8. Më 16 nëntor 2011, një eksperte e caktuar nga gjykata arriti në përfundimin se, për sa kishte të bënte me çështjen, 88 m² e truallit të kërkuesit ishte zënë nga rruga e re. Ajo deklaroi se sipas njoftimeve për shitje për toka të ngjashme, vlera e tregut të pronës ishte 160 euro për metër katror.

9. Kërkuesi nuk ra dakord dhe parashtroi se toka e tij kishte vlerë të paktën 200 euro për metër katror.

10. Rezulton se në një datë të papërcaktuar, DPRR-ja parashtroi në gjykatë se kishte nisur procesi formal për shpronësimin ndaj kërkuesit.

11. Më 29 janar 2012, DPRR-ja paraqiti pranë Ministrisë së Transportit dhe Punëve Publike një listë me emrat e pronarëve dhe pronat e tyre që prekeshin nga rruga e re konkrete. Për sa i përket kërkuesit, lista përcaktonte se 90 metër katrorë ishin subjekt i shpronësimit për një kompensim prej 2750 lekësh për metër katror (afërsisht 20 euro në atë periudhë). Rezulton se kjo listë ishte përfshirë si provë në dosjen e çështjes.

12. Më 9 shkurt 2012, ekspertja e plotësoi raportin e saj të datës 16 nëntor 2011 me një shtesë, ku deklarohet se sipas vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 1620, të datës 26 nëntor 2008 (“VKM 1620”), që rregullonte çmimin e referencës së tokës për metër katror në zonën përkatëse, në kontekstin e procedurave të kompensimit për tokën e shpronësuar gjatë regjimit komunist (shih *Çausb Driça kundër Shqipërisë*, nr. 10810/05, §§ 44–45, 15 mars 2011), trualli i kërkuesit vlerësohej në vlerën 12000 lekë për metër katror (afërsisht 86 euro në atë periudhë). Ekspertja ia la gjykatës që të vendoste për shumën e përshtatshme.

13. Më 23 nëntor 2012, Gjykata e Rrethit Tiranë e rrezoi kërkesën. Ajo iu referua parashtrimeve dhe korrespondencës së DPRR-së, të datës 29 janar 2012 (shih paragrafët 10–11 më sipër) për të arritur në përfundimin nëse trualli ishte shpronësuar rregullisht, si edhe për përlllogaritjen e kompensimit që do të duhej të shlyhej. Gjithashtu, ajo urdhëroi kërkuesin të shlyente kostot dhe shpenzimet e procesit që arrinin vlerën 452000 lekë (afërsisht 3200 euro në atë periudhë).

14. Në një datë të papërcaktuar, kërkuesi apeloj me argumentin se vendimi i gjykatës fillestare ishte i pambështetur në fakte dhe përsëriti kërkesën e tij për një shumë kompensimi më të madhe.

15. Më 5 qershor 2014, Gjykata Administrative Tiranë e Apelit la në fuqi vendimin dhe arsyetimin e gjykatës fillestare. Ajo theksonte veçanërisht se faktet përkatëse të çështjes kishin ndryshuar pas dorëzimit të padisë, sepse toka ishte shpronësuar më herët, më 29 janar 2012.

II. PROCEDURAT PRANË GJYKATËS SË LARTË DHE GJYKATËS KUSHTETUESE

16. Më 21 tetor 2014, kërkuesi bëri një rekurs në Gjykatën e Lartë duke argumentuar, për sa ka të bëjë me çështjen, se gjykatat më të ulëta kishin shkelur të



drejtën e tij ndaj pronës dhe ndaj një vendimi të arsyetuar pasi gjykatat nuk kishin dhënë arsye për miratimin e vlerësimit të DPRR-së në lidhje me vlerën e tokës së shpronësuar për metër katror përkundrejt përlllogaritjeve të ekspertes së caktuar nga gjykata, VKM-së 1620 dhe parashtrimeve të kërkuases.

17. Ndërkohë, më 8 prill 2015, Këshilli i Ministrave miratoi vendimin nr. 303 (“VKM 303”) me anë të së cilit ai shpronësonte 105 m² nga kërkuesi me vlerë 3081 lekë për metër katror (afërsisht 22 euro në atë periudhë).

18. Më 1 mars 2017, Gjykata e Lartë vendosi se procedura kishte qenë e drejtë dhe rrëzoi rekursin e kërkuetit si të papranueshëm. Ajo nuk adresoi çështjen e shumës së kompensimit.

19. Më 28 qershor 2017, kërkuesi depozitoi një rekurs pranë Gjykatës Kushtetuese duke u ankuar, për sa ka të bëjë me çështjen, për një sërë shkeljesh të nenit 6 § 1 të Konventës, duke përfshirë kërkesën për “afat të arsyeshëm” dhe të drejtën për një vendim të arsyetuar në lidhje me shumën e kompensimit për pjesën e shpronësuar të tokës së tij. Gjithashtu, ai u ankua për një shkelje të së drejtës së tij ndaj pronës sipas nenit 1, të Protokollit nr. 1 të Konventës.

20. Më 18 dhjetor 2017, Gjykata Kushtetuese konstatoi një shkelje të së drejtës së kërkuetit për një gjykim brenda një afati të arsyeshëm dhe rrëzoi ankesat e tjera. Gjykata adresoi pretendimet e kërkuetit në lidhje me prishjen e një pjese të pronës së tij pa kompensim, pjesë e cila ishte trajtuar nga autoritetet si ndërtim i paligjshëm, por heshti për metodën e përlllogaritjes për kompensim në procedurat e shpronësimit dhe për shumën e kompensimit ndaj kërkuetit.

21. Një përshkrim i përgjithshëm për procedurën e shpronësimit sipas ligjit për shpronësimin (ligji nr. 8561, i datës 22 dhjetor 1999, “Për shpronësimet dhe përdorimin e përkohshëm të pronës private në interesin publik”) bëhet në vendimin *Sharxhi dhe të Tjerë kundër Shqipërisë* (nr. 10613/16, § 63, 11 janar 2018). Për sa ka të bëjë me çështjen, në mbështetje të nenit 17 të ligjit, vlera e pronës së shpronësuar përcaktohet nga një komision i posaçëm i ngritur nga ministria përgjegjëse për shpronësimin. Në vijim, e njëjta ministri i paraqet një propozim Këshillit të Ministrave, që në fund vendos nëse duhet të kryhet shpronësimi. Nëse propozimi pranohet, Këshilli i Ministrave lëshon një vendim ku

përcaktohet, *inter alia*, prona e shpronësuar, pronari i saj dhe shuma e kompensimit për pronarin ose pronaren (neni 21). Brenda 30 ditëve nga vendimi i Këshillit të Ministrave për shpronësim, palët e prekura prej tij mund të fillojnë procedurat gjyqësore për të kundërshtuar shumën e kompensimit për pronat e tyre të shpronësuar (neni 24(1)).

VLERËSIMI I GJYKATËS

I. PRETENDIM PËR SHKELJE TË NENIT 6 § 1 TË KONVENTËS DHE NENIT 1 TË PROTOKOLLIT NR. 1 TË KONVENTËS, PËR MUNGESËN E ARSYEVE NË VENDIMET VENDASE NË LIDHJE ME SHUMËN E KOMPENSIMIT

22. Kërkuesi u ankua në mbështetje të nenit 6 § 1 të Konventës dhe nenit 1 të Protokollit nr. 1 të Konventës se gjykatat vendase nuk kishin dhënë arsye në lidhje me shumën e kompensimit për tokën e tij dhe rrëzimin e kërkesave të tij sipas kuantit. Gjykata vëren se këto ankesa nuk ishin të pambështetura në fakte sipas interpretimit të nenit 35 § 3 (a) të Konventës, apo të papranueshme për ndonjë arsye tjetër. Për këtë arsye, ato duhet të deklarohen të pranueshme.

23. Parimet e përgjithshme sipas nenit 6 § 1 të Konventës, në lidhje me detyrën e një gjykate për të dhënë arsye janë përmbledhur në vendimin *Moreira Ferreira kundër Portugalisë* (nr. 2) ([DHM], nr. 19867/12, § 84, 11 korrik 2017). Parimet e zbatueshme në mbështetje të nenit 1 të Protokollit nr. 1 të Konventës janë përmbledhur në vendimin *Vistiņš dhe Perepjolkins kundër Letonisë* ([DHM], nr. 71243/01, §§ 95-99 dhe 108-14, 25 tetor 2012).

24. Në gjykatat vendase nuk pati diskutime për faktin se një pjesë e tokës së kërkuetit ishte marrë nga autoritetet për ndërtimin e një rruge të re. Pasi ky aspekt ishte përcaktuar, çështja kryesore për t’u zgjidhur nga gjykatat vendase ishte shuma për metër katror, që do t’i paguhej kërkuetit si kompensim. Gjykata do ta shqyrtojë çështjen që ishte thelbi i ankesës së kërkuetit paraqitur pranë saj, më konkretisht nëse kompensimi dhënë për kërkuetin ishte i përshtatshëm. Teksa gjykatat vendase normalisht janë në një pozicion më të mirë për të përcaktuar ekzistencën dhe kuantin e dëmit pasuror (shih *Scordino kundër Italisë* (nr. 1) [DHM], nr. 36813/97, § 203, GJEDNJ 2006-V), Gjykata ka juridiksionin për të vlerësuar nëse kompensimi ishte i përshtatshëm dhe i mjaftueshëm sipas interpretimit të nenit 1 të Protokollit nr. 1 të Konventës.



25. Fillimisht, ajo konstaton, siç edhe rezulton nga shkresa e DPRR-së për kërkuësin (shih paragrafin 3 më sipër) dhe parashtrimet e tyre pranë gjykatës fillestare (shih paragrafin 10 më sipër), se në kohën kur kishin nisur punimet për ndërtimin e rrugës së re, procedura e shpronësimit nuk ishte përfunduar. Faktikisht, procedura formale e shpronësimit përfundoi vetëm në vitin 2015 (shih paragrafin 17 më sipër). Në këtë kontekst, rezulton se kur punimet për ndërtimin e rrugës filluan në vitin 2010, prona e kërkuësit ishte marrë nga autoritetet me anë të procedurës *de facto* të shpronësimit, dhe për këtë arsye, në çështjen konkrete nuk do të këtë diskutime për “interesin publik”. Sipas rrethanave, nuk ishte e paarsyeshme që kërkuësi të kishte pritshmëri për kompensim të plotë për dëmin e shkaktuar (krahaso *Kbizanishvili dhe Kandelaki kundër Gjeorgjisë* nr. 25601/12, § 54, 17 dhjetor 2019).

26. Të paktën pesë parashtrime të ndryshme u paraqitën pranë gjykatave vendase në lidhje me shumën e kompensimit për tokën që ishte marrë prej tij. Ekspertja e caktuar nga gjykata vendosi se çmimi i tregut për metër katror për tokën e kërkuësit ishte 160 euro, ndërsa sipas VKM-së 1620, çmimi ishte 86 euro (shih paragrafët 8 dhe 12 më sipër). Kërkuësi kundërshtoi se çmimi i tregut në fakt ishte 200 euro (shih paragrafin 9 më sipër). Një dokument pune i DPRR-së ka përcaktuar shifrën e kompensimit në vlerën 20 euro (shih paragrafin 11 më sipër). Në fund, VKM-ja 303 e përcaktonte shumën në vlerën 22 euro (shih paragrafin 17 më sipër).

27. Gjykata fillestare dhe gjykata e apelit iu referuan shumës së paraqitur nga DPRR-ja në dokumentin e saj të punës pa dhënë arsye se cilat elemente e çuan në miratimin e asaj vlere dhe në rrëzimin e parashtrimeve të tjera paraqitur pranë saj, veçanërisht propozimet e ekspertës. Rezultoi se këto gjykata nuk u angazhuan në mënyrën e duhur, apo nuk dhanë një përgjigje specifike dhe eksplicite për kërkesën kryesore të kërkuësit, gjë që ishte vendimtare për rezultatin e procedurave (krahaso *Ruiz Torija kundër Spanjës*, 9 dhjetor 1994, § 30, seritë A nr. 303-A; *Buzescu kundër Rumanisë* nr. 61302/00, § 67, 24 maj 2005; dhe për vlerësimin e proporcionalitetit të ndërhyrjes në të drejtën ndaj pronës, *Vistin dhe Perepjolkins*, §§ 111-14, dhe *Kbizanishvili dhe Kandelaki*, §§ 58–59, të dy cituar më sipër).

28. Kërkuësi u ankua për këtë aspekt në gjykatat më të lartë (shih paragrafët 16 dhe 19 më lart). Edhe pse ankesa e tij për mungesë të arsyeve nga gjykatat më të ulëta, në lidhje me një shkelje të mundshme të të drejtave të tij të garantuara nga Konventa, që gjykatat vendase duhej t'i shqyrtonin me vëmendje dhe kujdes të veçantë (shih *Fabris kundër Francës* [DHM] nr. 16574/08, § 72, GJEDNJ 2013 (ekstrakte)), Gjykata e Lartë dhe Gjykata Kushtetuese i rrëzuan ankesat e tij, pa i adresuar pretendimet e tij në lidhje me përlllogaritjen e shumës së kompensimit.

29. Në këtë mënyrë, është shkelur neni 6 § 1 dhe neni 1 i Protokollit nr. 1 të Konventës për mosdhënien e arsyeve nga ana e gjykatave vendase në lidhje me shumën e kompensimit dhe për faktin se kërkuësit nuk i ishte akorduar kompensim i përshtatshëm për pronën që i ishte marrë nga autoritetet vendase.

II. ANKESA TË TJERA

30. Duke marrë në konsideratë faktet e çështjes, parashtrimet e palëve dhe konstatimet e saj në mbështetje të nenit 6 § 1 të Konventës, Gjykata vlerëson se në çështjen konkrete nuk është e nevojshme që të jepet një vendim i veçantë për pranueshmërinë dhe meritat e ankesave sipas neneve 6 § 1 dhe nenit 8 të Konventës (krahaso *Qendra për Burimet Juridike në emër të Valentin Câmpeanu kundër Rumanisë* [DHM] nr. 47848/08, § 156, GJEDNJ 2014).

ZBATIMI I NENIT 41 TË KONVENTËS

31. Kërkuësi kërkoj 154,000 euro për dëmin jopasuror. Gjithashtu, ai kërkoj 3,233 euro që i ishin ngarkuar nga gjykata e shkallës së parë si kosto dhe shpenzime për procedurat vendase. Së fundmi, për sa i përket kostove dhe shpenzimeve të bëra në Gjykatë, ai kërkoj 66,000 lekë (afërsisht 523 euro) për shërbimet e dy ekspertëve për vlerësimin e pronave.

32. Qeveria i kundërshtoi shumat si të paarsyeshme.

33. Gjykata ka konstatuar se shkeljet e nenit 6 të Konventës dhe nenit 1 të Protokollit nr. 1 erdhën si pasojë e mosjustifikimit në mënyrën e duhur të shumës së kompensimit nga ana e gjykatave vendase. Duke marrë në konsideratë karakterin procedural të shkeljes së konstatuar, Gjykata nuk mund të spekulojë për shumën e duhur të dëmit pasuror dhe konstaton se rihapja e procedurave vendase dhe rishqyrtimi i çështjes në nivel kombëtar,



në parim, do të përbënte mënyrën më të përshtatshme për të korrigjuar shkeljen (shih, për qasje të ngjashme, *Gereksar dhe të Tjerë kundër Turqisë* nr. 34764/05 dhe 3 të tjerë, § 75, 1 shkurt 2011; *Kravchuk kundër Rusisë* nr. 10899/12, §§ 55–56, 26 nëntor 2019; *Kostov dhe të Tjerë kundër Bullgarisë* nr. 66581/12 dhe 25054/15, § 105, 14 maj 2020; dhe *Todorov dhe të Tjerë kundër Bullgarisë* nr. 50705/11 dhe 6 të tjerë, § 322, 13 korrik 2021). Duke qenë se neni 494 §(ë) i Kodit të Procedurës civile e parashikon një mundësi të tillë, një formë e përshtatshme korrigjimi për shkeljen e të drejtës së kërkuarit do të ishte rihapja e procedurave, nëse kërkuari do ta kërkonte një rihapje të procedurave, si edhe rishqyrtimi i çështjes në një mënyrë që është në respektim të parashikimeve të Konventës (shih *Pálka dhe të Tjerë kundër Republikës Çeke* nr. 30262/13, § 69, 24 mars 2022, *Khizanishvili dhe Kandelaki*, § 63, cituar më sipër). Në vijim, ajo i akordin kërkuarit 4,700 euro për dëmin jopasuror, plus çdo taksë që mund t'i tarifohet kërkuarit.

34. Në lidhje me kostot dhe shpenzimet në gjykatën e shkallës së parë, Gjykata konstatoi një shkelje procedurale të nenit 6 § 1 të Konventës, pa përcaktuar nëse kërkuari do të kishte pasur sukses në atë proces apo nëse do të ishte ngarkuar me kostot e procesit. Në këtë mënyrë, ajo e rrëzon kërkesën e tij. Duke qenë se kërkuari nuk paraqiti ndonjë kërkesë për kostot dhe shpenzimet pranë gjykatave të apelit dhe gjykatave më të larta, për këtë kategori nuk u bë asnjë akordim.

35. Në lidhje me tarifën e ekspertëve për procedurat pranë saj, këto shpenzime nuk ishin të nevojshme për të mbështetur shkeljen e konstatuar nga Gjykata, për aq kohë sa ato i përkisnin arsytimit të gjykatave vendase (shih *Merabishvili kundër Gjeorgjisë* [DH] nr. 72508/13, § 370, 28 nëntor 2017), për këtë arsye nuk u dha asnjë akordim as edhe në këtë kategori.

PËR KËTO ARSYE, GJYKATA, NË MËNYRË UNANIME,

1. *E deklaron* të pranueshme ankesën, në mbështetje të nenit 6 § 1 të Konventës dhe nenit 1 të Protokollit nr. 1 të Konventës, në lidhje me mosdhënien e arsytimit nga ana e gjykatave vendase;

2. *Gjykon* se është shkelur neni 6 § 1 dhe neni 1 i Protokollit nr. 1 të Konventës për shkak të mosdhënies së arsytimit nga gjykatat vendase për vendimet e tyre;

3. *Gjykon* se nuk është e nevojshme të shqyrtohen pranueshmëria dhe meritat e ankesave të tjera sipas nenit 6 § 1 dhe nenit 8 të Konventës;

4. *Gjykon*

a) se shteti përgjegjës duhet t'i paguajë kërkuarit, brenda tre muajve, 4,700 euro (katër mijë e shtatëqind euro), plus çdo taksë që mund të jetë e tarifueshme për dëmin jopasuror, të konvertuara në monedhën e shtetit përgjegjës në normën e zbatueshme në datën e shlyerjes;

b) se që nga përfundimi i periudhës tremujore të sipërpërmendur deri në shlyerjen e saj, një interes i thjeshtë do të paguhet për shumën e mësipërme në normën e barasvlershme me normën marginale të huadhënies së Bankës Qendrore Evropiane gjatë periudhës së mospagesës plus tre pikë përqindje;

5. *Rrëzon* pjesën tjetër të kërkesës së kërkuarit për dëmshpërblim të drejtë.

Hartuar në gjuhën angleze dhe njoftuar me shkrim më datë 5 dhjetor 2023, sipas rregullit 77 §§ 2 dhe 3 të Rregullores së Gjykatës.

ZËVENDËSSEKRETARE

Olga Chernishova

KRYETAR

Georgios A. Serghides

GJYKATA EVROPIANE E TË DREJTAVE
TË NJERIUT

SEKSIONI I TRETË
VENDIM

Kërkesa nr. 18175/12

**NIKOLLA CEPIKU DHE SENI SHPK
KUNDËR SHQIPËRISË**

(shih tabelën bashkëlidhur)

Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (Seksioni i Tretë), e mbledhur më 9 nëntor 2023 si një Komitet i përbërë nga:

Ioannis Ktistakis, *kryetar*,

Darian Pavli,

Oddný Mjöll Arnardóttir, *gjyqtarë*

dhe Viktoriya Maradudina, *zëvendëssekretare e përkohshme e Seksionit*,

duke marrë në konsideratë kërkesën e mësipërme të paraqitur më 7 mars 2012,



duke marrë në konsideratë deklaratën e paraqitur nga qeveria përgjegjëse me anë të së cilës Gjykatës i kërkohet të çregjistrojë kërkesën nga lista e çështjeve,

Pasi diskutoi, vendos si më poshtë:

FAKTET DHE PROCEDURA

Lista e kërkuessve paraqitet në tabelën bashkëlidhur.

Kërkuesit u përfaqësuan nga znj. A. Mascia, avokate që e praktikon ligjin në Verona.

Qeverisë shqiptare (“Qeveria”) iu komunikuan ankesat e kërkuessve në mbështetje të nenit 6 § 1 dhe nenit 13 të Konventës, në lidhje me kohëzgjatjen e tepërt të procesit civil dhe mungesën e mjeteve efikase.

LIGJI

A. Në lidhje me kërkesën e parë, z. Cepiku

Pas negociatave të pasuksesshme për zgjidhje miqësore, qeveria informoi Gjykatën se propozonte të bënte një deklaratë të njëanshme me qëllim zgjidhjen e problematikave që lindnin nga ankesat e mësipërme.

Qeveria e pranonte kohëzgjatjen e tepërt të procesit civil në lidhje me kërkuessin e parë. Në vijim, qeveria pranonte se autoritetet vendase kishin shkelur të drejtat e kërkuessit të parë, të garantuara nga neni 13 i Konventës. Qeveria ofronte t’i paguante kërkuessit të parë shumat e detajuara në tabelën bashkëlidhur dhe ftonte Gjykatën të çregjistronte kërkesën nga lista e çështjeve në përputhje me nenin 37 § 1 (c) të Konventës. Shumat do të konvertoheshin në monedhën e shtetit përgjegjës në normën e zbatueshme në datën e pagesës dhe do të shlyheshin brenda tre muajve nga data e njoftimit të vendimit të Gjykatës. Në rast se këto shuma nuk do të paguheshin brenda periudhës tremujore të sipërpërmendur, qeveria merrte përsipër të paguante interesin e thjeshtë për to nga përfundimi i periudhës deri në shlyerje, në normën e barasvlershme me normën marginale të huadhënies të Bankës Qendrore Evropiane gjatë periudhës së mospagesës plus tre pikë përqindje.

Pagesa do të përbënte zgjidhjen përfundimtare të çështjes.

Kërkuesit të parë iu dërguan kushtet e deklaratës së njëanshme të Qeverisë disa javë përpara datës së këtij vendimi. Më 7 mars 2023, Gjykata mori një përgjigje me anë të së cilës kërkuessi i parë kundërshtonte kushtet e deklaratës.

Gjykata vëren se neni 37 § 1 (c) i krijon mundësinë të çregjistrojë një çështje nga lista nëse:

“... për çdo arsye tjetër që, sipas Gjykatës, nuk justifikon vazhdimin e shqyrtimit të kërkesës”.

Në këtë mënyrë, Gjykata mund të çregjistrojë kërkesa në mbështetje të nenit 37 § 1 (c) mbështetur në një deklaratë të njëanshme nga qeveria përgjegjëse edhe nëse kërkuessit dëshirojnë që të vijohet me shqyrtimin e çështjes (shih veçanërisht vendimin *Tahsin Acar kundër Turqisë* (kundërshtimet paraprake) [DHM], nr. 26307/95, §§ 75–77, GJEDNJ 2003-VI).

Gjykata ka krijuar një praktikë gjyqësore të qartë dhe gjithëpërfshirëse, në lidhje me ankesat për kohëzgjatjen e tepërt të procesit civil (shih, për shembull, *Luli dhe të Tjerë kundër Shqipërisë* nr. 64480/09 dhe 5 të tjerë, 1 prill 2014, dhe *Mishgjoni kundër Shqipërisë* nr. 18381/05, 7 dhjetor 2010).

Duke vënë re pohimet në deklaratën e Qeverisë, si edhe shumën e kompensimit të propozuar – që është në përputhje me shumat e akorduara në çështje të ngjashme – Gjykata vlerëson se nuk është e justifikueshme që të vijohet me shqyrtimin e kërkesës në pjesën e paraqitur nga kërkuessi i parë (neni 37 § 1 (c)).

Për sa më sipër, Gjykata vlerëson se mbështetur në parashikimet e Konventës dhe të Protokolleve të saj mbi të drejtat e njeriut, asaj nuk i kërkohet të vijojë me shqyrtimin e pjesës respektive të kërkesës (neni 37 § 1 *in fine*).

Së fundmi, Gjykata thekson se nëse qeveria nuk respekton kushtet e deklaratës së saj të njëanshme, kërkesa mund të rikthehet në listë në përputhje me nenin 37 § 2 të Konventës (shih *Josipović kundër Serbisë* (vendim) nr. 18369/07, 4 mars 2008).

Për sa më sipër, është me vend që të çregjistrohen ankesat në lidhje me kohëzgjatjen e tepërt të procesit civil dhe mungesën e mjeteve efektive për sa i takon kërkuessit të parë, z. Cepiku.

B. Në lidhje me kompaninë kërkuese

Edhe kompania kërkuese ngriti ankesa të ngjashme në mbështetje të neneve 6 dhe 13 të Konventës.

Gjykata ka shqyrtuar kërkesën dhe vlerëson se, në mbështetje të të gjithë materialeve që zotëron dhe përderisa çështjet për të cilat janë ngritur ankesat janë në kompetencën e saj, këto ankesa nuk përmbushin kriteret e pranueshmërisë të parashikuara në nenet 34 dhe 35 të Konventës, dhe nuk paraqesin ndonjë konstatim të shkeljes së të



drejtave dhe lirive të parashikuara në Konventë ose në Protokollin e saj.

Rrjedhimisht, kjo pjesë e kërkesës duhet të kundërshtohet në mbështetje të nenit 35 § 4 të Konventës.

Për këto arsye, Gjykata, në mënyrë unanime,

Mban në konsideratë kushtet e deklaratës së Qeverisë përgjegjëse në lidhje me kërkuuesin e parë, z. Cepiku, dhe angazhimet për garantimin e respektimit të premtimeve në të;

Vendos të çregjistrojë këtë pjesë të kërkesës nga lista e saj e çështjeve në përputhje me nenin 37 § 1 (c) të Konventës;

E deklaron pjesën tjetër të kërkesës të papranueshme.

Hartuar në gjuhën angleze dhe njoftuar me shkrim më datë 30 nëntor 2023.

ZËVENDËSSEKRETARE E PËRKOHSHME
Viktoria Maradudina

KRYETAR
Ioannis Ktistakis

SHTOJCË

Lista e kërkesave sipas së cilave paraqiten ankesa në mbështetje me nenin 6 § 1 të Konventës
(kohëzgjatje e tepërt e procesit civil dhe mungesa e mjeteve efektive në ligjin vendas për këtë aspekt)

Ankesa nr. Data e paraqitjes	Emri i ankuesit Viti i lindjes	Emri dhe vendndodhja e përfaqësuesit	Data e marrjes së deklaratës së Qeverisë	Data e marrjes së komenteve të kërkuarit	Shuma akorduar për dëmin jopasuror për kërkuarin e parë sipas deklaratës së njëanshme (në euro) ⁴	Shuma e akorduar për kostot dhe shpenzimet për kërkuarin e parë sipas deklaratës së njëanshme (në euro) ⁵
18175/12 7.3.2012	Nikolla CEPIKU 1954	Mascia Antonella Verona	30.1.2023	7.3.2023	1,200	250
	SENI SHPK 1995					

⁴ Plus çdo taksë që mund t'i tarifohet kërkuarit.

⁵ Plus çdo taksë që mund t'i tarifohet kërkuarit.

*Shënim: Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë
të një procedure automatike nga një sistem elektronik
(Qendra e Botimeve Zyrtare)*

Formati 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2024

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 352 lekë